

Xhafer Durmishi
SKENDER

VEPRA
3

"Zëri i popullit"
dhe
Zëri i Jusuf Gërvallës



PARAFJALË

1. ARRATISJA

2. Kush përgjigjet për krimet e gjenocidit në Kosovë?

3. ZËRI I POPULLIT - ZË I TË GJITHË SHQIPTARËVE

4. Lajmërimi i Pranverës '81 në Lajmëtarin e lirisë
5. ZËRI I KIÇO FOTJADHIT
6. PSE U PËRDOR DHUNA POLICORE DHE TANKET KUNDËR SHQIPTARËVE NË KOSOVË?
7. KUSH E NXIT ARMIQËSINË MIDIS POPUJVE TË JUGOSLLAVISË?
8. DUHESHIN SHKRIME, TRAKTE DHE FJALIME
9. Kërkesa për ti njohur Kosovës, statusin e Republikës, është e drejtë
10. GJENEZA SIPAS GJENAZEVE
11. KËRKESA "KOSOVA – REPUBLIKË" NUK MUND TË SHUHET AS ME DHUNË, AS ME TEORIZIME BOSHE
12. KOSOVËS PO I VRITEN DJEMTË NGA SERBOMËDHENJTË
13. ZËRI I JUSUF GËRVALLËS
14. Të madhërishëm dhe të patejkalueshëm

Parafjalë

Për përgatitjen e këtij libri dua ta falënderoj Faridin Tafallarin në dy drejtime:
 -Së pari, ai qysh më heret m'i ka siguruar të gjitha kopjet që ia kam kërkuar nga revista Lajmëtarin e lirisë, Bashkimi dhe Zëri i Kosovës.

-Së dyti për ofrimin e ndihmës përmes shokut të tij A. S. nga Tirana, rreth sigurimit e artikujve të "Zërit të popullit", i cili kërkesën e Faridinit e ka pritur në këtë formë:

Faridin,

Gëzohem shumë që u dëgjua se, kishim kohë që nuk kishim komunikuar, por edhe që jeni mirë me shëndet. Edhe ne këtej nga Tirana, në këtë vjeshtë - pranverë, jemi mirë, mezi presim që të freskohet pak moti!? Përsa më shkruan për kërkesën e atyre artikujve, do të përpiqem të ta plotësoj por duhet të dish që më duhet pak kohë sepse janë disa procese për kërkimin e artikujve në fjalë, fotokopjimin etj... E them këtë se, ti shoku ynë e di fare mirë se, nuk "përtojmë" kurrë për Ty, sepse ke lënë gjurmë të forta burrërie tek ne, si njeri me karakter fisnik e një shqiptar i vërtetë i Kosovës, pra i besës, dhe jo si shumë të tjerë, madje emra të njohur, që e kanë "dredh" pa pikë turpi, dhe na kanë "haru"... Të kujtojmë shpesh edhe në bisedat me H., sepse ... nevoja për miqtë dhe shokët e vërtetë po kërkohet shumë dhe Ti je njëri prej tyre!

Faridin!...Sot e mbarova porosinë tënde për artikujt e gazetës Z.P.! U vonuan ca... dhe u mundova pak sepse, për fat, Biblioteka Kombëtare është në konstruksion, kështu që falë respektit për ty, por dhe vendit që kam atje, u përpoqën që në mes të atij pluhuri e rrëmujës së madhe të rinovimit të fondeve, të më nxirrnin koleksionet, që ju kërkoja... Siç të kisha vënë në dijeni, artikujt ishin shumë voluminoz, kështu që edhe fotokopjimi i tyre qe mjaft i vështirë... ata nuk mund të dërgohen me asnjë rrugë tjetër, përveçse postimit të fotokopjeve të tyre!...

Gjithë të mirat!

A. S.

Xhafer Durmishi

1. ARRATISJA

Jusuf Gërvalla: "E diel, 30 dhjetor, 1979 ora 00.45 Ludwigsburg
Pardje dy javë, më 14 dhjetor, natën vonë e braktisa Prishtinën dhe Kosovën.
Aty nga ora 16, erdhën në "Rilindje" Suzana me Kadri Rexhën dhe më prunë lajme të hidhura.

Atë ditë heret në mëngjes, e paskëshin burgosur Hysenin; i kishin gjetur materiale të shtypura të Lëvizjes. Dina, i cili e kishte sjellë lajmin për Hysenin, i gjen punëtorët e SPB-së duke ma bastisur banesën.

Shoku i Lëvizjes, Bashkim Prishtina, qe i mendimit se është shumë më mirë të arratisem, se sa të bie në burg: edhe dënimi do të kish qenë i rëndë, edhe do të rrezikohej eventualisht organizata. ...

Në Ludwigsburg, në banesë të Bardhit, arritëm nga ora katër e mëngjesit, ditën e premte, më 21 dhjetor, plot një javë pas arratisjes sime." (Vepra, vëllimi 4, Prishtinë 2010, faqe 245-248)

2. Kush përgjigjet për krimet e gjenocidit në Kosovë?

Jusuf Gërvalla këtë artikull e merr nga "Zëri i Popullit" ku nuk figuron autori. Ky artikull është shkruar nga Enver Hoxha dhe gjendet gjithashtu në Vëllimin 33 të veprave të tij, në faqet 254-273

Nga "Zëri i popullit", 31 gusht 1966

Jusuf Gërvalla: "Në verë të vitit 1966, kur një pjesë naive e shqiptarëve me banim në Jugosllavi kishin zënë të besonin se me rënien e Rankoviçit perënduan gjithë të ligat, Partia e Punës e Shqipërisë doli me një analizë të hollësishme, që tregonte të kundërtën. Artikulli që po e sjellim këtu, as sot nuk ka humbur asgjë nga aktualiteti i vet. Përkundrazi, ai vlen edhe për situatën e sotme në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia."

(Shënim: Torturimet ndaj Shefqet Jasharit janë të bëra në vitin 1980 në atë vit kur Jusuf Gërvalla e përgatit këtë artikull për ribotim - Xh. D.)

Xhelati i popujve të Jugosllavisë J. B. Tito dhe klika e tij për të shpëtuar lëkurën e vet, për të shpëtuar sistemin e shtypjes, të shfrytëzimit e terrorit që po tronditet nga themelet, "sakrifikoi", bashkëpunëtorin më të ngushtë, Rankoviçin, të cilit i veshi të gjitha fajet dhe e ngarkoi me të gjitha dështimet, gabimet, krimet dhe disfatat e gjertanishme të regjimit titist.

Me shkarkimin e Rankoviçit nga të gjitha funksionet shtetërore dhe të partisë në Jugosllavi, në gjirin e bandës titiste shpërtheu haptazi lufta për pushtet midis klaneve kroato-slllovene e serbomadhe, që kanë përkatësisht përkrahjen e imperialistëve ... e të revizionistëve sovjetikë. Kjo është një shprehje e qartë e kontradiktave të thella klasore e nacionale që brejnë prej kohësh dhe po shembin mbretërinë e Titos, shprehje e kalbëzimit, degjenerimit dhe dekompozimit të sistemit titist.

Ngjarjet e fundit treguan edhe një herë se Jugosllavia titiste ndodhet në rrugë kryq. Tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit nga ana e klikës së Titos që e ktheu Jugosllavinë në një shtet borgjez kapitalist me të gjitha tiparet e veta, solli (dhe do të sillte medoemos) përçarjen në gjirin e saj, se ajo do të zhvillonte, sikundër që zhvilloi, nacionalizmin e

shovinizmin në mes pjesëtarëve të saj dhe, si rrjedhim, grupimet e ndryshme kombëtare në Jugosllavi që përpiqeshin të afirmoheshin, të forconin pozitat në shtet, në ekonomi, në ushtri, gjithsecili në kurriz të tjetrit dhe më i forti kundër më të dobët. U ringjall dhe u përcaktua rruga e rivaliteteve të vjetra nacionale-shoviniste serbo-kroate.

E tërë politika nacionale e klikës së Titos gjatë këtyre njëzet e ca vjetëve ndaj kombësive të ndryshme është karakterizuar nga shtypja e pabarazia, nga shfrytëzimi dhe diskriminimi ekonomik e kultural. Në mënyrë të veçantë titistët kanë zbatuar terrorin më të egër, më gjakatar, gjymtimet dhe asgjësimin fizik mbi popullsinë shqiptare në Jugosllavi. Popullsia shqiptare në Jugosllavi me shtypjen e përgjithshme që ka pësuar nga regjimi skllavërues, nga politika e tij shoviniste ç'kombëtarizuese është një aktakuzë e fuqishme, e pakundërshtueshme kundër rendit policor të Beogradit. Mbi kurrizin e saj janë bërë persekutime të tipit fashist, tortura fizike e shpirtërore, është zbatuar gjerësisht krimi i gjenocidit.

Shefqet Jashari: *"Hetimet zgjatën 7-8 muaj. Është vështirë të përmenden gjithë hetuesit që merrnin pjesë në maltretime. Veçmas kanë qenë të pashpirt Asllan Sllamniku, Sllavkoviqi dhe njëfarë Muharremi. Kam pasur rastin ta njoh edhe Abdullah Prapashticën, e cili e shikonte duke më rënë me këmbëve i pashpirti Asllan Sllamniku."*

Klika e Titos, pas plenumit të 4-të të së ashtuquajturës LK Jugosllave po përpiket me të gjitha mjetet të shpëtojë regjimin titist nga katastrofa, drejt së cilës po rrukulliset me shpejtësi duke u orvatur t'ja ngarkojë përgjegjësitë e rënda për gjendjen pa rrugëdalje të krijuar në Jugosllavi ish kryetarit të UDB-së, bashkëpunëtorit më të ngushtë të Titos, Rankoviçit. Në gjithë Jugosllavinë po bëhen përpjekje për ta vënë UDB-në, këtë organizatë famëkeqe gjakësorësh, më mirë në shërbim të regjimit titist, duke hequr prej saj, sa për sy e faqe, ndonjë kriminel tepër të kompromentuar. Kështu, me urdhër të Titos, u bënë disa "spastrime në gjirin e hierarkisë drejtuese të UDB-së." U hoqën disa ministra të punëve të brendshme në ato republika e krahina ku politika shoviniste e shtypjes dhe e çfarosjes nacionale ka qenë më e egër dhe ku mundësia e shpërthimit të zemërimit popullor ka vënë në rrezik vetë ekzistencën e regjimit titist. Kështu ndodhi në Serbi, në Mal të Zi, në Maqedoni, në Bosnjë e Hercegovinë e gjetkë. Kështu, sipas lajmeve të shtypit jugosllav, edhe në "krahinën" e Kosovës janë bërë ndryshime në udhëheqjen e UDB-së. Përgjegjësit e gjertanishëm të UDB-së në Kosovë Miça Mijushkoviç, Stanislav Gerkoviç e Sh. Kajtazi u shkarkuan duke u zëvendësuar nga të tjerë "specialistë" të UDB-së si Xhevdet Hamza e Dushko Ristiçi. Por popujt jugosllavë nuk mashtrohen. Aq më tepër nuk mashtrohet populli shqiptar në Jugosllavi. Kjo fushatë gjoja "spastrimesh" është një llustër për të mbuluar krimet e pashlyeshme të regjimit titist, për të larë nga përgjegjësitë klanin Tito-Kardel-Bakariç, që doli përkohësisht i fituar nga lufta për pushtet. Ajo bëhet, më në fund, për ta paraqitur Titon si "shpëtimtar të situatës", që gjoja kujdeset për të rivendosur "rendin e ligjshmërinë" e asgjësuar nga vetë sistemi titist dhe UDB-ashët fashistë, të cilët gjithmonë kanë vepruar nën drejtimin e Titos dhe klikës së tij.

Por asnjë manovër nuk e shpëton dot klikën titiste. Krimet e gjenocidit që janë zbatuar kundër popullsisë shqiptare të Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit, Maqedonisë e Malit të Zi, janë produkt i politikës së nacionalizmit e të shovinizmit të egër që ka zbatuar regjimi titist. Për ato duhet të përgjigjet në radhë të parë vetë Titua dhe, bashkë me të, e tërë banda e tij, që nga peshkaqenët e mëdhenj Rankoviç, i cili është i lyer gjer në gryk me gjakun e popullit shqiptar në Jugosllavi, Kardel, Bakariç, B. Jovanoviç, L. Kolishevski e të tjerë e deri tek ata më të vegjlit, si Dushan Mugosha, Veli Deva, Xhavit

Nimani, Ali Shukriu, Gjoko Pajkoviçi, Çedo Mujoviçi, Çedo Topalloviçi, Sinan Hasani, Xhevdet Hamza etj.

Partia e Punës e Shqipërisë, duke u nisur kurdoherë nga pozita të drejta parimore marksiste-leniniste, ka demaskuar me kohë dhe me vendosmërinë më të madhe të gjitha krimet e shëmtuara që banda tradhtare e Titos ka vazhduar të kryejë në dëm të popujve në Jugosllavi, dhe në mënyrë të veçantë në dëm të popullsisë shqiptare të atij shteti.

Ne kurrë nuk kemi ndërhyrë dhe nuk do të ndërhyjmë në punët e brendshme të Jugosllavisë. Përkundrazi është klika revizioniste e Titos ajo që e ka ngritur në sistem ndërhyrjen në punët e brendshme të Shqipërisë e të vendeve të tjera, ajo që për më se njëzet vjet nuk ka lënë gjë pa bërë në luftën e saj kundër popullit shqiptar, kundër PPSH, kundër RPSH dhe kundër rendit shtetëror e shoqëror socialist të vendosur në Shqipëri. Ndërhyrjet e klikës titiste në Shqipëri, veprimtaria e saj e vazhdueshme komplotuese e diversioniste, aleancat e saj me armiqtë më të tërbuar të popullit shqiptar, që nga fashistët, ballistët, zogistët e deri në imperialistët ..., monarko-fashistët grekë e revizionistët hrushovianë kundër PPSH, janë të njohura tanimë nga gjithë bota. Natyrisht, të gjitha këto ndërhyrje të klikës së Titos në punët e brendshme të Shqipërisë kanë hasur në kundërshtimin e vendosur të popullit tonë, janë bërë copë e thërrime nga vigjilenca dhe uniteti revolucionar i popullit shqiptar, që është bashkuar me partinë e tij, si mishi me kockën. Por në rast se klika revizioniste e Titos përcjell në varr me aq ceremoni e pompozitet provokues një tradhtar të tillë me damkë të njohur të popullit shqiptar e të PPSH si Panajot Plaku, aq më tepër ne i kemi të gjitha të drejtat të ngremë zërin tonë për të mbrojtur interesat jetike të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, e cila jeton nën terrorin e klikës së Titos e të UDB-së, nën rrezikun e përhershëm të çkombëtarizimit e të çfarosjes masive.

Krimet, vrasjet e asgjësimi fizik i popullsisë shqiptare të Jugosllavisë nga ana e klikës titiste si dhe politika për çkombëtarizimin e saj, përbëjnë një vijë sistematike, e cila ka filluar qysh në ditët e para të çlirimit dhe ka vazhduar e vazhdon me egërsi gjithnjë e më të llahtarshme edhe sot e kësaj dite. Këto krime e kjo politikë gjenocidi nuk mund të shlyhen nga kujtesa e asnjë njeriu të ndershëm në botë, e aq më pak në kujtesën e atyre që i kanë hequr dhe i heqin përditë mbi kurrizin e tyre. Kurrë nuk do të harrojmë popullsinë shqiptare në Jugosllavi ngjarjen e hidhur të vjeshtës së vitit 1944, kur banda Tito-Rankoviç arrestoi në Tetovë 10 000 shqiptarë dhe pushkatoi pa gjyq 1200 prej tyre, pa bërë fjalë për ata që vdiqën në burgjet. Cinizmi, egërsia, tërbimi për të çfarosur shqiptarët kanë karakterizuar gjithmonë veprimet e banditëve titistë. Kur një patriotësh shqiptarë protestoi në komandën titiste për këto krime, gjenerali Apostokli, komandant i atëhershëm i Brigadës së parë maqedonase, u përgjegj: "Kjo nuk është asgjë, është një pastrim që bëjmë. Këta që vriten duhet të qërohen". Dhe Vukmanoviç Tempo, i cili ishte i pranishëm atëherë, urdhëroi: "Akoma mbani njerëz nëpër kampe? Ata që kini për të pastruar, i qëroni shpejt". Ky urdhër i përfaqësuesit personal të Titos u zbatua me zell të madh. Në nëntorin e vitit 1944, mijëra fshatarë të pafajshëm shqiptarë u pushkatuan rrugëve të Maqedonisë, u dogjën në zjarr, u infektuan me qëllim dhe vdiqën nga tifua e morrit.

Brez pas brezi populli shqiptar i Jugosllavisë do të kujtojë me urrejtje të papërmbajtur, kundër klikës gjakatare titiste, masakrën e Drenicës të dimrit të 1944-ës, kur divizionet jugosllave, nën pretekstin e spastrimit nga elementët armiq, rrethuan zonën e çliruar të Drenicës dhe masakruan rreth 30 000 burra, gra, pleq e fëmijë shqiptarë. Ngjarja e Drenicës ishte një kasaphanë e vërtetë, një asgjësim sistematik e i organizuar i popullsisë së këtyre krahinave me kombësi shqiptare. Përse dhe me ç'qëllime titistët u sulën si bisha mbi popullsinë shqiptare dhe e mbuluan përsëri me gjak shqiptar Kosovën

e martirizuar? I vetmi faj i kësaj popullsie ishte kombësia e saj shqiptare dhe qëllimi i titistëve ka qenë dhe mbetet asgjësimi i popullsisë shqiptare në përgjithësi. Në këtë rrugë ata ecin pa u ndalur edhe sot e kësaj dite. Mbi 2000 shqiptarë në Mitrovicë dhe më se 1000 të tjerë në Gjilan, mijëra shqiptarë që shkuan si partizanë në brigadat jugosllave për të luftuar fashistët, u vranë me plumbin pas kokës, me urdhër të shtabit jugosllav. Qindra shqiptarë të tjerë të rekrutuar ushtarë nga jugosllavët, u pushkatuan prej tyre gjatë rrugës Prizren-Tivar. 1200 djem shqiptarë që kishin mbetur nga ky udhëtim tragjik, u pushkatuan në Tivar. Në Gorica të Triestes më shumë se 2000 shqiptarë nga Maqedonia, të mobilizuar në brigada pune, u mbytën me gaze helmuese. Asgjësimi fizik i shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi kryhej në mënyrë sistematike. Nga të dhënat e dëshmitarëve e të dokumentave del se më shumë se 40 000 vetë kanë rënë nga plumbi, bajoneta dhe helmi gjatë viteve 1944-1948.

Por ky terror asgjësues i klikës titiste kundër popullit shqiptar të Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit, Maqedonisë e Malit të Zi vazhdon edhe më i egër e më i organizuar pas vitit 1948. Udhëheqja revizioniste jugosllave, pas daljes së rezolucionit të Byrosë Informative më 1948 me të cilën u dënua tradhtia e Titos ndaj marksizëm-leninizmit dhe çështjes së socializmit, shtoi shtypjen e egër dhe të gjithanshme mbi popullsinë shqiptare të Jugosllavisë, mbi të cilën si gjatë viteve 1948-1950 ashtu edhe gjatë periudhës 1951-1965 shpërtheu vala e vrasjeve, arrestimeve dhe torturave më çnjerëzore.

Titistët me të gjitha mjetet nxitin vëllavrasjen midis shqiptarëve, ringjallin jo vetëm gjaqet e vjetra, por me kombinacione të ndryshme krijojnë gjaqe të reja. Për zgjerimin e tyre, oficerët e UDB-së, me anën e agjenturës, organizojnë rrëmbime dhe çnderime vajzash e grash kosovare dhe pastaj i shtyjnë të vriten, ndërsa ligjet, me qëllim inkurajimi, parashikojnë dënime të lehta. Kështu, ndërsa gjatë vitit 1965 në krahinën e Kosovës u kryen 41 vrasje dhe 74 plagosje, në gjashtëmujorin e parë të këtij viti u bënë 26 vrasje dhe 46 plagosje të rënda.

Por a und të shprehen me fjalë dhe të përshkruhen krimet dhe barbarizmat e pashembullta që klika titiste kreu në dimrin 1955-1956 kundër popullsisë shqiptare gjatë të ashtuquajturit "aksion të armëve". Për zbatimin me përpikmëri të operacionit kriminal dhe për drejtimin e operacioneve ndëshkimore Titua ngarkoi vetë Rankoviçin, formoi edhe një shtab, në të cilin ishin caktuar njerëzit më të sprovuar në barbarizma, shovinistë nga më të tërbuarit, kriminelë të regjur, që kanë lyer duart me gjakun e popullit shqiptar të Kosovës. Ky shtab udhëhiqej nga Dushan Mugosha, Gjoko Pajkoviçi, kolonel i UDB-së Çedo Mujoviç, Çedo Topalloviçi, Xhavit Nimani, Xhevdet Hamza, etj.

E para që pësoi goditjen e terrorit ishte krahina e Rugovës. Ekspedita ndëshkimore me oficerin e UDB-së Bogolub Rediçin në krye, me pretekstin e kërkimit të armëve, torturoi barbarisht pothuajse të gjithë burrat e kësaj krahine. Ata i rrihnin për vdekje me pendrak (kërbaç me peshë të një goditje prej 70 kg), i mundonin me anën e korrentit elektrik dhe i linin tërë natën të zhveshur e zbathur në dëborë. Pastaj i vinin në kolonë dhe i futnin në kanal, ku uji kishte ngrirë nga të ftohtit e madh që i kalonte të 15 gradët nën zero. Në të njejtën mënyrë vazhduan torturat e masakrat në Junik të Gjakovës, në Deçan të Pejës, në Suharekë të Prizrenit, në Llap të Prishtinës, në Vuçiternë, në Drenicë, Mitrovicë etj.

Shefqet Jashari: *"Hetimet zgjatën 7-8 muaj. Është vështirë të përmenden gjithë hetuesit që merrnin pjesë në maltretime. Veçmas kanë qenë të pashpirt Asllan Sllamniku, Sllavkoviçi dhe njëfarë Muharremi. Kam pasur rastin ta njoh edhe Abdullah Prapashticën, e cili e shikonte duke më rënë me kërbaç këmbëve i pashpirti Asllan Sllamniku."*

"Brenda një nate" – tregon ndër të tjera emigranti kosovar Brahim Rexh Binaku nga katundi Drenoc i rrethit të Gjakovës, – UDB-ja na mori ne 34 burra të Drenicës dhe na grumbulloi në kullën e Shaban Ibishit, ku gjatë natës oficeri i UDB-së Drago Kileviç me katër milicë serbë na rrihnin një nga një në dhomat e kësaj kulle me një llastikë që ishte i mbushur brenda me copa metali, me shqelma, me grushta, me qytën e pushkës dhe me dru. Pas kësaj UDB-ja në çdo tri-katër ditë merrte në pyetje secilin prej nesh dhe na thosh se çfarë kini bërë para 20 vjetëve.

Emigranti Din Sadrija nga Istoku i Pejës ka deklaruar:

"Në katundin Dubovc UDB-ja ka bërë tortura të tmerrshme nën pretekstin e armëve. Këto u bënë në postën e milicisë. Nga 50 shtëpi që ka katundi, për 5 muaj me radhë u torturuan 50 burra". Shumë ndër ta si rezultat i torturave, u vranë ose u sakatuan. Të marrin dëshminë e emigrantit tjetër Xhem Zek Haxhija, nga katundi Bogë i Rugovës – Pejë: "Në muajin janar të vitit 1956, oficerët e UDB-së të rrethit të Pejës Bogolub Radiç e Vllado Dazhiç për një ditë na grumbulluan 65 burra në dyqanin e katundit dhe filluan të na torturojnë. Torturat dhe poshtërimet e UDB-së nuk u shtrinë vetëm mbi ne burrat por edhe mbi gratë shqiptare, gjë që nuk kanë mundur ta bëjnë as sulltanët e Turqisë e as kralët e Serbisë e Malit të Zi në malësitë tona." Të tilla dëshmi mbi mizoritë barbare të kriminelëve titistë ka shumë.

Me qindra njerëz vdiqën në duart e xhelatëve të UDB-së, gjatë torturave ose pas disa ditësh. Shumë të tjerë, duke mos qenë në gjendje t'u rezistojnë torturave për të dytën e të tretën herë, i kanë dhënë fund jetës në mënyrë tragjike, duke u vrarë, mbytur, therur, duke u hedhur në pus, në lumë, etj. Kurse mijëra të tjerë mbetën të gjymtuar e të paafte për punë, një pjesë prej të cilëve kanë vdekur pas shumë vjetësh, një pjesë u çmendën dhe një pjesë po vuajnë akoma edhe sot nga plagët e shkaktuara qysh atëherë. Dhe për t'i vënë kapak veprimtarisë prej xhelatësh, autoritetet jugosllave lëshuan urdhërin kategorik që shqiptarët e gjymtuar gjatë torturave të vjetëve 1955-1956 të mos pranoreshin në asnjë mënyrë nëpër spitale për t'u mjekuar.

Të burgosurit shqiptarë që ndodhen në burgjet titiste, jetojnë në kushte çnjerëzore. Vetëm në burgun e Nishit ndodhen mbi 2000 shqiptarë të burgosur. Gjithashtu edhe në burgun e Sremska Mitrovicës, që është edhe ky burg qendror, ka mbi 700 të burgosur, një e treta e të cilëve i përkasin kombësisë shqiptare. Ndërsa gjysma e të dënuarve me akuza politike në Srem janë shqiptarë. Titistët i kanë kthyer krahinat shqiptare në Jugosllavi në burgje e kampe përqëndrimi të çfarosjes masive. Për këtë dëshmojnë burgjet në Nish e Srem, në Idrizovë të Maqedonisë, në Prishtinë, në Gjurakovc, në Suharekë, në Goli Otoku etj. Kudo shqiptarët në Jugosllavi jetojnë me frikën e pasigurisë për të nesërmen. Vdekja qëndron varur mbi kokat e tyre si shpata e Damokleut. Një i burgosur kujton me llahtarë: "Kam parë lloj-lloj krimesh kundër shqiptarëve, – thotë ai. – Kam parë krime të atilla që e therrnin njeriun në qafë si qengjin. Por ç'kam parë në burgun e Prishtinës një ditë nuk mund ta përshkruaj. Edhe tani tmerrohem kur mendoj ato krime dhe më rrok frika. Në burg kishin qenë tre shqiptarë. Njëri prej tyre ishte therur copa-copa, dy të tjerët ishin gjallë, por njërit ia kishin thyer duart dhe këmbët, ndërsa tjetrit ja kishin prerë një vesh, i kishin nxjerrë një sy dhe i kishin prerë njëren mustaqe me gjithë buzë."

-Në burgjet e Jugosllavisë, veçanërisht në Kosovë, ka hyrë fjala e fundit e teknikës moderne. Ato janë pajisur me dhoma frigoriferi dhe kaloriferi. Të arrestuarit i futin në dhomën e frigoriferit lakuriq me një temperaturë shumë gradë nën zero dhe i mbajnë atje për dy deri tri orë rrjesht. Pastaj i futin menjëherë në dhomën e kaloriferit, ku temperatura është mbi 30 gradë. Ky ndryshim i menjëhershëm i temperaturës e shkatërron organizmin e njeriut. Kjo torturë bëhet me qëllim që të dërmojë njerëzit nga ana shëndetësore dhe për

t'u thyer vullnetin që të pranojnë akuza të pabaza e të vihen në shërbim të titistëve. Të tilla dhoma ka në burgun e Prishtinës, Nishit dhe Idrizovës.

A nuk të kujton një trajtim i tillë që u bëhet të burgosurve shqiptarë në burgjet titiste, trajtimin e antifashistëve nëpër kampet e përqëndrimit të nazistëve gjermanë? Dhe s'ka si të ndodhë ndryshe për deri sa drejtori i burgut të Nishit ka kryer po këtë detyrë edhe në kohën e kralit e të pushtuesve gjermanë dhe tani të titistëve. Po kështu edhe drejtori i burgut të Sremit është i njohur si çetnik dhe profesionist për vrasje dhe tortura. Në të tilla burgje vuajnë persekutimet më të egra shkrimtari patriot kosovar Adem Demaçi,

Adem Dema-Demaçi: *"Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur."*

patriotët Ramadan Shala, Selajdin Daci, Shefqet Deçani dhe qindra patriotë të tjerë, të cilët bashkë me popullin shqiptar të Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit, Maqedonisë e Malit të Zi, nuk i janë nënshtruar dhe nuk do t'i nënshtrohen kurrë zgjedhës së Titos, dhunës çfarosëse, diskriminimit nacional e gjenocidit, që janë ngritur në sistem shtetëror nga regjimi titist. Vetëm shtatë ditë pas "kthesës" së Brionit mundi të ikte nga skëterra titiste dhe të vinte në Shqipëri, por me nofulla të copëtuara dhe ulok nga torturat e UDB-së së Budvës punëtori Hamit Fejzulla Sollova nga Vuçiterna. Ai u rrah në mënyrë çnjerëzore nga shtatë agjentë titistë vetëm, sepse, pas punës lodhëse të ditës, në pushimin e drekës në hijen e një parku, me dy shokë të tjerë, po këndonte një këngë në gjuhën amtare! Kjo qe e mjaftueshme për njerëzit e UDB-së që ta rrahin keq, t'i thyejnë nofullat dhe ta hedhin në rrugën e madhe. Raste të tilla ka me qindra edhe sot e kësaj dite.

Ne pyesim: Kush përgjigjet për këto krime të tmerrshme të gjenocidit, që për dhjetëra vjet me radhë, në mënyrë sistematike, kryhen nga regjimi titist kundër popullsisë shqiptare në Jugosllavi? A mos vallë vetëm Rankoviçi dhe banda e tij udbashe? Jo. Për këto e krime të tjera duhet të përgjigjen jo vetëm ekzekutuesit kryesorë, jo vetëm shërbëtorët, por në radhë të parë ustai i tyre në krime, xhelati Tito, dhe gjithë banda e tij kriminale.

Shefqet Jashari: *"Hetimet zgjatën 7-8 muaj. Është vështirë të përmenden gjithë hetuesit që merrnin pjesë në maltretime. Veçmas kanë qenë të pashpirt Asllan Sllamniku, Sllavkoviçi dhe njëfarë Muharremi. Kam pasur rastin ta njoh edhe Abdullah Prapashticën, e cili e shikonte duke më rënë me kërbac këmbëve i pashpirti Asllan Sllamniku."*

Një nga aspektet dhe objektivat e vijës së përgjithshme të politikës nacionale të klikës së Titos, veç vrasjeve e krimeve masive, ka qenë dhe mbetet çkombëtarizimi i popullsisë shqiptare të Jugosllavisë në çdo mënyrë e me çdo mjet. Për këtë qëllim ata kanë kombinuar masat administrative dhe terrorin policor me veprimtarinë e dëndur propagandistike, e cila synon dhe shprehet me mbytjen e frymës patriotike, me mohimin e autoktonisë ("në tokat tuaja jini të ardhur, prandaj duhet të ikni këtej"), me mënjanimin e masave shqiptare nga jeta politike dhe mohimi i kërkesave të tyre nacionale, me çoroditjen dhe degjenerimin me "opium" fetar dhe me ndezjen e armiqësive e të vëllavrasjeve sipas parimit imperialist "përça e sundo".

Gjatë periudhës së fundit dhjetëvjeçare propaganda titiste është përpjekur me të gjitha mjetet të "argumentoj" e të përligjë "integrimin" violent të masës shqiptare në grupet etnike serbe, maqedone, malazeze, shpërnguljen gjoja "vullnetare" të shqiptarëve në vende të huaja, orvatjet për të ndryshuar emrat e vendeve nga shqiptare në sllave, turqizimin e sforcuar të shqiptarëve dhe, nën presionin e privacioneve ekonomike, thithjen e shqiptarëve në thellësi të Jugosllavisë.

Parulla e "lirisë për të jetuar ku të duash" dhe "për t'u quajtur si të duash" përbën në esencë imponimin politiko-ekonomik të shqiptarit për t'u larguar nga vendlindja e tij dhe për të jetuar në thellësitë e largëta të Jugosllavisë, apo për të emigruar në Itali, Austri, Gjermani Perëndimore, etj., si skllav i kapitalit monopolist. Po për titistët çdo mjet është i përshtatshëm për të arritur qëllimin. Jo më kot dhe jo rastësisht Gjoko Pajkoviçi, anëtar i KQ të LK Jugosllave, ish sekretar i LKJ për Kosovën, shpalli si vijë zyrtare të detyrueshme "lirinë" për shqiptarët që të mohojnë kombësinë e tyre. Në sesionin e 2-të të legjislaturës së 3-të të këshillit krahinor të Kosovës ai pat thënë duke bërë aluzion të hapur për turqizimin, ose më mirë të themi çkombëtarizimin e shqiptarëve, edhe këto: "Askush nuk mund të më ndalojë të shkoj në shkollën turqishte në se dua vetë... Kjo është liria ime, unë mundem me qenë serb, turk, amerikan e ku ta di unë". Kozmopolitizmi i revizionistëve nuk ka kufi, por ky kozmopolitizëm shprehet në një drejtim shumë të caktuar: për t'u mohuar shqiptarëve, nën të ashtuquajturën liri për "të zgjedhur" çfarëdo kombësi tjetër, të drejtën për të qenë shqiptar.

Në fushën e ekonomisë titistët, për të detyruar masën shqiptare të shpërngulet për në thellësi të territorit jugosllav, përdorin gjerësisht presionin ekonomik dhe taksat shumë të rënda. Të gjitha krahinat shqiptare në Jugosllavi nga pikëpamja ekonomike janë shumë të prapambetura, pasi të gjitha objektet kryesore industriale janë përqëndruar kryesisht në Serbi, Kroaci e Slloveni.

Në Kosovë, Rrafshin e Dukagjinit dhe në krahinat e tjera shqiptare pushteti titist u ka dhënë rëndësi vetëm atyre sektorëve ekonomikë nëpërmjet të cilëve mund të shfrytëzojë pasuritë e mëdha të këtyre krahinave dhe këto pasuri i dërgon për në thellësi ose perëndim, duke sjellë varfërimin në masën shqiptare. Me të tilla metoda të shfrytëzimit tipik kolonialist veprohet në minierat e pasura të Trepçës, Devës, Goleshit, etj. Në këto miniera personeli administrativ dhe specialist është serbo-maqedon dhe malazez. Në qoftë se në këto miniera kërkon shqiptarin, atë e gjen në kategorinë e punëtorit të pakualifikuar. Edhe në ato pak objekte industriale dominon elementi sllav, p.sh. nga 400 punëtorët e fabrikës së duhanit në Gjilan, vetëm 90 janë shqiptarë.

Krahinat e banuara nga shqiptarët janë shndërruar në koloni që po shfrytëzohen intensivisht nga serbët, malazezët e maqedonët. Papunësia rritet me shpejtësi. Lidhur me këtë Slobodan Peneziqi, në Prishtinë, ka deklaruar qartë: *"Me gjithë përparimet, papunësia nuk zgjidhet, është nevoja që punëtorët të shkojnë në krahina të tjera"*. Kurse më vonë Dushan Mugosha, si sekretar i atëhershëm i LK të Kosovës, deklaroi hapur: *"Ne ende nuk jemi në gjendje me i sigurue punë një numri të madh njerëzish. Për çdo vit afër 7000 banorë të kësaj krahine (Kosovës) shkojnë me kërkue punë në viset e tjera të vendit, jashtë Kosovës e Metohisë"*. Ndërsa çdo vit 14000 krahë pune të rinj i shtohen armatës së të papunëve. Ky fenomen ka vazhduar edhe më vonë me të njëjtat ritme. Më 20 gusht 1966, Tanjugu njoftonte se në mbledhjen e veçes ekzekutive të Kosovës e Metohisë u konstatua se "numri i njerëzve që futen në punë në këtë krahinë pakësohet gjithnjë e më tepër dhe janë duke u pakësuar gjithnjë e më tepër mundësitë për marrjen në punë të punëtorëve të rinj. Sipas të dhënave statistikore, në fund të muajit maj të këtij viti kishte 5000 punëtorë më pak të futur në punë se në majin e vitit të kaluar."

Në këto rrethana shpërnguljet për në thellësi të Jugosllavisë, aktualisht, përbëjnë formën kryesore të çkombëtarizimit të krahinave shqiptare. Për rrjedhim, që nga viti 1958 dhe deri më sot, me dhjetëra mijëra banorë shqiptarë janë shpërngulur në krahinat veriore të Jugosllavisë, në Vojvodinë, në Kroaci, në Slloveni, veç faktit që deri tani, sipas pohimeve të shtypit, janë detyruar të braktisin vendlindjen e tyre për në Turqi më tepër se 250 000 shqiptarë nga Jugosllavia.

Shovinizmi i egër serbomadhi e antishqiptar i titistëve është çfaqur edhe në fushën e arsimit e të kulturës.

Populli shqiptar në Jugosllavi është i bindur nga eksperiencia e tij e gjatë se manevrat e sotme të klikës së Titos, pavarësisht nga fjalët e "ëmbela", pavarësisht nga maskat, kanë vetëm një qëllim: të forcojnë pushtetin e tronditur të klikës titiste, të forcojnë shtypjen nacionale, shfrytëzimin e çkombëtarizimit të Kosovës. Për popullin shqiptar në Jugosllavi, si për gjithë popujt e shtypur të Jugosllavisë, kriza e thellë që ka goditur klikën e Titos është një gjë që pritej, është pasojë e pashmangshme e vetë kontradiktave antagoniste që ziejnë prej vitesh në gjirin e bandës së renegatëve.

Por eksperiencia e hidhur shumëvjeçare nën sundimin e egër të bandës së Titos, e ka bërë popullin shqiptar të Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit, Maqedonisë e Malit të Zi, të jetë vigjilent, të hapë sytë e t'i bëjë katër për të mos u mashtruar nga demagogjia e kurthet e klikës titiste që kanë shpërthyer kohët e fundit në gjithë vendin.

Loja që po bën tani Titua me anën e një grushti tradhtarësh, si Veli Deva, Ali Shukriu, Xhevdet Hamza, etj., është një lojë shumë dinake dhe e rrezikshme. Por Titua dhe telallët e tij nuk mund të mashtrojnë njeri. Populli shqiptar i Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit, i Maqedonisë dhe Malit të Zi i njeh se kush janë titistët. Ai e di fort mirë se janë po këta Veli Devët, Xhavit Nimanët, Ali Shukrit e Xhevdet Hamzat, si dhe një grusht tradhtarësh të tjerë, që kanë bashkëpunuar me bishat e Titos në krimet e përgjakshme të Drenicës e të Tetovës, të Ulqinit e të Prishtinës, të "aksionit të armëve" e të Pejës, janë ata që kur popullsia shqiptare e atyre krahinave ishte e përgjakur dhe e copëtuar nga klika e Titos-Rankoviçit, ata e lyejnë dhe e zbkuronin regjimin xhelat të Titos. Populli shqiptar i këtyre krahinave nuk do të bjerë në lakun e ri të mashtrimeve të këtyre tradhtarëve dhe padronit të tyre Titos, Kardelit, Bakariçit etj.

Sado të egra, cinike dhe dinake të jenë masat e sundimtarëve revizionistë të Beogradit, ata kurrë nuk do t'ja dalin në krye të çkombëtarizojnë, të çfarosin e të asgjësojnë popullsinë shqiptare të Jugosllavisë. Ky popull, i cili u qëndroi me heroizëm të mrekullueshëm valëve të tërbuara të pushtuesve otomanë e sllavë gjatë shekujve dhe ka ruajtur me guxim e vendosmëri heroike gjuhën, traditat, zakonet, kulturën e vet, personalitetin dhe vitalitetin e tij, të gjitha karakteristikat e veçoritë e tij kombëtare, përballë të gjithë orvatjeve çkombëtarizuese e asgjësuese, një popull i tillë nuk mund të nënshtrohet e të çfaroset kurrë. Ai është i përjetshëm dhe do të fitojë. Do të vijë dita që Titua e banda e tij pa tjetër do të japin llogari deri në fund për krimet e tyre të përbindshme, për gjenocidin e pashembullt në Kosovë.

(Artikull i gazetës "Zëri i Popullit", 31 gusht 1966. Ky artikull nën kujdesin e Jusuf Gërvallës u ribotua në gazetën Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq Popullor, Janar 1981, faqe 4)

3. ZËRI I POPULLIT - ZË I TË GJITHË SHQIPTARËVE

Nga Jusuf Gërvalla, shkurt 1980


Kërcënimi Sovjetik për intervenimin ushtarak në Jugosllavi, kumboi në Shqipërinë Socialiste si kushtim për t'u ardhur në ndihmë proletariatit dhe popujve të Jugosllavisë. Për shqiptarët që ndjekin me admirim politikën e vendit të tyre amë, RPS të Shqipërisë, kjo është rruga e vetme që shpie kah lufta e pritur për çlirimin social e nacional nga revizionizmi titist dhe kah bashkimi kombëtar me vendim amë.

Fill pas pushtimit të Afganistanit në dhjetorin e kaluar, në botë piku fjala se Bashkimi Sovjetik (BS) s'e ka fort larg t'i shtrijë kthetrat edhe përmbi Jugosllavinë. Dhe bota, si një masë amorfë, e rënduar nga përgjumja kapitaliste, kolonialiste dhe revizioniste, ka zënë të merret me shkaqet dhe me arsyet e BS për një intervenim ushtarak në Jugosllavi, në vend që ta shtrydh mendjen se si të pengohet ky rrezik i prapët për popujt e Jugosllavisë.

Vetëm një vend i vogël krenar, Shqipëria Socialiste, në vend që të merret si të tjerët me dokrra, e shpalli botërisht me anën e Organit "ZËRI I POPULLIT" gatishmërinë e Qeverisë dhe të popullit shqiptar për t'u ardhur në ndihmë popujve të Jugosllavisë në rast intervenimi ushtarak nga ana e BS. Mendja e urtë mund të nxjerrë menjëherë përfundimin se Shqipëria Socialiste, që kultivon një vigjilencë të pashembullt lidhur me ngjarjet në botë, i ka të qarta arsyet e kërcënimit sovjetik dhe është e vetëdijshme se cilën anë do ta marrë për vete.

Kohë më parë, prijësi i madh i popullit shqiptar, Shoku ENVER HOXHA ftonte jo vetëm popujt tjerë, por edhe vet proletariatin sovjetik: "...ta shkatërroni regjimin diktatorial fashist, që fshihet me sllogane mashtruese. Ju duhet ta dini se ata që ju drejtojnë janë fashistë, shovenistë dhe imperialistë. Ata ju përgatisin si mish për top, për një luftë të ashpër imperialiste, për të vrarë popujt dhe për të djegur e shkatërruar vende, që shpresonin shumë tek atdheu i Leninit dhe Stalinit.... Armatimet dhe ushtria në BS s'janë më në duart e popujve sovjetikë dhe nuk shërbejnë për çlirimin e proletariatit botërorë, por përkundrazi, ato janë destinuar për të shtypur popujt sovjetikë e popujt tjerë." (E. Hoxha: Me Stalinin, Tiranë 1979, f. 41-42)

Në ngushticën e madhe të një intervenimi ushtarak sovjetik, për popujt e Jugosllavisë do të qeleshin disa fronte: mposhtja e dominimit të kapitalit perëndimor (me 35 miliardë dollarët që i ka borxh Perëndimit, Jugosllavia, në bazë të numrit të banorëve, është vendi me më së shumti borxhe në botë); shembja e regjimit të klikës hegjemoniste e social-shoveniste të Beogradit, e cila popujt e Jugosllavisë i ka futur në një rrugë të pakrye; dhe lufta e vështirë me armë kundër kuçedrës evro-aziatike ruse. Dhe gjithë këto fronte popujt e Jugosllavisë janë të shtrënguar t'i përballojnë vetëm me forcat e veta, të cilat në këtë çast janë të dërmuara fare nga mjetet e egra të pushtetit anti-popullor revizionist në Jugosllavi që tridhjetë e pesë vjet.



Jusuf Gërvalla

Për qeverinë dhe popullin shqiptar, të mbledhur grusht rreth Partisë së Punës të Shqipërisë (PPSH), ky rrezik i popujve fqinjë u bë kushttrim i hapur për t'i ardhur në ndihmë proletariatit të Jugosllavisë dhe për të treguar edhe një herë, si vazhdimisht brenda këtyre 35 vjet jete në socializëm të mirëfilltë, konsekuencën e pashembullt ndaj idealeve të larta proletare, marksiste-leniniste.

Historikisht, në rrethana të caktuara, "bashkimi i armëve (shqiptare) me aleatët ballkanikë ishte vetëvrasje" (A. Puto: Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914, Tiranë).

Dhe "ZËRI I POPULLIT", që i dha zë aktit fisnik të mbrojtjes së të drejtave të popujve në emër të internacionalizmit proletar, pa shikuar rrezikun me të cilin e ngarkon veten ka pasur parasysh këtë fakt. Shqipëria s'i harron masakrat që kanë bërë mbi popullin shqiptar ushtritë dhe xhandarmëria serbe, para njëqind vjetësh, kur shqiptarët u përzunë me mënyrat më barbare nga tokat e veta poshtë Nishit; masakrat e pa para të ushtrive serbe në Prizrenin e porsaçliruar nga forcat e Lidhjes Shqiptare, kur serbët gjetën shesh për të bërë kërdinë mbi pleq, gra e fëmijë, mbi të plagosurit shqiptarë të strehuar në konsullatën Austro-Hungareze në Prizren (Pierre Loti: "Tourquie ago nisante", Paris, Calman-Revy); egërsimin sllavë të serbeve e malazezëve (të shtyrë nga Rusia, e cila sot po kanoset t'i pushtojë vetë po këta serbe e malazezë) mbi popullsinë shqiptare tamam në kohën që këta, e kishin çliruar pëllëmbë për pëllëmbë vendin e tyre nga Turqia, më 1912, dhe kur Pashiqi i Serbisë dhe Nikolla i Malit të Zi, që e gjetën Shqipërinë të dërmuar nga lufta me turqë, hynë dhe shkretuan të thuash gjithë tokat shqiptare dhe, më në fund, me

dredhite e veta e me anën e dredhisë së madhe ruse, atdheut tonë ia shkëputën Kosovën, viset shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi e në Serbi; mizorit e pastajme të mbretërisë Jugosllave, e cila i kishte dhënë vetes për detyrë të zhdukte nga faqja e dheut popullin shqiptar...

Akti i sotëm i vendit tonë amë, në sytë e të gjithë shqiptarëve dhe botës bëhet edhe më madhështor kur dihet fare mirë se gjatë këtyre 35 viteve të pushtetit popullor shqiptar, Partia e Punës ndoqi me interesim jetësor sidomos mizorit e mëvonshme jugosllave, ato të PKJ, e cila “ndaj popullsisë së Kosovës ndoqi një politikë nacional-shoveniste, që ishte e njëjtë me politikën e Mihajloviqit dhe Nediqit”(Që në fund të vitit 1945,-thotë Sh. Ballvora”, Tiranë 1968,-kur Jugosllavia kishte ende vise të pushtuara nga forcat e fashizmit gjerman, grupe udhëheqës i PKJ dërgoi brigada dhe divizione të tëra për të masakruar popullin e Kosovës dhe ushtroi një terror që ia kalonte atë që kishin përdorur ushtarët e monarkiste serbe në periudhën e mëparëme”) Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, e cila shënuar me interesim të gjallë dhe me indinjatë të thellë çdo akt të diskriminimit nacional, social e politik të shqiptarëve në Jugosllave nga ana e revizionizmit jugosllav (dëbimin e programuar shtetëror të shqiptarëve nga tokat e tyre dhe popullzimin e atyre tokave me kolonistë serbë, malazezë e maqedonas; përpjekjet këmbëngulëse të Jugosllavisë për të bërë një diferencim artificial gjuhësor, historik e kulturor ndërmjet shqiptarëve në RPS të Shqipërisë dhe atyre në viset shqiptarëve në Jugosllavi, me qëllim që këtyre viseve t’u ndërrohet fizionomia etnike, sidomos me ndihmën e presioneve të vazhdueshme nacional-shoveniste për shpërnguljen, zhdukjen fizike ose asimilimin e shqiptarëve; vjeljen e begative të mëdha e natyrore të Kosovës në dobi të Serbisë e të tjerave republika të Jugosllavisë, e në dëm të zhvillimit të mbarë ekonomik të popullit shqiptar në Kosovë...), pra, RPS e Shqipërisë i ka pasur parasysh të gjitha këto kur shfaqti gatishmëri t’u vinte në ndihmë popujve të Jugosllavisë kundër tërbimit rus. Është ideali i lartë proletar, solidariteti i pashembullt klasor e fqinjësor, mungesa e ndjenjës së praptë të revanshizmit, dhe jo harresa e fakteve, që Shqipërinë Socialiste e bën të dallojë mirë pafajësinë e popujve të Jugosllavisë nga egërsimi sllavomadh dhe nga tradhtia e madhe e qeverisë revizioniste e nacional-shoveniste të Jugosllavisë.

Më në fund, vetëvrasja e vërtetë do kish qenë bashkimi i armëve me krerët revizionist jugosllavë, që po veprojnë me tërbim për t’ua ngrënë kokën shqiptarëve liridashës të Kosovës: nga lufta e këtej, organet fashiste të sigurimit jugosllavë kanë hedhur në burgje më se pesëdhjetë grupe e organizata liridashëse të patriotëve shqiptarë, që një mënyrë a në një tjetër u përpoqën të heqin qafe skllavërinë në Jugosllavinë titiste. Sot, po këto organe, me një tërbim më të madh se kurrë, i kanë një burgosjeje në masë të shqiptarëve, që pati rezultat mbi 2000 të burgosur, femra e meshkuj, mbi të cilët po ushtrohet një terror i egër me metoda policore që ua kalojnë metodave më çnjerëzore fashiste.

Partia Punës e Shqipërisë, kurrë nuk është kursyer me kritikën e veta ndaj regjimit antipopullor dhe antishqiptar të klikës titiste-rankoviqiste. “Për klikën e Beogradit, thotë vet shoku Enver Hoxha, Kosova është një pikë shumë e dobët, prandaj ajo ushtron në Kosovë një terror të madh...Elementi shqiptar goditet posaçërisht në Jugosllavin titiste, sepse udhëheqësit e tanishëm jugosllavë i njohin mirë tiparet revolucionare të popullsisë shqiptare të atjeshme, e dinë mirë se këtë popullsi problemi nacional gjithmonë ka qenë dhe mbetet në plagë e hapët që kërkon shërim.” Por aq sa ishin të rrepta kritikën ndaj regjimit revizionist jugosllavë, aq ishte e madhe dashuria dhe keqardhja e shqiptarëve për popujt e Jugosllavisë.

Është pra e vetë kuptueshme se, sa për klikën titiste, nuk do çanin kokë Qeveria dhe populli shqiptar, për çfarëdo intervenimi që të jetë fjala. Vaftë në djall Titoja (nëse nuk ka vdekur) me këlyshët e tij, të cilët qe 35 vjet po përdhosin idenë e madhe komuniste e popujt e Jugosllavisë po i privojnë nga e drejta e tyre e pamohueshme për një zhvillim të mbarë e të vërtetë socialist, për të cilin ata patën dhënë gjakun e vet të shtrenjtë gjatë luftës së fundit!

Duke qenë të vetëdijshëm për të gjitha këto, krerët dinak jugosllavë i dhanë hov edhe më të madh veprimtarisë së tyre të errët, tamam në çastin që popujt e udhëhequr prej tyre u ndodhën për ballë rrezikut rus, në vend që ti gëzohen ndihmës së pa rezervë të fqinjit të parë. Në fillim, ata e trumbetuan me të madhe në shtyp, radio e televizion artikullin e “Zërit të popullit”. Nuk harruan, porse të heqin si me thikë ato pjesë të artikullit, që lidheshin me interesimin vital të RPS të Shqipërisë për fatin e hidhur të shqiptarëve në Jugosllavi. Pos kësaj, si pas zakonit të dhelpres, ata edhe këtë rast e shfrytëzuan për të mbjell mjegull te popullsia shqiptare e këtushme. Nëpërmjet agjentëve të regjur në punë antishqiptare, krerët jugosllavë dhe renegatët kosovarë (të cilët e shkelën dinjitetin e tyre si shqiptar, që do ishin dhe u bënë sllavë të jugut) i dhanë krah parullës absurde sesi, me aktin e gatishmërisë për t’i dhënë ndihmë të pakursyer Jugosllavisë përballë rrezikut sovjetik. Qeveria shqiptare dhe Partia e Punës e Shqipërisë paskan ndërmend të rreshtohen krah për krah me revizionizmin jugosllav!

Kjo është edhe një shenj e qartë se tradhtia revizioniste jugosllave ndaj interesave të popujve brenda kufijve politik të saj dhe jashtë tyre, është e papërmirësueshme.

Kur u pa se shqiptarët e Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare në Jugosllavi nuk e hanin dot këtë pemë helmuese, sepse vetëdija e ngritur kombëtare dhe klasore ata i bënë të zgjedhin të vetmen rrugë të mbarë, atë të bashkimit me vendin amë Shqipërinë dhe të përkrahjes pazezervë të rrugës së Partisë së Punës me Enver Hoxhën në krye, revizionizmi jugosllavë e hoqi maskën dhe i zbuloi këmbët e veta: A. Gërlaçkovi, një funksionar i lartë i revizionizmit jugosllavë dhe renegat maqedonas, deklaroi se Jugosllavia as e ka kërkuar dhe as e ka për gjë ndihmën që po i ofron një parti dhe një vend, që deri më tash e ka kritikuar ashpër politikën jugosllave!

Kjo nuk është ndonjë çudi e madhe. Regjimet antipopullore jugosllave ia kanë njohur turrin shqiptarit të armatosur, të cilit lufta e drejtë për trojet e veta ia dhjetëfishon fuqinë. Prandaj, ky regjim ende ushqehet me ëndrrën e moçme sesi, në rast të një lufte të re, përsëri shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptarët në Jugosllavi do t’i mobilizojnë e do t’i dërgojnë për luftime në Srem e në slloveni, në mënyrë që çetnikëve serbë e malazez t’u hapë shesh për të ardhur e për të masakruar përfundimisht popullsinë shqiptare në viset e saj. Duke ditur për borxhet e mëdha ndaj shqiptarëve revizionizmi jugosllavë do të pranonte gjithçka tjetër më parë sesa kosovarët e mobilizuar dhe kalimin e Ushtrisë Shqiptare këndeje kufirit, pa marrë parasysh se u vjen për ndihmë popujve të qeverisur prej tij.

Ndërkaq ne, luftëtarët e lirisë, duke njohur armikun dhe aspiratat e tij, duhet përqendrojmë vëmendjen edhe në pikat e tij të dobëta, në mënyrë që lufta e ardhshme, e pashmangshme, të na shkojë mbarë. Ky është për ne rasti më i volitshëm të heqim dorë nga çdo ndjenjë revanshizmi, të bëjmë edhe ne dallimin e domosdoshëm ndërmjet popujve jugosllavë, të pa fajshëm për krimet e ushtruara mbi ne, dhe qeverisë nacional-shoveniste të Beogradit; të armatosur vetë dhe të bashkuar me forcat e armatosura të Nënës Shqipëri, ne do të mund të realizojmë dy qëllime të larta-t’i ndihmojmë popujt e Jugosllavisë për të mposhtur regjimin e tyre tradhtar dhe për ta përballur sa më mirë egërsimin rus, e në anën tjetër, vetë t’i realizojmë aspiratat tona shekullore, çlirimin e tokave shqiptare nga zgjedha jugosllave dhe bashkimin e tyre me vendin tonë amë, Republikën Popullore të Shqipërisë.

Të mos presim, pra, të hutuar-se hutesa mund të na kushtojë shfarosje- por, duke ditur qëllimet e errëta të klikës titiste, të mblidhemi edhe ne, shqiptarët në Jugosllavi, dhe të ndjekim me besnikëri hapin e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të vëllezërve shqiptarë të ndjekim rrugën unike, e cila do të na shpjerë pa dyshim fitore! Shkurt, 1980 (Botuar në gazetën Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq, pranverë 1980)

4. Lajmërimi i Pranverës '81 në *Lajmëtarin e lirisë*

Në vitet e fundit është shkruar shumë për demonstratat e vitit 1981, d.m.th. me dekada të tëra pas mbarimit të tyre. Me gjakftohtësi, dhe me perspektivën e distancës kohore janë bërë revidime të qëlluara që përputhen me të vërtetën historike. Kuptimi i drejtë i të së kaluarës është bazë e mirë për t'u orientuar në të tashmen. Megjithatë janë të shumtë ata të cilën nuk janë në gjendje ta kuptojnë të kaluarën por servojnë gënjeshtër nga më skandalozet.

Shkrimi i mëposhtëm i Jusuf Gërvallës dallohet nga të gjitha shkrimet që janë bërë deri me sot. Ky është shkrim i një lloji të veçantë ashtu siç janë edhe punimet tjera të tij. Ata që kanë pasur shtet, që e kanë pasur shërbimin informativ, që kanë pasur diplomatë, që kanë pasur APARATIN e shtetit, në disa raste janë deklaruar se Pranvera e vitit 1981 i ka befasuar. Por kjo Pranverë nuk e ka befasuar parashikuesin, largpamësin dhe Lajmëtarin Jusuf Gërvalla, i cili, i shkëputur nga pjesa kryesore e shokëve, nga trualli, pa diplomatë, vetëm, në studion i tij të punës, pa aparat shtetëror, por me një aparat tjetër - me një radioaparat të fuqishëm me valë të shkurta, dhe me APARATIN edhe më të fuqishëm analitik të trurit të tij, i deshifron e dekodon me shpejtësinë e vetimës lajmet e marra, duke i kthyer në rreze të gjata drite e veprimi, për t'i treguar popullit ngjarjet që i ka në prag.

Jusuf Gërvalla: *"Mirëpo kjo pakënaqësi, që vetvetiu përbën një nga forcat kryesore të luftës së ardhme, implikon para së gjithash edhe nevojën e përdorimit të saj me kohë e me vend. Sepse, si forcë goditëse, ajo ka një cilësi të atillë, që nuk i shfaqet kujt do. Ajo do t'i shfaqet vetëm atij që është i denjë për luftën e vendosur dhe serioze, deri në fitore, pa marrë parasysh vështirësitë dhe sakrificat. Prandaj, si bij revolucionarë të popullit tonë, ne, në radhë të parë, duhet ta kemi parasysh pakënaqësinë e madhe të popullit dhe të hyjmë në esencën e saj e t'i përgatisim asaj terren të vërtetë për grushtin e saj të fuqishëm."*

Këtë largpamësi që i shfaqet Jusufit, e vërteton më së miri artikulli i mëposhtëm që ka të bëjë me një ngjarje pikërisht para 30 vitesh, më 21 shtator 1980, në Prishtinë.

Dokumenti i gatishmërisë

Nga Jusuf Gërvalla

Gjithë ata shqiptarë që - duke harruar demonstratat historike të vitit 1968 - ka harruar ç'është forca e masës së revoltuar, këto ditë pati rast të përkujtohet edhe njëherë, me demonstratat e futbolldashësve të Prishtinës, më 21 shtator.

Vendi dhe preteksti i tyre mund të jetë i pakuptim në dukje të parë: reagim për një padrejtësi sportive në fushën e futbollit. Por, duhet të jesh fare jashtë realitetit shoqëror kosovar, nëse çështjen e kufizon në këtë mënyrë. Edhe fizikisht, demonstratat kaluan

jashtë fushës së sportit, u përhapën në rrugët e Prishtinës dhe zgjatën deri natën vonë. Vallë, një padrejtësi e thjeshtë sportive mund t'i shtynte qytetarët tanë që "tërbimin" e tyre ta derdhnin mbi çdo automjet, të madh a të vogël, që nuk kishte targë të Krahinës sonë?! A s'i përkujtojnë autobusët dhe veturat e përmbysura, demonstratat e 1968-ës?!

Ky dokument i gjallë i pakënaqësisë së masave, pos që i dha grusht qeverisë së Beogradit, duhet t'i bëjë të mendojnë pak më thellë edhe forcat tona revolucionare, sidomos pararojën e tyre: në qoftë se nuk evidentohet pakënaqësia e përgjithshme, në qoftë se ajo nuk shfrytëzohet në mënyrë të organizuar për qëllime revolucionare, atëherë s'do mend se pakënaqësia e tillë, si potencial që kërkon shkarkim të domosdoshëm, do të manifestohet patjetër në mënyrë spontane. Dhe dihet se në raste të, vendi dhe preteksti s'kanë si të jenë të qëlluar, domethënë në mënyrë vitale të nisin dhe të zhvillohen atje dhe ashtu si e do puna.

Ky shpërthim ndodhi në një kohë të përshtatshme, kur disa elemente të revolucionit tonë, të tërhequr nga ofensiva për shkak të presionit të madh policor e politik të pushtetit, kishin zënë të përqafonin aty-këtu edhe ide disfatiste e kapitulluese. Një pjesë e inteligjencës sonë donte të thoshte - natyrisht, jashtë ligjeve të dialektikës - sesi te populli ynë qenkan vërejtur edhe shenja përgjumjeje dhe mosgatishmërie për t'iu përgjigjur pararojës revolucionare. Ata e harrojnë traditën shekullore luftarake të popullit shqiptar dhe, nga hutesa e vet, bëjnë llogari të gabuara dhe veprime të rrezikshme: dyshojnë dhe përhapin dyshime lidhur me situatën reale të ne dhe me shpirtin luftarak të popullit tonë në këto çaste të vështira robërie e mjerimi.

Tani, jo me fjalë e me shtrydhje sterile të trurit që të shpie në udhë të pakrye, po me një vepër të shkëlqyer të manifestimit konkret të forcës së popullit, këto demonstrata na e tërheqin veshin qortueshëm dhe sikur na thonë fare qartë se kush ka të drejtë të dëshpërohet: inteligjenca me popullin, apo populli me inteligjencën? Pakënaqësia dhe revolti i shtresuar i masës në rrethana të caktuara historiko-shoqërore janë, pa dyshim, të barasvlershme me potencialin e pafrenuar të rrymës së rrëmbeshme të lumit. A do të derdhet kot ai potencial, apo do t'i lëvizë turbinat e revolucionit, varet nga djalëria pararojë, pjesë e pandashme e së cilës është inteligjenca popullore.

S'ka revolucion pa popullin dhe s'ka popull jorevolucionar. Gjithçka varet nga kushtet objektive, në të cilat do të shpërthej ose jo revolucioni. Kurse qielli ynë - siç e tregon realiteti objektiv dhe siç e thonë analizat e thella shkencore marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të udhëheqësit të madh shqiptar Enver Hoxha - është i stërngarkuar me elektrizim të fuqishëm revolucionar.

Për revolucionarin e vërtetë është e qartë se shkarkimi i këtij elektrizimi do të bëhej më me vend e më me efekt po të kishte udhëheqës të denjë revolucionarë, që do të viheshin në ballë të masave të revoltuara për t'u prirë atyre kah fronti i shenjtë i çlirimit të tokave stërgjyshore dhe i bashkimit me Atdheun tonë të lirë, Shqipërinë socialiste.

Marrë nga Lajmëtari i lirisë, nr. 2, tetor-nëntor 1980, faqe 6

5. ZËRI I KIÇO FOTJADHIT

Pjesë nga një intervistë me Albert Zholin

Në vitin 1981 filluan ngjarjet në Kosovë që kërkonin pavarësinë dhe Shqipëria mbajti qëndrimin e saj me disa artikuj shumë të fuqishëm. Një prej atyre artikujve ka qenë i marsit i vitit 1981. Artikulli e kishte titullin "Kush e nxit armiqtësinë midis popujve të Jugosllavisë". Ishte historik-shkencor-politik-ideologjik. Dikush e lexoi nga spikeret në radio e lexoi, por udhëheqja dhe nuk e pëlqeu. Dhe i thanë se i vetmi që mund ta lexojë mirë është Kiço Fatjari. Më morën dhe më dhanë tekstin. E lexova disa herë vetëm. Pastaj

në radio. Kisha emocione të jashtëzakonshme pasi ishte një artikull bombë, patriotik. Të jepte zjarr. Aty ishte shkëlqimi im atë ditë që u transmetua ajo. Ngjarja për të cilën unë flisja më ngacmoi shumë. Unë bëra një lexim artistik të përkryer, të gjithë që e dëgjuan e pëlqyen shumë. Ngjarjet e jashtëzakonshme kanë lexime të jashtëzakonshme. Ajo ishte ngjarje kombëtare. Isha shumë i zhytur në ato materiale. Unë lexoja dhe dridhesha i tëri dhe më rrënoqetjesh mishi. Pas atij momenti të gjithë materialet që ishin për Kosovën kalonin nëpërmjet meje. Unë dashje pa dashje jam quajtur spikeri i Kosovës. Më vinin urime nga populli i Kosovës, disa mendonin se isha kosovar, pastaj morën vesh që unë isha himarjot...

A keni marrë ndonjë vlerësim nga Enver Hoxha?

Kur lexoja artikujt për ngjarjet e Kosovës më vëzhgonte shumë drejtori i radios Agim Papaproko që ishte gazetar dhe drejtor i radios në atë kohë. Në studio, jo përballë meje por anash, rrinte Çajup Rusmaili. Unë tregoja artin tim të të folurit. Kam lexuar edhe nekrologjinë e Naserit dhe të Ho Shi Minit, dhe njoftimin për vrasjen e Mehmet Shehut dhe nekrologjinë e Enver Hoxhës në radio. Por leximet për Kosovën ngelen ndër më të dashurat dhe ato me më përgjegjësi për mua. Kur dal një ditë nga studio i lodhur Çajupi më thotë se më ke bërë një nder shumë të madhe se një herë në tre ditë më merr Enver Hoxha në telefon dhe më thotë se **“bravo ju qoftë për ato artikuj, ai djalë lexon shumë bukur dhe përgëzojeni atë djalë. Ai djalë nuk lexon, por këndon këngë patriotike”**.

Ti e ke dhënë lajmin e vdekjes së Enver Hoxhës?

Lajmin e kam dhënë në radio (në TV vetëm në mëngjes). U kërkua që lajmi të lexohej çdo dy orë. Vonë kam takuar të burgosur politik, personalitete, që më kanë thënë se ti na ke bërë të qajmë neve në burg. Ai neve na ka futur në burg padrejtësisht, por ti me mënyrën tënde të leximit na detyrove të qajmë. Unë e trajtova si një poemë poetike lajmin. Një ngjarje e jashtëzakonshme ka lexime të jashtëzakonshme.

6. PSE U PËRDOR DHUNA POLICORE DHE TANKET KUNDËR SHQIPTARËVE NË KOSOVË?

("Zëri i popullit", 8 prill 1981)

Shtypi e radiotelevizioni jugosllav kanë ngritur një fushatë të jashtëzakonshme dezinformimi rreth shkaqeve që shtynë studentët e punonjësit kosovarë të dalin në demonstratë. Ajo që bie në sy menjëherë në fjalimet e udhëheqësve e në artikujt e pafund që mbushin faqet e gazetave jugosllave, sidomos të atyre të Beogradit, është toni i ngritur shovinist dhe mungesa e plotë e çdo analize realiste e qëndrimi objektiv ndaj ngjarjeve tragjike të Kosovës. Jo vetëm hijet rankoviçiane, por edhe shpirtrat e vjetër të karagjorgjeviçve janë ngjallur. Ato veprojnë tashti me kërbac e me tanke që popullsisë shqiptare në Jugosllavi t'i mbytet zëri, që ajo të goditet fort, të shtypet e të nënshtrohet.

Por, pavarësisht nga ç'thuhet e ç'shkruhet në Jugosllavi, shkaqet e vërteta të demonstratave të Kosovës, përmbajtja e tyre, kërkesat që u paraqitën në to nuk mund të mbulohen me frazeologjira të rreme dhe të zhurmshme, siç veprojnë shtabet e Beogradit. Çdo njeri objektiv, çdo vëzhgues i paanshëm e shikon dhe e kupton menjëherë se në bazë të ngjarjeve të fundit në Kosovë qëndrojnë prapambetja e madhe e kësaj krahine, varfëria e mjerimi i njerëzve të saj, mungesa e lirive demokratike dhe e të drejtave politike. Demonstratat janë shpërthimi i një gjendjeje të padurueshme që vazhdon prej dhjetëra vjetësh, është errësimi i mëtejshëm i perspektivës për të dalë nga kjo gjendje.

Sipas të dhënave që jep shtypi jugosllav, të ardhurat kombëtare për frymë në Kosovë janë 6 herë më të ulëta se në Slloveni, rreth 5 herë më të ulëta se në Kroaci dhe

3,5 herë më të ulëta se në Serbi. Vitet e fundit ritmi i rritjes së prodhimit industrial në Kosovë ka qenë 4-5 herë më i vogël se ai i Serbisë. Shkalla e papunësisë është 20 herë më e madhe se në Slloveni dhe 2,5 herë më e madhe se në Serbi. Numri i punëtorëve që kanë emigruar për punë jashtë Kosovës e Jugosllavisë i kalon të 110000 vetat përveç 70000 vetave, shumica punëtorë të kualifikuar... Në një fjalim të mbajtur në Prishtinë, V. Gjuranoviç, Kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Jugosllavisë, ka thënë: "Zhvillimi i Kosovës po ngec... Shihet qartë se politika e zhvillimit të shpejtuar të krahinës nuk po realizohet sipas përpjesëtimeve të parapara me plan. Përkundrazi, diferenca ndërmjet Kosovës dhe pjesëve të tjera të vendit po ashpërsohet... Investimet ekonomike në Kosovë janë 43 për qind më të vogla se mesatarja e Jugosllavisë".

M. Bakalli, Kryetar i Kryesisë së LK të Kosovës, në fjalën e mbajtur në mbledhjen e 15-të të KQ të LKJ (Dhjetor 1980) ka thënë se "nuk u arritën synimet për zvogëlimin e diferencave në shkallën e zhvillimit të Kosovës në krahasim me mesataren e vendit. Përkundrazi, u bë një thellim i mëtejshëm i diferencave... Kësisoj, në vend që dinamika e zhvillimit të krahinës të jetë 60 për qind mbi dinamikën e zhvillimit të vendit, siç ka qenë planifikuar, dinamika e zhvillimit të Kosovës ishte 46,9 për qind nën mesataren e vendit. Kjo tendencë e rritjes së këtyre diferencave, tha ai, vazhdon që nga viti 1947 e deri tani. Ky proces i thellimit të diferencave, thotë M. Bakalli, ka arritur kufijtë kritikë".

Nga kjo situatë bëhet e qartë pse populli i Kosovës është i pakënaqur dhe pse doli në demonstratë për ta shprehur këtë pakënaqësi në mënyrën që ai e quajti më të mirë dhe në formën që e gjeti më të përshtatshme.

Çfarë bënë dhe çfarë kërkuar studentët kosovarë ndaj të cilëve Beogradi po lëshon tani breshër e rrufe? Vetë udhëheqësit jugosllavë dhe komunikatat e shtypit e kanë pranuar botërisht e zyrtarisht se në demonstratat e 11 marsit në Prishtinë studentët kanë shprehur pakënaqësinë e tyre për gjendjen ekonomike, për kushtet e këqija të jetesës, për diskriminimin që u bëhej atyre në krahasim me studentët e tjerë të universiteteve jugosllave. Këtë pakënaqësi, siç është pasqyruar shpesh në vetë shtypin jugosllav, ata e kanë shprehur disa herë si përpara autoriteteve lokale, ashtu edhe atyre qendrore. Po kështu punonjësit e Kosovës kanë folur shpeshherë edhe për prapambetjen e Kosovës dhe kanë vënë në dukje nevojën e marrjes së masave urgjente për zhvillimin e vendit. Por këtyre kërkesave të drejta e esenciale njeri nuk ua ka vënë veshin. Çdo gjë e ka mbuluar indiferentizmi dhe populli është lënë në mëshirën e fatit. Në qoftë se do të kishte pasur ndonjë interesim, Kosova me burimet e pafundme minerare, me fusha pjellore, me njerëzit e saj trima e punëdashës, nuk do të ishte këtu ku është. Sigurisht, këto pasuri shfrytëzohen. Qymyri nxirret me miliona tonelatë, termocentralet prodhojnë me miliona kilovat, plumbi shkrihet si lumë në Trepçe, kromi, nikeli, magnezi formojnë male të lartë, gruri i Kosovës mbush eshalone të tëra vagonash dhe bagëtia e shijshme e Kosovës shkon në tërë pazaret evropiane. Po Kosova pse ngec në vend? Këto janë pyetjet që studentët dhe populli i Kosovës i bëri udhëheqjes jugosllave dhe që përgjigjen e morën me plumba.

Udhëheqësit jugosllavë thonë se në Jugosllavi kombet e kombësitë, punonjësit e kolektivat e ndryshme vetadministrohen, se ato vetëvendosin për zhvillimin ekonomik të ndërmarrjeve, fshatrave, qyteteve, republikave etj. Nuk duam këtu të hyjmë në polemikë ideologjike me teoritë e praktikën e tyre por deshëm të bënim një pyetje të thjeshtë: Në këtë të ashtuquajtur vend socialist e të vetadministruar, në RSFJ, në bazë të atyre të drejtave që jep Kushtetuta Jugosllave, a ka të drejtë populli dhe rinia e Kosovës, a kanë lirinë të shtrojnë pyetjen pse krahinat e tjera të Jugosllavisë zhvillohen, ndërsa në Kosovë nuk ndodh një gjë e tillë? Duket se dikush e pengon zhvillimin e Kosovës, dhe se kush është ai këtë duhet ta dijë udhëheqja e Federatës, përderisa ajo ka pohuar se Kosova është, në të njëjtën kohë, e pasur në mundësira dhe e varfër në fakt.

Në fjalimet e disa udhëheqësve kosovarë, si dhe në mjaft organe të shtypit është deklaruar se demonstratat e studentëve në Prishtinë... kërkuar edhe më shumë liri e të drejta ekonomike, vendosjen e statusit të Republikës së Federuar për Kosovën. Edhe për këtë çështje lind një pyetje: Në bazë të së ashtuquajturës demokraci vetadministruese, a kanë të drejtë popujt e Jugosllavisë t'i kërkojnë këto gjëra?

Dushan Dragosavaci, Sekretar i Kryesisë së KQ të LKJ, në një fjalim që mbajti më datën 3 prill, kushtuar ngjarjeve në Kosovë, tha: "Përvoja ka treguar se vazhdimisht kemi pasur dëme, kur i kemi lënë pas dore momentet që paraqiteshin për ne si historike". Kjo këshillë "e vlefshme", që jep ai, është me vend jo vetëm për udhëheqjen e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, por është një kujtesë edhe për Republikën Popullore të Shqipërisë. Ajo nuk është një rekomandim vetëm për popullin serb, por edhe për popullin shqiptar që jeton në trojet e veta në Jugosllavi.

Por ne dëshirojmë të theksojmë, me këtë rast, se udhëheqja jugosllave asgjë nuk ka lënë në harresë, dhe historinë nuk ka dashur ta shikoj ashtu si duhej shikuar, me qëllim që të mos përsëritej e kaluara e hidhur.

Dushan Dragosavaci, po në këtë fjalim, thotë se, "Ne kemi zgjidhur në mënyrën më të mirë të mundshme çështjen e kombësive, të republikave kombëtare dhe në kuadrin e Republikës Socialiste të Serbisë, çështjen e krahinave autonome". Po këtë gjë thekson edhe Dobrivoje Vidiçi, Kryetar i Republikës Socialiste të Serbisë, i cili, pasi hodhi vrerin dhe mërinë më të madhe mbi Kosovën, tha se "Krahinat autonome socialiste kanë pavarësi e barazi të plotë në kuadrin e Republikës Socialiste të Serbisë". Shkurt "pavarësi e barazi të plotë", por nën sjetullën e Serbisë!

Këto pohime të udhëheqësve jugosllavë tregojnë se, edhe pas Luftës Nacionalçlirimtare të popujve të Jugosllavisë, historia e vjetër nuk u harrua: Kosova mbeti një "një krahinë autonome" e Republikës së Serbisë dhe popullsia shqiptare, kompakte, si nga kombësia ashtu edhe nga territori, u nda në mes tri republikave të Federatës Jugosllave. Pse ndodhi kështu? Këtë iu bie ta shpjegojnë ideologjikisht, politikisht, gjeografikisht dhe ekonomikisht Dragosavacit, Vidiçit e shokëve të tyre. Po të bëhet një analizë e tillë, atëherë do të dalë se sa pa vlerë janë afirmimet si ato të Dragosavacit, kur thotë: "Ne kemi zgjidhur në mënyrën më të mirë të mundshme çështjen e kombësive dhe të republikave kombëtare".

Në një vend të fjalimit të tij Sekretari i Kryesisë të KQ të LKJ, pasi pretendon se në Jugosllavi janë zgjidhur drejt çështjet e kombësive thotë: "Megjithatë, do të ishte iluzion të mendohej se këtë e kemi zgjidhur në mënyrë të qëndrueshme dhe të përsosur dhe se nuk do të ketë probleme ndërnacionale". Qartë, ai pohon se "nuk e kanë zgjidhur në mënyrë të qëndrueshme dhe të përsosur" këtë problem kaq të koklavitur të kombësive. Atëherë duhet të dilet me konkluzionin se nga popujt që përbëjnë Jugosllavinë duhet të bëhen përpjekje që këto probleme të përsosen. Pra, u përket popujve të Jugosllavisë që t'i zgjidhin e t'i përsosin këto demokratikisht, brenda kuadrit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Tani, popullsia shqiptare që jeton në Kosovë dhe që përbën pjesën dërrmuese të saj, kërkon, brenda normave kushtetuese, por edhe në rrugë, që Krahina e Kosovës të çlirohet nga tutela e Serbisë, ajo kërkon t'i njihet statusi i një republike brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Ç'krim bëri populli i Kosovës me këtë kërkesë, që u cilësua si i tillë nga udhëheqja e Federatës së Jugosllavisë dhe nga disa udhëheqës kryesorë të Krahinës së Kosovës? Ai s'bëri asnjë krim. Përkundrazi, këto kërkesa të ligjshme janë nënvlerësuar, janë quajtur armiqësore, prandaj edhe u arrit në demonstratat që u zhvilluan.

Asnjëherë populli shqiptar i Kosovës dhe i viseve të tjera të Jugosllavisë nuk është e lejuar të shprehet lirisht dhe në mënyrë demokratike mbi statusin që duhej të kishin

krahinat ku ata banonin. Persona të tjerë kanë vendosur për ta. Dhe ata kërkuan me zë të lartë, që të dëgjonin popujt vëllezër të Jugosllavisë, se Kosova kërkonte statusin e një republike brenda kuadrit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ata që bënë veshin e shurdhër, s'nguruan të sulmojnë me tanke dhe të qëllonin mbi shqiptarët. Jo vetëm kaq, por studentët trima kosovarë i akuzuan se gjoja vepruan si gangsterët e Çikagos dhe vunë përpara kalamanët e vegjël. Këto zakone të ndyra mund të jenë të të tjerëve, por kurrë të shqiptarëve që kanë luftuar dhe luftojnë me pallën sheshit. Pretendimi i shtypit jugosllav vërteton të kundërtën, se demonstratat ishin popullore dhe paqësore. Ky pretendim, gjithashtu, të le të kuptosh, se, po të mos ishin truma nxënësish, policia serbe do t'i kishte grirë njerëzit me mitraloza. Këto gjëra nuk harrohen kollaj. Ato nuk tregojnë forcën, por dobësinë, nuk tregojnë pjekurinë, por hutimin.

Pse udhëheqja e Federatës nuk i studion në rrugë të drejtë kërkesat për republikë brenda kuadrit të federatës, pse ajo nuk i interpreton ato si kërkesa që rrjedhin nga vetë Kushtetuta e RSFJ, por nxitohet t'i quaj "armiqësore, kundërrevolucionare, që prishin stabilitetin, që shkatërrojnë Jugosllavinë". A nuk i kanë shqiptarët e Kosovës të gjitha tiparet e karakteristikat që përbëjnë një komb, a nuk rrojnë ata në një territor kompakt, a u mungojnë atyre gjuha, kultura dhe konstitucioni shpirtëror i përbashkët, a nuk janë ata të aftë për t'i vetëqeverisur, por u nevojitet tutela e dikujt, a janë të paktë në numër sa nuk do t'ia vlente të ngriheshin në rangun e një republike, a s'ka republika të tjera të federuara në Jugosllavi dhe republika që kërkojnë shqiptarët e Kosovës do të bënte një përjashtim?

Çështjet duhet gjykuar me objektivitet dhe me drejtësi dhe jo të arrihet deri atje sa të gjitha udhëheqjet e çdo rangu të vihen në lëvizje për të ngjallur në popujt e Jugosllavisë ndjenjat e mërisë e të armiqësisë ndaj shqiptarëve, sa të mobilizohen gjithë forcat që të sulmojnë, të shajnë, të rrahin, të vrasin, të gjymtojnë dhe të burgosin lulen më të bukur, rininë trime shqiptare të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare.

Nuk është as në nderin dhe as në interesin e Jugosllavisë që të derdhen mbi Kosovë gjysma e policisë serbe dhe e milicisë së Beogradit të armatosura deri në dhëmbë, të rrethojnë qytetet e Kosovës me tanke, të mbulojnë qiejt me aviona dhe të mbushen aerodromet me parashutistë.

Jo, kjo s'duhesh të ngjiste. Ne e dënojmë rëndë këtë dhunë të pashembullt në Kosovë. Shkaktarët e vërtetë të situatave duhet të gjenden, po këta nuk janë në Kosovë, as në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, siç bëhen aluzione dhe siç flitet me nënkuptime. Ata duhet të kërkojnë e të gjenden më thellë, në arsyt subjektive dhe objektive, në politikën e ndjekur nga udhëheqja jugosllave.

Demonstratat dhe kërkesat e drejta të studentëve e të popullit shqiptar të Kosovës, janë parë e interpretuar nga një kënd i gabuar, ato janë trajtuar në mënyrë armiqësore dhe me një brutalitet të jashtëzakonshëm. Ne mendojmë se këto çështje duheshin trajtuar me gjakftohtësi e urtësi, sidomos duke pasur parasysh se popullsia shqiptare në Jugosllavi kurdoherë i janë bërë padrejtësi dhe forca shoviniste janë përpjekur të hakmerren në mënyrë të egër, qoftë në historinë e largët, qoftë edhe në atë më të afërmen.

Të kërkojë të frikësosh një popull me epitete monstruoze dhe me tanke, siç po veprohet me shqiptarët në Jugosllavi, nuk i arrihet asnjë qëllimi. Me shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe me ata që kanë shkuar në emigracion nga mjerimi dhe papunësia, duhet biseduar shtruar, me qetësi, me arsye e jo me paragjykime të këqija. Ata duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe të kenë barazi të plotë me popujt e tjerë brenda Federatës së Jugosllavisë.

Çdo propozim e çdo kërkesë e drejtë e shqiptarëve ... i prish rehatinë udhëheqjes federale dhe asaj krahinore, kualifikohet pa ngurrim "armiqësore, shoviniste shqiptare, irredentiste etj.". Po kështu edhe çdo protestë kundër padrejtësive që u janë bërë dhe po u bëhen atyre, dhe ato s'janë as të pakta dhe as të vogla, futen në këto kallëpe ofenduese.

Ç'do të thotë në gojën e jugosllavëve epiteti "nacionalist" që u vihet shqiptarëve? Fjala nacionalist, vjen nga fjala nacion, që do të thotë komb, kombësi. Çdo fjalor, i vogël ose i madh, e shpjegon qartë këtë. Por në gojën e jugosllavëve epiteti "nacionalist" është kërkesë për nënshtrim ndaj kombit të madh, është kërkesë që njerëzit të heqin dorë nga dashuria për vendin, atdheun dhe kombin e tyre.

Kur një kombi përpiqesh t'ia mohosh kombësinë, sovranitetin dhe të gjitha atributet që rrjedhin prej tij, atëherë fjalët nacion, nacionalitet që jugosllavët i mbajnë përditë në gojë dhe i shkruajnë në letër, janë vetëm demagogji. Këto përpjekje shkaktojnë fërkime që çojnë edhe në konfrontime të padëshirueshme e të rrezikshme. Në qoftë se një populli përpiqesh t'ia shtypësh dhe t'ia zhdukësh traditat dhe aspiratat nacionale, atëherë do të hasësh patjetër në një reaksion vetëmbrojtës.

Vetëm marksizëm-leninizmi dhe socializmi shkencor ... i zgjidh drejt problemet nacionale.

Në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë është shkuar deri atje sa në Republikën e Bosnjë-Hercegovinës, në Kosovë dhe kudo ku jetojnë shqiptarët të krijohet një "kombësi myslimane". Thuhet se "kombësia myslimane" na qenka një specifike e Jugosllavisë. Por, për çudi, në Jugosllavi nuk ka "kombësi kristiane ortodokse" dhe as "kombësi katolike romane". Ai që do shpjegime për këtë le të lexojë promemorian e V. Çubriloviçit, ish-konsulent politik në regjimin monarkist, ish ministër i RSFJ dhe tani akademik i Jugosllavisë, drejtuar qeverisë mbretërore të Stojadinoviçit.

Po të lexohet kjo promemorie kuptohet edhe më mirë pse çdo veprim i shqiptarëve të Kosovës, brenda kushtetutës dhe ligjeve të federatës, cilësohet menjëherë "shovinizëm shqiptar", pse për t'i futur njerëzit në burgje e në kampe përqëndrimi, cilësohen fare lehtë "si irredentistë". Të akuzosh si irredentist një popull dhe një komb të tërë, prej më shumë se 2 milionë banorësh, siç është pjesa e kombit shqiptar që jeton në trojet e veta në Jugosllavi, duhet vetë të mos jesh shovinist dhe të kesh zhdukur të gjitha shkaqet dhe burimet e padrejtësive nacionale, që janë pjellë e imperialistëve dhe e feudoborgjezisë së vjetër ballkanike. Në qoftë se pas Luftës Nacionalçlirimtare është zbatuar siç pretendohet, parimi i vetëvendosjes së popujve, atëherë pse duhet të ketë irredentizëm?

Më parë se të flitet për të ashtuquajturin irredentizëm, duhet të shpjegohet historia e kaluar, prapambetja ekonomiko-kulturore, papunësia në masë dhe emigracioni i detyruar i shqiptarëve, që përbën një nga emigracionet më të mëdha të Jugosllavisë, në vendet e huaja. Gjendja e Kosovës nuk shpjegohet me "krizën botërore" siç duan ta shpjegojnë disa udhëheqës jugosllavë, gjoja teoricienë, të Federatës dhe të Kosovës.

Për sa i përket shovinizmit të ashtuquajtur shqiptar, duhet thënë se karakteri i shqiptarit dhe historia e tij në shekuj tregojnë të kundërtën e asaj për të cilin akuzohen shqiptarët e Jugosllavisë. Shqiptari asnjëherë s'ka shtypur dhe s'ka shfrytëzuar ndonjë popull. Kurrë ai nuk ka sulmuar dhe copëtuar tokat e popujve tjerë. E kundërta ka ngjarë ndaj shqiptarëve. Prandaj shovinizmi duhet kërkuar e duhet gjetur gjetiu dhe jo te shqiptarët e Kosovës dhe as ata të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, që përbëjnë një popull e një komb. Shovinizmi duhet kërkuar pikërisht te ata udhëheqës jugosllavë që urdhëruan sulmin me tanke dhe me policë serbë, që vranë, gjakosën, torturuan dhe burgosën studentët, punëtorët dhe fshatarët shqiptarë, nipërit dhe mbesat e heronjve të ... Bajram Currit, Abdyl dhe Naim Frashërit, Sulejman Vokshit, Ymer Prizrenit, Azem e Shote Galicës, Çerçiz Topullit e Selam Salarisë, vëllezërit dhe bashkëluftëtarët e Hajdar Dushit, Hysni Kapos, Miladin Popoviçit, Emin Durakut dhe të mijëra partizanëve heroikë shqiptarë, malazes dhe maqedonas që luftuan së toku si vëllezër dhe derdhën gjakun e tyre në Jugosllavi për lirinë, pavarësinë dhe vetëvendosjen e popujve të Jugosllavisë.

Mos vallë në Beograd kërkojnë që shqiptari të mos jetë patriot? Jo, kjo s'do të ngjasë kurrë! Shqiptari kurdoherë është mbrojtur me heroizëm dhe ka fituar mbi armiqtë, pse gjithnjë ka qenë në të drejtën e vet. Kudo që jeton, punon dhe lufton, ai tregon kurdoherë pjekuri dhe durim. Por siç ka thënë shoku Enver Hoxha: "Popullin shqiptar mos e zemëroni, ai është i durueshëm, por, kur zemërohet shqiptari, merr zjarr e flakë edhe stralli".

Historia shekullore e shqiptarëve dhe ajo e kohës së Luftës Nacionalçlirimtare kanë vërtetuar se populli ynë ka derdhur gjakun e bijve dhe bijave të tij për t'u ardhur në ndihmë edhe popujve vëllezër fqinj. Atë e karakterizon shpirti i lartë i sakrificës dhe ndjenja e thellë interncionaliste. Me Jugosllavinë kemi dashur dhe duam fqinjësi të mirë. Qëndrimi ynë është i pandryshuar. Në qoftë se ndokush, ... e sulmon Jugosllavinë, populli ynë, Shqipëria socialiste, do të luftojë përkrah popujve të Jugosllavisë. Këtë e kemi thënë dhe këtë do ta bëjmë.

Opinionin ynë dhe opinionin ndërkombëtar nuk mund të pranojnë dhe të pajtohen me veprimet barbare që po bëhen kundër shqiptarëve të Jugosllavisë. Udhëheqja jugosllave duhet të jetë e matur dhe t'i studiojë e t'i zgjidhë drejt problemet e saj të brendshme dhe jo t'i jap mësim me bollëk të tjerëve, "për moderacion, për zgjidhje paqësore të konflikteve, për të drejtat e njeriut dhe të popujve e të tjera".

Ne mendojmë se duhet ulur gjakrat, dhe, në radhë të parë, nga udhëheqësit jugosllavë. Çështjet e shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi të studiohen me gjakftohtësi, me urtësi e drejtësi. Po u veprua ndryshe, nuk shërohet plaga, përkundrazi, do të thellohet hendeku. Ne nuk duam të ngjasë kjo dhe jemi gati të ndihmojmë me të gjitha forcat të pastra e fisnike, të zemrës dhe të mendjes, për të ruajtur miqësinë me popujt vëllezër të Jugosllavisë, për të ruajtur marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë që janë vendosur, për të ndihmuar si edhe më parë vëllezërit tanë shqiptarë në çdo drejtim, për të zhvilluar me ta marrëdhëniet tregtare dhe shkëmbimet kulturore, siç bëjmë edhe me popujt e tjerë të Jugosllavisë, në bazë të marrëveshjeve të përfunduara bashkërisht në mes Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Këtë e do interesi i të dy shteteve tona, e do miqësia, fqinjësia e mirë, pa ndërhyrë në asnjë moment në punët e brendshme të njëri-tjetrit.

Shqipëria as ka ndërhyrë, as ndërhyrë në çështjet e brendshme të Jugosllavisë. Ky është një parim bazë i politikës sonë. Edhe duke shfaqur pikëpamjet tona për ngjarjet e fundit në Kosovë, ne nuk ndërhyjmë në punët e brendshme të Jugosllavisë. Po ne ngremë zërin dhe kemi të drejtë ngremë kur bëhen padrejtësi ndaj vëllezërve tanë, kur ndaj tyre përdoret dhuna e represioni, kur slogane të ndryshme si shovinizmi shqiptar, irredentizëm etj. përdoren për të diskredituar rininë e popullin shqiptar të Kosovës. Ashtu siç ka të drejtë Jugosllavia dhe çdo shtet tjetër të mbrojë dhe të kërkojë të drejtat për pakicat e veta nacionale, këtë të drejtë e kemi edhe ne. Traktati i Londrës, Traktati i Versajës dhe çdo traktat tjetër imperialist nuk kalon më mbi kurrizin e popullit shqiptar. Këtë ta kenë të qartë të gjithë, miq dhe armiq, shtete të vegjël e të mëdhenj, imperialistë dhe revizionistë, antikomunistë e pseudosocialistë, si dhe shokët e vëllezërit komunistë dhe njerëzit përparimtarë. ("Zëri i popullit", 8 prill 1981)

Jusuf Gërvalla: *"Kam pasur nderin të njihem edhe me sekretarin e parë të Partisë Komuniste Gjermane, njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri dhe i kam dërguar një letër me lutjen që edhe ai me partinë e tij të shikojë ndonjë formë të përshtatshme ndihme për përkrahjen morale të popullit shqiptar të Kosovës. Ende s'kam marrë përgjigje prej tij, por shpresoj se megjithatë do të na ndihmojë patjetër, sepse për këtë i obligon drejtpërdrejt edhe artikulli i*

"Zërit të popullit" i datës 8 prill, se siç dihet, kjo parti e komunistëve gjermanë ka për busollë të vetme PPSH-në." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 260)

7. KUSH E NXIT ARMIQËSINË MIDIS POPUJVE TË JUGOSLLAVISË?

"Zëri i popullit", 23 prill 1981

Ngjarjet tragjike të Kosovës vazhdojnë të mbushin faqet e shtypit ndërkombëtar. Informatat mbi gjendjen në Kosovë, që ndodhet akoma në një rrethim ushtarak e policor të plotë, janë të pakta, por komentet janë të shumta. Gazeta dhe autorë të tendencave më të ndryshme politike bëjnë një pyetje dhe kërkojnë një shpjegim nga udhëheqja jugosllave: Cilat janë ato shkaqe ekonomike, politike e shoqërore që qëndrojnë në bazën e ngjarjeve të Kosovës?

Anëtari i kryesisë së KQ të LKJ Stane Dolanci, me kombësi nga Sllovenia ku niveli i jetesës është më i larti në Jugosllavi, në intervistën që u dha gazetarëve të huaj dhe atyre jugosllavë në Beograd në lidhje me ngjarjet në Kosovë, nuk foli fare për gjendjen e rëndë ekonomike të saj. Ai jo vetëm duhej ta kishte përmendur këtë, por edhe duhej t'i kish shpjeguar shtypit ndërkombëtar për ç'arsye Sllovenia, Kroacia dhe Serbia kanë një nivel jetese aq të lartë, kurse Kosova aq të ulët, për ç'arsye hendeku midis tyre vazhdon të thellohet, megjithëse toka dhe nëntoka e Kosovës është më e pasur se e çdo republike të Jugosllavisë.

A nuk e di Dolanci se ekonomia, përgjithësisht marrëdhëniet ekonomike, luajnë rolin vendimtar në ekzistencën e shteteve dhe të popujve? Pse nuk u mor mundimi të flitej për problemet ekonomike kapitale që shqetësojnë Kosovën e që përcaktojnë gjendjen e përgjithshme të saj?

Është lehtë që të injorohen ato dhe të shpjegohen revoltat dhe kërkesat e popullit të Kosovës me sharje, se "shqiptarët u treguan kundërrevolucionarë, shovinistë, irredentistë". Po të sharat as kanë qenë, as mund të jenë argumente. Zëvendësimi i analizës realiste e objektive të gjendjes në Kosovë me përdorimin e pakontrolluar të epiteteve ofenduese e diskriminuese për një popull të tërë as e shpjegon e as e përmirëson situatën. Gjendja mbetet ajo që është, problemet mbeten ato që janë dhe pjellin dukuri të atilla, të cilat Dolanci dhe udhëheqësit tjerë jugosllavë ose nuk duan t'i shohin ose tremben t'i përballojnë.

Udhëheqësit jugosllavë, që nga më i madhi deri te më i vogli, pretendojnë se në vendin e tyre për të gjitha kombet e kombësitë ekziston "barazia në të drejta politike dhe ekonomike", ekziston "bashkim-vëllazërimi". Po si mund të besohen ata, kur një republikë apo një krahinë trajtohet si "djali i nënës" dhe krahina tjetër si e njerkes, kur një "vëlla" ha me lugë të artë, kurse tjetri me lugë të vogël prej druri? Kjo nuk tregon as "bashkim" as "vëllazërim".

Mos vallë për këtë gjendje, për këtë realitet i bie faji artikullit të "Zërit të popullit" që shprehu mendimin e vet, siç bëri edhe gjithë shtypi botëror, për ngjarjet në Kosovë dhe që dënoi udhëheqjen jugosllave për represionin barbar të ushtruar kundër shqiptarëve?

Shtypi jugosllav na akuzon se ne injorojmë ndryshimet pozitive që janë bërë në Kosovë. Por s'është kështu. Çka është e drejtë ne e mbrojmë dhe e pohojmë, çka është e padrejtë, e denoncojmë dhe e dënojmë.

Ne kemi afirmuar dhe afirmojmë se në dhjetëvjeçarin e fundit arsimit dhe kultura shqiptare në Kosovë (dhe më pak në Maqedoni e në Mal të Zi) kanë bërë një hap të lavdërueshëm përpara. Hapja e shkollave shqipe, e Universitetit të rëndësishëm të Prishtinës, vënia në përdorim e gjuhës letrare shqipe, zhvillimi i këngëve, i valleve, i folklorit shqiptar, i muzikës së përpunuar, i letërsisë shqipe, i shkencave albanologjike etj., përkrah kulturës së popujve të tjerë të Jugosllavisë, kanë marrë një hov që nuk ishte parë kohë më parë. Arsytet dihen dhe nuk duam të zgjatemi këtu. Pra, ne i shohim dhe e krahasojmë të kaluarën me të sotmen, i shohim ndryshimet pozitive të bëra në këto fusha.

Por një gjë të tillë nuk kemi si ta pohojmë për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe viseve të tjera ku banojnë shqiptarët, i cili ka ecur tepër ngadalë në krahasim me pjesët e tjera të Jugosllavisë. Diferencat në zhvillimin e ekonomisë dhe në nivelin e jetesës midis tyre janë kolosale. Këto diferenca nuk shpjegohen dot, siç bëjnë udhëheqësit jugosllavë, me arsyen e "krizës botërore". Diferencat në nivelin e jetesës në mes republikave dhe krahinave duhet të kërkohen në arsye tjera të mëdha, politike, ideologjike dhe ekonomike.

Për zhvillimin e ulët të ekonomisë në Kosovë flet edhe numri i madh i emigrantëve ekonomikë. Vetëm në Turqi janë detyruar të emigrojnë rreth 250 mijë vetë nga shqiptarët që banojnë në Jugosllavi, përveç dhjetëra e dhjetëra mijërave në vende të tjera të Evropës, të Amerikës, të Australisë etj. Kudo gjen emigrantë shqiptarë të ikur nga Jugosllavia "socialiste vetadministruese"... Rinia e Kosovës nuk gjen punë, vuan për bukë në Jugosllavinë e Titos e të pas Titos. Këtyre problemeve duhet t'u gjendet arsyeja, t'u bëhet diagnoza, me qëllim që të shërohet sëmundja sa më parë dhe sa më drejtë.

Shqipëria socialiste dhe gazeta "Zëri i popullit", më parë se kushdo tjetër, kanë të drejtën të thonë fjalën e tyre për gjendjen në Kosovë, për vrasjet dhe torturat e egra që u bënë nga UDB-ja dhe ushtria serbe kundër shqiptarëve të Kosovës. Dhe nuk është hera e parë që në Kosovë bëhet një gjë e tillë. Historia nuk harrohet, ajo është e shkruar. Scripta manent.

Të gërthiturat dhe fshehja e së vërtetës nga personalitete të "mëdhenj" të Federatës e të republikave, histerizmat e shtypit serb, ... etj. arrijnë deri në akuza të përbindshme, sipas të cilave "Shqipëria socialiste ka gisht në demonstratat e Kosovës", se "Shqipëria socialiste u bashkua me reaksionin kroato-sllloveno-shqiptar në emigracion", se "Shqipëria bashkohet me ato shtete që duan shpartallimin e federatës jugosllave" etj., etj., janë shpifje rrugaçësh. Sa më shumë dhe sa më zë më të lartë të jenë këto britma, aq më mirë bota e kupton se bëhen përpjekje të pashpresa që të mbulohet e vërteta. Verba volant. Asgjë s'do të mbetet nga këto zhurma, pse asgjë nuk është e vërtetë.

Stane Dolanc: *"I njohim cilët janë organizatorët. Ata janë në Shtutgart, në Bruksel, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës."*

Dolanci, në intervistën që përmendëm, tha se në demonstratat në Kosovë u vranë 11 veta. Një shërbëtor i tij nga udhëheqja e Kosovës tha nëntë. Me sa duket nuk patën kohë të mirreshin vesh dhe të binin dakord. Megjithatë, të gjithë gënjen opinionin botëror dhe atë jugosllav. Në Kosovë shtypi i huaj flet për qindra të vrarë, qindra të humbur, të plagosur e të arrestuar. Por këto më mirë i di vetë populli i Kosovës, pse gjaku i tij u derdh. Ai e di gjithashtu se pse u derdh ky gjak dhe kush e bëri këtë gjëmë.

Minimizimi nga ana e udhëheqjes jugosllave i numrit të të vrarëve, të të plagosurve e të të arrestuarve nuk vjen "si rezultat i të dhënave të çrregullta", ai është

rrjedhim i përpjekjeve për të fshehur nga bota terrorin që ka shpërthyer në Kosovë dhe për të ruajtur maskën e demokracisë falso të vetadministrimit jugosllav. Por e vërteta do të çajë muret e shtetrrethimit dhe të censurës jugosllave që është vendosur në Kosovë. Atëherë bota do të shohë se ç'masakra e tortura masive u bënë nga ushtria e policia serbe dhe do të njohë fytyrën e vërtetë të "socializmit vetadministrues e njerëzor jugosllav". Gënjeshtrës së Beogradit rreth vrasjeve në Kosovë shpejt do t'i dalë kallaji.

Të gjithë sa flasin e shkruajnë tani në Jugosllavi për ngjarjet në Kosovë thonë se "në demonstratat ka marrë pjesë një numër i vogël të rinjsh, edhe këta të gënjer".

Në rast se në demonstrata ishin pak njerëz, atëherë pse Beogradi dërgoi ushtrinë, milicinë e kryeqytetit, tanket dhe avionët? Përse u vranë dhe u plagosën me armë zjarri aq njerëz dhe përse u vendos shtetrrethimi? Për një "grusht të vogël armiqsh", për 10-5 veta që u quajtën nga udhëheqja jugosllave "reaksonarë, shovinistë e irredentistë"?

Vallë për një kokërr limoni priset dasma, ajo "dasmë", për të cilën tani nga të katër anët e Jugosllavisë vërshojnë si ujët e Danubit, të Savës dhe të Dravës telegramet plot indinjatë e zemërim kundër "shovinistëve dhe irredentistëve shqiptarë", dhe plot himne ditirambike për "unitetin e kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë"? Me të tilla truke nuk është e lehtë të gënjehet një popull trim e i pjekur, siç është populli shqiptar që jeton në pjesë të ndryshme të Jugosllavisë, të gënjehen punëtorët, fshatarët, studentët dhe inteligjencia e ndershme, të cilët janë të ndërgjegjshëm për jetën dhe fatin e kombit të tyre.

Kush e ndjell dhe e nxit pra armiqësinë në mes popujve të Jugosllavisë? Artikulli i natyrshëm, i drejtë dhe i matur i "Zërit të popullit", apo kjo fushatë e tërbuar që ka ngritur udhëheqja e Jugosllavisë kundër popullsisë shqiptare të Kosovës?

A mos donte vallë udhëheqja jugosllave që shtypi shqiptar të heshte për tragjedinë që ajo shkaktoi në Kosovë, kur gjithë shtypi botëror ka javë të tëra që po flet dhe dënon egërsinë e treguar? Mos vallë ajo donte që ne ta mburnim për ato akte të mbrapshta që bëri në Kosovë?

Jo, zotërinj udhëheqës jugosllav! Jini realistë, ruani gjakftohtësinë! Pa shihni se ç'po bëni për demonstruesit dhe grevistët e "Solidarnostit" në Poloni! Ju po flisni, ju shkruani, kritikoni, këshilloni, moralizoni. Vetëm ju paskeni të drejtë të flisni e të shkruani për të tjerët. Që kur botuam artikullin tonë të 8 prillit e deri tani ne kemi ruajtur gjakftohtësinë, kurse udhëheqja jugosllave dhe deri fletushka më e fundit në Jugosllavi kanë vjellë vrer e kanë bërë sulme të shumta kundër vendit tonë. ...

Jugosllavët kur është fjala për ndonjë minoritet të tyre protestojnë edhe për tabelat e dyqaneve, që nuk shkruhen në gjuhën amtare, si në Karinthi. Kryetari i Këshillit Ekzekutiv Federativ Gjuranoviç gjatë vizitës së fundit që bëri në Austri kërkoi "zgjidhjen konkrete të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat dhe pozitën e pakicës kombëtare sllovene e asaj kroate", që ndodhet atje. Për këtë ne nuk e akuzuam atë as si "kundërrevolucionar", as si "irredentist", as si "shovinist".

Mbrojtje e të drejtave të minoriteteve sllovene e kroate, që nuk grihen nga plumbat e mitralozëve dhe as shtypen nga zingjirët e tankeve, për qeverinë jugosllave konsiderohen normale. Por kur Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë interesohet për gjuhën e arsimin shqip, për liritë dhe të drejtat, për gjendjen ekonomike, për vrasjet në masë, për burgosjet dhe torturat që u bëhen shqiptarëve në Jugosllavi, kjo na qenka "shovinizëm" e "irredentizëm". Nga vjen dhe ku e ka burimin alergjia e madhe antishqiptare e udhëheqësve dhe e propagandës jugosllave?!

Harruat ju zotërinj udhëheqës jugosllavë, si luftuat në Konferencën e Parisit për Triesten, Pulën, Rijekën etj.? Të drejtë kishit. Ne nuk ju quajtëm as "shovinistë", as "irredentistë". Por kur nuk ishit të tillë, përse nuk ju shkoi ndërmend që ekzistonte një popullatë shqiptare, e treta në Jugosllavi nga madhësia, e cila duhesh të bashkohesh me

Shqipërinë, aleaten tuaj socialiste në Luftën Nacionalçlirimtare? Ju heshtët. Pse heshtët, kur na qenkeni kaq parimorë? Ju as statusin e krahinës nuk ia dhatë Kosovës deri në vitin 1968. Pse presidenti Tito nuk e realizoi atë që i tha shokut Enver Hoxha, në bisedimet zyrtare që patën në vitin 1946, se "Kosova dhe viset e tjera të banuara nga shqiptarët i përkasin Shqipërisë dhe do t'ia kthejmë, por jo tash, se akoma reaksioni serbomadn nuk do ta pranonte një gjë të tillë"?

Megjithëkëtë rivendikime territoriale nga ana e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk janë bërë. Nuk mund të gjesh një gjë të tillë në asnjë dokument. Por dokumente për të mbrojtur të drejtat e vëllezërve kosovarë dhe të shqiptarëve që banojnë në republikat e tjera të Jugosllavisë, të drejta që ua njeh Kushtetuta Jugosllave dhe që u janë shkëlur e po u shkelen, do të gjesh boll, në të kaluarën dhe në të sotmen. Varet nga qëndrimi dhe politika Jugosllave ndaj shqiptarëve nëse do të ketë ose jo në të ardhmen.

Njëri pas tjetrit udhëheqësit jugosllavë deklarojnë se "Kosova nuk do të bëhet kurrë republikë... pse këtë nuk e lejon Serbia". "Po të bëhet Kosova republikë në kuadrin e federatës, thonë ata, atëherë u shkatërrua federata". Ata e paraqesin çështjen sikur viset shqiptare janë "kyçi i murit" që mban federatën. Këto "argumente" nuk qëndrojnë as nga pikëpamja historike, as nga ajo ekonomike e juridike, as nga vetë përmbajtja e Kushtetutës së Jugosllavisë, as nga praktika e zbatuar me kombet e tjerë që përfshihen në shtetin jugosllav. Por ato tregojnë se këto vise janë bërë plaçkë tregu dhe ata që sundojnë në Beograd vazhdojnë t'i konsiderojnë e trajtojnë si të tilla. "Republikën e Kosovës" renda federatës jugosllave nuk e shpikëm ne, atë e kërkoi populli i Kosovës.

Ndryshime statusi nga krahinë në republikë etj., janë çështje të brendshme të popujve të Jugosllavisë, janë çështje të vetë popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi, i cili, në bazë të vetë Kushtetutës së Jugosllavisë, ka të drejtë t'i kërkojë. Jo vetëm që askush në federatë s'ka të drejtë t'ua ndalojë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi këto kërkesa, por ca më pak t'i sulmojë, t'i plagosë, t'i vrasë dhe t'i burgosë ata.

Për këtë të vërtetë që themi jugosllavët na akuzojnë se ndërhyjmë në punët e brendshme të tyre. Ne nuk kemi ndërhyrë në këto punë të brendshme të tyre, të cilat mendojmë se zgjidhen drejt vetëm me vetëvendosje, me mirëkuptim, me bisedime të sinqerta dhe me gjakftohtësi nga të gjitha palët.

Shqipëria Socialiste nuk ka bërë as ndërhyrjen më të vogël në Kosovë. Ajo nuk dërgoi as tanke, as helikopterë, as policë, as shtoi kufitarë, as bateri topash nuk nxori në kufijtë e saj dhe as protestë zyrtare nuk bëri. Vetëm "Zëri i popullit" botoi një artikull për tragjedinë që u shkaktua në Kosovë, një artikull të matur dhe të argumentuar politikisht, ideologjikisht dhe historikisht. Kështu e vlerësoi edhe shtypi botëror. Prandaj përgjegjësi për çka ngjau në Kosovë nuk ka Shqipëria, përgjegjës janë ata që përdorën dhunën dhe jo gjakftohtësinë e arsytën.

Në Jugosllavi kanë filluar të dalin libra me tituj bombastikë që bien erë megalomani dhe shovinizëm të pafrenuar, si "Lufta për Ballkanin" i Svetozar Vukmanoviç Tempos, "Aspekte të çështjes maqedonase" i L Lazar Kolishevskit, i cilësuar edhe ky "si një libër mbi realitetin në Ballkan". Në të njëjtën kohë në Bullgari, koloni e socialimperialistëve sovjetikë, po shkruhen artikuj të gjatë, bëhen festime e mbahen fjalime për "Bullgarinë e madhe" të Shën Stefanit, që i çon kufijtë e saj deri në Shqipëri.

Këta njerëz asgjë s'kanë mësuar dhe asgjë s'kanë harrua nga historia. Vetëm shqiptarët, që janë bërë preja e tyre, na qenkan "shovinistë dhe irredentistë".

Po le të lemë të flasë me gojën e tij L Lazar Kolishevski, ish-president i Presidencës së Jugosllavisë. Në librin që përmendëm, siç transmetoi agjencia TANJUG më 15 prill 1981, ai shkruan: "Është fakt se ne ekzistojmë, se Republika Socialiste e Maqedonisë dhe kombi maqedonas po zhvillohen dhe riafirmohen vazhdimisht dhe se ndjenja që ushqen

çdo maqedonas, se është një pjesë e kombit të tij, po bëhet gjithnjë më e fortë pavarësisht se ku jeton. Ky është një proces që askush nuk mund ta ndalë".

Si t'i cilësojmë këto mendime, zotërinj Doalnc, Dragosavac, Vidiç e të tjerë, që akuzoni shqiptarët e Kosovës dhe Shqipërisë socialiste si "shoviniste dhe irredentiste"?

"Ky proces i zhvillimit dhe i afirmimit që askush nuk mund ta ndalojë", na qenka një e drejtë vetëm për maqedonasit? Po në Kosovë, në Maqedoni dhe në vise të tjera të Jugosllavisë, ku jetojnë më tepër se dy milionë shqiptarë, a nuk zhvillohet ky proces? A nuk është një fakt se atje ekziston një popull, që nuk kërkon veçse të drejtën të shpallet republikë brenda federatës? Atëherë ky proces "të cilin nuk mund të ndalë askush për maqedonasit", pse ndalohet për shqiptarët?

I akordoni të paktën me njëri-tjetrin mendimet, por jo në kurrizin e popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi!

Udhëheqja jugosllave gabohet kur mendon se mund të gënjejë ndokënd, e sidomos opinionin botëror, kur thotë se Shqipëria socialiste kërkon minimin e federatës ose bën lojën e atyre që duan një gjë të tillë. Ajo po të dojë t'i marrë për keq të vërtetat tona, le të na akuzojë, po t'i vijë për mbarë, për ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë. Por kjo nuk e ndryshon aspak situatën në Federatën Jugosllave. Sëmundja kronike që ekziston atje nuk vjen nga të drejtat e ligjshme që kërkojnë shqiptarët që banojnë në Jugosllavi, po nga padrejtësitë dhe dobësira të tjera të thella që ekzistojnë në gjithë federatën.

Federatën e ka minuar vetë titizmi, kjo rrymë armiqësore e marksizëm-leninizmit. Atë e ka minuar sistemi antisocialist i vetadministrimit, e kanë minuar borxhet e mëdha që e kanë mbytur deri në fyt Jugosllavinë dhe kanë shkaktuar inflacionin, papunësinë e madhe, ngritjen e çmimeve, pabarazinë e zhvillimit në mes republikave e krahinave, varfërinë e masave punonjëse, emigracionin e qindra mijëra njerëzve nga vatrat e tyre.

Zyrtarët jugosllavë na akuzojnë "nacionalistë, shovinistë etj." Gati sa s'na akuzojnë edhe për "pansllavistë". Të gjitha këto nuk janë ideologji tonat. Ato janë ideologji antimarksiste, teori të borgjezisë, të imperializmit dhe revizionizmit.

Mund ta bësh revolucionin, siç flasin për të e teorizojnë përditë udhëheqësit jugosllavë, por mund edhe ta devijosh e ta tradhtosh atë. Revizionizmi modern, i çdo ngjyre dhe nën çdo maskë që të fshihet, është pjellë e borgjezisë kapitaliste që lufton revolucionin, që e deformon dhe e mbyt atë në gjak. Ashtu si borgjezia edhe revizionizmi modern nuk i bashkon popujt, por i përçan.

Ç'ndodhi në Bashkimin Sovjetik? Hrushovi dhe pasardhësit e tij e devijuan veprën e madhe të revolucionit, vendosën kapitalizmin dhe hoqën dorë nga politika nacionale e Leninit... Tani shovinizmi rusomadh dominon egërsisht mbi popujt e Bashkimit Sovjetik, por njëkohësisht kanë ngritur veshët edhe nacionalizmi ukrainas, ai gjeorgjian, armen etj. Në Bashkimin Sovjetik dominon pansllavizmi, dhe ai nga një vend socialist u kthye në një vend socialimperialist agresiv dhe luftënxitës. Teoria e Brezhnjev-it e "sovranitetit të kufizuar" ia ka zënë nga gryka të gjitha vendet e Traktatit të Varshavës, pjesëtarë të KNER-it dhe të "Bashkësisë socialiste", të cilët forca e armëve sovjetike i bënë të qeshin verdhë për të mos qarë e lebetitur.

Kjo është një histori e tmerrshme dhe një mësim për popujt që duan të rrojnë të lirë dhe të ndërtojnë socializmin... Prandaj zotërinj, zotërinj teoricienë të "Borbës" ka shkallëzim në shovinizëm dhe lloje të ndryshme shovinizmi, pavarësisht nga forma dhe nga madhësia e tyre, pavarësisht nga maskat dhe nga fjalët pompoze. Nacionalizmi, shovinizmi dhe pansllavizmi janë të dënueshme nga çdo anë që të vijnë, pavarësisht se ata që kultivojnë këto janë të mëdhenj a të vegjël, por nacionalizmi dhe shovinizmi më i madh është më i rrezikshëm. Kjo s'duhet harruar. Të gjitha këto të këqija duhen luftuar,

duhen shkukur nga rrënjët, por kjo nuk mund të bëhet kurrë veçse nga pozitë e marksizëm-leninizmit. Tjetër rrugë s'ka.

Jugosllavët hiqen si politikanë të zgjuar, por tregohen jo vetëm naivë, por edhe të hutuar. Plagët dhe përçarjet qëndrojnë jo në demonstratat e Prishtinës. Ato duhet kërkuar në vijën e ndjekur nga udhëheqja jugosllave, në shovinizmat e mëdha e të vjetra dhe në ato të reja që ka krijuar sistemi i tyre antisocialist. Kënde vjen ajo përçarje, ajo e keqe, që ne nuk ua duam aspak popujve vëllezër të Jugosllavisë.

Është e vërtetë se popujt e Jugosllavisë bënë revolucionin. Por megjithëkëtë grindjet dhe dasitë e vjetra nuk u zhdukën, ato mbetën të fshehura si qymyri i ndezur nën hi, mbetën rivalitetet në mes serbëve, kroatëve, sllovenëve, pavarësisht se këta popuj luftuan kundër çetnikëve serbë dhe ustashëve kroatë dhe i mundën fizikisht. Nuk u spastrua sistematikisht ideologjia dhe fryma nacionaliste e shoviniste që do të manifestohej, siç u manifestua më vonë, në formë të ndryshme, por me përmbajtje gati të njëjtë, e mbuluar këtë herë me petkun e "socializmit", "të bashkim-vëllazërimit", e "të drejtave të barabarta" të popujve.

Lufta heroike e popujve të Jugosllavisë s'kish si të mos ngjallte një krenari të ligjshme, por kjo u kthye nga udhëheqja jugosllave në një megalomani dhe shovinizëm jugosllav, duke pretenduar se gati vetëm ata luftuan, vetëm ata sakrifiku, vetëm në sajë të tyre luftuan e nga ata morën shembull edhe popujt e tjerë. E gjithë kjo u transformua në një "ndjenjë superioriteti" që nuk mbante fare erën e marksizëm-leninizmit.

Krimbi ishte brenda në "mollën e kuqe", ai gërryente revolucionin dhe, për ta arsyetuar këtë, ia hodhën fajin Stalinit, Bashkimit Sovjetik, sistemit të tij të vërtetë leninist dhe ideologjisë që e kish udhëhequr këtë sistem, marksizëm-leninizmit. Titoja dhe shokët e tij u bënë nga borgjezia ndërkombëtare heronjtë e ditës antistalinianë dhe antisovjetikë. U dhjetëfishua megalomania e tyre.

Kundërrevolucionin dhe "socializmin vetadministrues" ngjallën rivalitet dhe hegjemonizmat e vjetra, hegjemonizmin serb nga njëra anë dhe atë kroato-slloven nga ana tjetër. Këto dy hegjemonizma janë minuesit e Federatës Jugosllave dhe jo "shovinizmi" shqiptar. Ky i fundit përdoret si cipë për të mbuluar shovinizmin serbomadhin dhe atë kroato-sllovenomadhin.

Lufta për hegjemoni dhe për pushtet në mes këtyre dy klaneve është zhvilluar dhe zhvillohet e egër. Titoja hiqej si moderator, por ai ishte përkrahës i hegjemonizmit kroato-slloven. Klani i tij rrojti në luks të madh, mori pjesën e luanit nga të ardhurat e Jugosllavisë, hëngri sa deshi nga borxhet e ... shteteve kapitaliste.

Është e kuptueshme se klanit serb një gjendje e tillë nuk i leverdis dhe lufton të rifitojë supremacinë.

Rreth këtyre dy klaneve rivale vërtiten republikat e tjera të varfra. Të gjitha me qëndrimet e tyre në favor të njëres ose tjetres palë, kush më shumë e kush më pak, i hedhin benzinë këtij zjarri të madh që ekziston në këtë Republikë Socialiste Federative të Jugosllavisë të pastabilizuar kurrë.

I vetmi faktor pozitiv dhe i paanshëm në këtë federatë është faktori shqiptar. Shqiptarët në Jugosllavi kanë qenë të përbuzur politikisht, ekonomikisht, si dhe nga ana kulturore-arsimore. Por ata kanë qenë njëkohësisht edhe faktori më i durueshëm dhe më realist në kaosin politiko-ekonomik ku ishte zhytur Jugosllavia e pas Luftës së Dytë Botërore, kaos që veçanërisht shqiptarëve u rëndonte shumë.

Asnjë politikanë jugosllav nuk ia vuri veshin këtij faktori kaq të rëndësishëm. Elementi shqiptar, në skakjerën e politikanëve jugosllavë, ishte një pion që mund ta lëviznin si të donin dhe me të të bënin çfarë të donin. Politika e ndjekur nga Tito-Kardeli dhe Rankoviçi ka qenë jo vetëm e gabuar karshi shqiptarëve, por edhe e egër e shfarosëse. Shqiptarët duruan, por nuk u përkulën. Edhe pse, më pas, u bë Krahinë Autonome,

Kosova mbeti ekonomikisht më e varfra dhe politikisht më e lëna pas dore në sistemin "vetadministrues". Në këto kushte populli i Kosovës kërkoi statusin e Republikës në kuadrin e Federatës Jugosllave.

Është kjo kërkesë një faktor përçarës i Jugosllavisë apo janë rivalitetet e mëdha serbo-kroato-slllovene? Është më se evidente se janë këto të dytat. Shqiptarët nuk janë partizanë në këto rivalitete dhe nuk kanë ambicie për hegjemoni e supremaci mbi të tjerët. Ata nuk i mbajnë sytë te njëra ose tjetra superfuqi për të fituar përkrahje dhe mbështetje për të zënë pozita dominuese në Federatë.

Udhëheqja dhe shtypi jugosllav për demonstratat në Kosovë bënë fajtor popullin shqiptar të Kosovës, pastaj akuzuan Shqipërinë socialiste dhe me të ustashët, çetnikët dhe ballistët në Evropë

Stane Dolanc: *"I njohim cilët janë organizatorët. Ata janë në Shtutgart, në Bruksel, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës."*

e në Amerikë, duke menduar se me mendjelehtësi e zgjidhën enigmën. Këtë zgjidhje ia vunë në pjatë opinionit botëror që ta hante. Po se ha kush çorbën që gatuan jugosllavët.

Arsyet e vërteta të ngjarjeve në Kosovë udhëheqja jugosllave kërkon t'i fshehë. Ky qëndrim i saj është i mbarsur me rreziqe jo vetëm për popujt e Jugosllavisë, por edhe për Shqipërinë e popujt e tjerë të Ballkanit. Prandaj ne nuk i fshehim mendimet tona dhe flasim hapur nga vijnë këto rreziqe.

Kush thellohet në këto probleme kyçe të jetës jugosllave, do të dalë menjëherë në konkluzionin se nuk janë as Shqipëria socialiste, as shqiptarët që banojnë në Jugosllavi ata që e minojnë federatën. Bile, siç del edhe nga intervista e Dolancit, shqiptarët janë për ruajtjen e Federatës Jugosllave. Por Dolanci gabohet rëndë kur mendon të frenojë lakmitë serbe për hegjemoni përballë hegjemonisë kroato-slllovene, duke e prerë me thikë se "Kosova nuk do të bëhet kurrë republikë". Haraç i këtij antagonizmi nuk mund të bëhet Kosova.

Në këto situata krize ndërkombëtare jo vetëm ekonomike, por edhe politike, në këto rivalitete agresive luftënxitëse në mes imperializmit... e socialimperializmit sovjetik, a kanë gisht këto superfuqi në dobësimin e Republikës Federative të Jugosllavisë, në nxitjen e shovinizmit serbomadh dhe të atij kroato-slllovenomadh? "Politikanët" jugosllav jo pa qëllim nuk e gërvishin këtë plagë të madhe.

Pse fshihet kjo situatë e rrezikshme? Ajo fshihet se Jugosllavi është jo e pavarur, por e varur nga këto dy fuqi të mëdha. Teoria e Titos e vendeve të "paangazhuara" është boshe, është një falsitet. Këtë e tregon jeta. Jugosllavia nuk rron dot pa borxhe. Me këtë vartësi ekonomike s'ka asnjë dyshim që gërshetohen dhe interesat politike, hegjemoniste dhe strategjike të ... superfuqive në Jugosllavi. ...

Po jua përsërisim për të njëqindtën herë se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe populli shqiptar që jeton në Jugosllavi nuk janë armiq të as të popujve jugosllavë, as të Federatës Jugosllave. Ju zotërinj politikanë jugosllavë, po të doni mos na dëgjoni, po ne jemi të bindur se popujt e Jugosllavisë do të na dëgjojnë dhe do ta kuptojnë mendimin tonë, ndjenjat tona të sinqerta, ndjenjat vëllazërore të shqiptarëve.

Ne komunistët shqiptarë jemi zotër në shtëpinë tonë dhe bëjmë politikën që e gjejmë më të mirë e më të drejtë. Të tjerët mund të mos pajtohen me të. Është e drejtë e tyre. Ne na shikon e na gjykon populli ynë. Faktet, jeta, puna tregojnë se populli shqiptar e mbështet dhe e mbron me të gjitha forcat vijën e drejtë të Partisë dhe të pushtetit të tij.

Sistemin tonë socialist, të ndërtuar në bazat e marksizëm-leninizmit, propaganda zyrtare jugosllave e sulmon me epitete përçmuese si "stalinist, etatist-burokratik" e të tjera si këto. Një pseudoteori e tërë është ndërtuar për këtë mision. Jugosllavët e mbrojnë dhe

e propagandojnë sistemin e tyre "vetadministrues" si një "nga format më të përsosura të socializmit". Kjo është puna e tyre.

... Ne jemi dhe luftojmë ideologjikisht kundër "vetadministrimit" jugosllav, i cili për ne është një sistem kapitalist, pseudosocialist, kundërrevolucionar. Këtë e bëjmë dhe do ta bëjmë pa lëkundje.

Është e qartë, pra, se ideologjikisht dhe politikisht me revizionistët jugosllav ne as puqemi, as nuk do të puqemi kurrë. Këtë të vërtetë e dimë edhe ne, e dinë mirë edhe ata. Këtë e di gjithë bota.

Por, pavarësisht se ideologjikisht dhe politikisht nuk pajtohemi kurrë, Shqipëria dhe Jugosllavia kanë arritur në të njëjtin mendim se, në mes dy shteteve tona, për hir të fqinjësisë së mirë dhe për stabilitetin e paqen në rajonin e Ballkanit, duhet të zhvillohen marrëdhëniet normale tregtare, kulturore etj.

Duhet të pohojmë se nga të dy palët në këtë është gjendur mirëkuptim. Tregtia midis dy vendeve tona, në interesin jo vetëm të Shqipërisë, siç dëshiron ta paraqesë borgjezia kapitaliste botërore, por edhe në interesin e Jugosllavisë, është zhvilluar dhe po zhvillohet në mënyrë të kënaqshme. Marrëdhëniet kulturore dhe veçanërisht me Kosovën, me Maqedoninë dhe me Malin e Zi, kanë ecur mirë, me sukses, pa asnjë incident dhe në një mirëkuptim të frytshëm. As nga ana shqiptare, as nga ana jugosllave nuk ka dalë asnjë pengesë serioze. Këto marrëdhënie, si edhe marrëdhëniet tregtare ne i konsiderojmë si gjëra të mira, që duhet të vazhdojnë dhe të mos ndërpriten. As shenja më e vogël e "shovinizmit dhe e irredentizmit shqiptar", siç po pretendohet tani nga udhëheqja jugosllave dhe shtypi i saj, nuk është shfaqur dhe nuk mund të shfaqej nga asnjë prej nënshtetasve tanë që kanë vizituar Kosovën, që nga ministrja jonë e Arsimit dhe e Kulturës, deri te profesorët dhe turistit më i thjeshtë shqiptar. Po kështu mund të themi se, edhe nga shtetasit jugosllavë njësoj është vepruar. Nuk është parë asnjë shfaqje që ta prishë këtë rrjedhë.

Duke shkruar këtë artikull ne nuk kemi për qëllim të ngjallim polemikën, as t'i hedhim benzinë zjarrit. Ne u detyruam t'i japim përgjigje fushatës antishqiptare që ka shpërthyer aktualisht në Jugosllavi dhe të shprehim edhe njëherë hapur mendimet tona mbi ngjarjet e Kosovës. Njëkohësisht deshëm të shprehim përsëri dëshirën e gatishmërinë tonë për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, gjë të është në interesin e të dy palëve. ("Zëri i popullit", 23 prill 1981)

8. DUHESHIN SHKRIME, TRAKTE DHE FJALIME

Jusuf Gërvalla: *"Letrat e tua dhe materialet e shkruara i mora me kohë. Por, i lejova vetes të ta vonoja pak përgjigjen, për arsye se isha i zënë me disa punë të nisura, shumë të ngutshme. Me një shok (Kadri Zekën-shën i Xh. D.) të "Lirisë" organizuam në Zvicër dhe në RFGJ katër demonstrata të punëtorëve kosovarë në botën e jashtme, dhe jemi në prag të organizimit të demonstratës së pestë. Duheshin shkrime, trakte dhe fjalime, pastaj, duhej një vrap i madh për tubimin e njerëzve. Demonstrata e parë u mbajt më 11 prill në Bern të Zvicrës, e dyta më 18 prill në Cyrih të Zvicrës, kurse e treta dhe e katërta në Shtutgart e Dyseldorf të RF Gjermane, me 25 prill, përkatësisht më 9 maj. Në demonstrata u hodhën po ato parulla që ishin hedhur në demonstratat në Kosovë. Para ambasadave u mbajtën kudo mitingje protestuese, me fjalime të rëndësishme, që demaskonin qëllimet dhe veprimet fashiste të jugosllavëve dhe tregonin qëllimin e vërtetë të kryengritjes në Kosovë si dhe shkaqet e saj të vërteta. Thuaia në të gjitha demonstratat e organizuara ishim bashkë me ne edhe komunistët dhe demokratët gjermanë dhe shumë komunistë nga radhët e punëtorëve turq, qoftë fizikisht, qoftë me trakte e fjalime, në të*

cilat paraqitej gjendja reale në Kosovë dhe dënohej rëndë veprimi fashist i policisë dhe ushtrisë jugosllave mbi popullsinë e pafajshme dhe duarthatë të Kosovës. Demonstrata e ardhshme do të bëhet në Mynih të RF Gjermane, të shtunën , më 16 maj." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-262)

9. Kërkesa për ti njohur Kosovës, statusin e Republikës, është e drejtë

("Zëri i Popullit", 17-Maj 1981)

Njëri pas tjetrit, shtabet politike të Jugosllavisë, që nga instancat më të ulëta e deri në ato më të larta, që nga krahinat, republikat e deri në federatë, që nga organizatat bazë e deri në Komitetin Qendror të LKJ-së, u mbledhën për të diskutuar për ngjarjet e Kosovës. Kudo mallkime për popullin e rininë kosovare, kudo kërcënime, sharje dhe fyerje! Shovinizmi serbomadh dhe antishqiptar po mbulon Jugosllavinë. Udhëheqësit jugosllavë, janë vënë në një garë oratorie se kush është më i zoti, të mbulojë shkaqet e vërteta të demonstratave e revoltave të popullsisë shqiptare në Kosovë, të fshehë masakrat çnjerëzore dhe barbarizmat e ushtrive serbe, të denigrojnë shqiptarët e Kosovës. Të gjithë nxitojnë se kush më parë të propozojë masat më drakoniane, se kush të parashtojë masat më shtypëse e më antihumanitare ndaj tyre.

Por sot, në këtë artikull, nuk kemi ndërmend të kthehemi te shpjegimi i ngjarjeve tragjike të Kosovës, të tregojmë se ku e kanë burimin e kush i shkaktoi ato.

Pikëpamjen dhe qëndrimin tonë për këto çështje e kemi shprehur në artikujt që kemi shkruar në 8 dhe 23-Prill. Atyre, s'kemi ç'tu heqim dhe çka tu shtojmë. Ato që kishim për ti thënë i thamë hapur, drejt, me sinjeritet e me ndjenjë të lartë përgjegjësie. Menduam se në udhëheqjen jugosllave, mbas tronditjeve dhe hutimeve të para, do të fitonte arsyeja, gjakftohtësia, gjykimi realist e objektiv i shkaqeve që çuan në tragjedinë e re të Kosovës, se interesat, miqësia dhe uniteti i kombeve dhe i kombësive që e përbëjnë atë, do të qëndronin mbi paragjykimet e vjetra e të reja nacionaliste.

Kjo nuk ndodhi. Përkundrazi, të gjitha organizmat e organet qeveritare e të Lidhjes Komuniste, i përfshiu një valë e egër shovinizmi, jo vetëm kundër shqiptarëve të Kosovës, por edhe kundër Partisë së Punës e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, kundër vijës dhe politikës së tyre të drejtë ndaj Jugosllavisë. Shqipërinë e akuzojnë as më shumë, as më pak se "ka ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë".

Paskemi ndërhyrë, pse dënuam publikisht masakrat që u bënë në Kosovë, pse thamë të vërtetën se atje janë vrarë, plagosur e arrestuar me mijëra njerëz! Udhëheqësit jugosllavë, mos prisnin që tu dërgonim përshëndetje për këto krime e barbarizma? Paskemi ndërhyrë, pse thamë në artikujt tanë se kosovarët kanë të drejtë që kërkojnë statusin e republikës së federuar. Por kjo është një kërkesë legjitime, një kërkesë e popullit të Kosovës, të cilën nuk e kemi shpikur ne.

Udhëheqësit jugosllavë, këto ditë, kanë folur shumë për këto çështje, por asnjëri nuk ka shpjeguar pse Kosova nuk mund të jetë republikë. Ata vetëm përsërisin njëri pas tjetrit se kërkesa e Kosovës për të qenë republikë e federuar, qenka reaksionare, kundërrevolucionare, shoviniste etj. Ky pozicion, jo vetëm është pa asnjë bazë, por është në kundërshtim të hapët dhe flagrant edhe me qëndrimet programatike të PKJ-së të kohës së luftës mbi çështjen kombëtare dhe me shumë deklarata të personaliteteve më të larta të Partisë dhe shtetit jugosllav. Po më mirë le tu referohemi dokumenteve:

Kombi shqiptar është një, ai ka historinë, kulturën e gjuhën e tij të njëjtë

Marrëdhëniet arsimore, kulturore e shkencore që Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë ka zhvilluar, në radhë të parë me Kosovën, por më pak edhe me Republikën Socialiste të Maqedonisë dhe me atë të Malit të Zi (dhe me këto dy të fundit më pak jo se ka munguar vullneti ynë), për mendimin tonë kanë qenë shumë normale, frytdhënëse, të dobishme e korrekte për të dy palët. Këto marrëdhënie janë zhvilluar me marrëveshje të përbashkëta dhe me pëlqimin e të dy qeverive tona.

Besojmë se Qeveria e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë u ka dhënë pëlqimin e vet si Krahinës Autonome të Kosovës edhe dy republikave të federuara ku jetojnë shqiptarët. Por kjo është një çështje që nuk na përket neve. Të dy palëve na përket fakti që këto marrëdhënie zhvilloheshin në rrugë të drejtë, ato nuk kishin karakter politik, as nxisnin nacionalizmin, shovinizmin dhe irredentizmin. Asnjë reklamim për mungesë korrektese, për shkelje të ligjeve të njëres ose të tjetres republikë nga njerëzit që kanë vajtur dhe ardhur në vendet tona, nuk ka patur, asnjë incident, qoftë edhe i vogël, nuk ka ngjarë.

Ne kemi bindjen e plotë se këto marrëdhënie, siç keni qejf ta përsërisni shpesh herë, shërbyen si urë për forcimin e marrëdhënieve të popullit shqiptar me popujt e Jugosllavisë.

Këto marrëdhënie ekonomike, tregtare, arsimore e kulturore në mes Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Krahinës Autonome të Kosovës, pas turbullirave që ngjanë atje, jo për fajin tonë dhe pa as më të voglën nxitje e ndërhyrje nga ana jonë, udhëheqja e federatës Jugosllave i konsideroi si "ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë, si nxitje të shovinizmit shqiptaromadhi, si rivendikime territoriale, si irredentiste". Ajo këto marrëdhënie që po zhvillohen prej kohësh në dritën e diellit dhe jo në skuta, i cilësoi si frymëzim bazal të nacionalizmit shqiptar, i importuar nga Tirana, nga shkencëtarët, nga profesorët, nga akademikët, nga këngëtarët dhe valltarët tanë. Ky mendim shpifës dhe armiqësor nuk është shfaqur asnjëherë as si kritikë, as si vërejtje nga ana jugosllave.

Përkundrazi duam të theksojmë se personalitete nga më kryesorët të udhëheqjes shqiptare në Federatë dhe në krahinë, që u treguan nga më të egrit kundër demonstruesve në Prishtinë e gjetkë, vazhdimisht i kanë marrë njerëzit tanë të artit dhe të kulturës që shkonin në Kosovë si shembull dhe i kanë lavdëruar e falenderuar publikisht për mirësjelljet e tyre.

Udhëheqja jugosllave harron se kombi shqiptar është një, pavarësisht se një pjesë rron në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe pjesa tjetër në tre pjesë të Jugosllavisë Federative. Ai ka historinë, kulturën e gjuhën e tij të njëjtë, ai ka heronjtë e tij, poetët, piktorët, muzikantët e artistët e përbashkët. Ky është thesari i tij i madh që ai e ruan, e kultivon dhe e zhvillon. Këto janë tiparet kryesore të një kombi.

A mendojnë jugosllavët se këto tipare të kombit shqiptar duhet të shuhen, duhet të cilësohen si shenjat dhe dukuritë e një "nacionalizmi romantik të perënduar dhe të një shovinizmi të dënueshëm"?

Shkëmbimi i mendimeve midis njerëzve të Shqipërisë socialiste dhe shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi për pasurimin e gjuhës shqipe, për gjenezën e popullit shqiptar, për historinë e të parëve të tyre, për shkencat shoqërore dhe natyrore, a mund të konsiderohet si nxitje e shovinizmit dhe irredentizmit shqiptar? A mund të konsiderohen vallet dhe këngët tona popullore që janë shfaqur në Jugosllavi si nxitje e shovinizmit dhe të irredentizmit? Ky është thesari ynë, i të gjithë shqiptarëve, i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në veçanti. Planet e bashkëpunimit kulturor e arsimor dhe

programet e shfaqjeve të grupeve artistike jua kemi paraqitur qysh më përpara dhe ju i keni miratuar. Ato i ka pëlqyer shumë publiku dhe i ka duartrokitur. Të bukurën dhe të shëndoshën të gjithë e duan.

Ansamblët tona artistike kanë shkuar kudo. Ato janë pritur dhe duartrokitur me një simpati dhe entuziazëm të madh nga populli grek dhe udhëheqësit e tij, nga artdashësit dhe shtypi i këtij vendi. Po kështu vallet dhe këngët tona popullore i kanë pëlqyer shumë popullit turk dhe udhëheqësit e tij të çdo rangu. E njëjta gjë ka ngjarë në Francë, në Itali, në Algjeri, në Tunizi, në vendet nordike e kudo. Asnjë s'na ka akuzuar as për nacionalizëm, as për shovinizëm. Ata kanë respektuar ndjenjat tona dhe ne kemi respektuar të tyre.

Pyesim: Pse ky qëndrim i udhëheqësve jugosllavë? Çfarë i shqetëson ata në kokën dhe në ndjenjat e tyre? Pse nuk e kanë ndërgjegjen të qetë? A mos mendojnë ata se kanë shkuar më shumë njerëz ose grupe njerëzish nga ana jonë në Jugosllavi, se sa kanë ardhur prej andej te ne? Statistikat tregojnë të kundërtën, dhe ne gëzohemi.

Apo mos duan të gjejnë një arsye pa bazë që këto marrëdhënie t'i ngushtojnë, që shkëmbimet në shkencat, në kulturë, në arte dhe në vajtje-ardhjet e njerëzve t'i zvogëlojnë? Këtë e zbuloi zoti Dushan Ristiç, kryetar i Kuvendit të Kosovës kur tha se "të gjitha protokollet mbi bashkëpunimin e institucioneve dhe organizatave kulturore-arsimore etj. të Kosovës dhe organizatave kulturore-arsimore të mos zbatohen më".

Federata dhe organet e tjera kompetente po të duan mund të bëjnë ashtu siç kërkon Ristiçi. Kjo është në të drejtën e tyre. Ne dyert e botës nuk i hapim me pahir. Ne për veten tonë do t'i kemi dyert të hapëta për të gjithë miqtë e sinqertë, cilëtdo qofshin dhe veçanërisht për vëllezërit tanë shqiptarë që jetojnë në Jugosllavi. Kjo do të shërbejë që ata të shohin "skëterrën shqiptare", sikurse thonë udhëheqësit kryesorë të Krahinës Autonome të Kosovës dhe të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, dhe ta barazojnë atë me "parajsën jugosllave" sikurse themi ne.

Për mendimin tonë ne po themi që më përpara: në rast se jugosllavët i marrin këto masa nacionaliste, shoviniste, ky do të jetë një gabim i madh nga ana e tyre. Shqiptarët e Jugosllavisë dhe gjithë populli shqiptar do t'i dënojnë ata dhe me të drejtë do të thonë se jugosllavët kanë frikë nga zhvillimi i kulturës shqiptare dhe s'kanë frikë nga kultura dekadente!

Po u themi miqësisht jugosllavëve, që masa të tilla nuk do ta qetësojnë opinionin shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera të Jugosllavisë. Ne jemi të bindur se edhe opinionin i shëndoshë jugosllav e ai botëror do ta dënojë gjithashtu këtë veprim.

Edhe një herë e kemi për detyrë t'u themi udhëheqësve jugosllavë, të ruajnë gjakftohtësinë në mendime dhe në veprime. Udhëheqja jugosllave të shikojë me drejtësinë më rigoroze nevojat e shqiptarëve të Jugosllavisë, të mos i trajtojë keq dhe të mos i diskriminojë ata, të shikojë më seriozisht dhe me objektivitet kërkesat e ligjshme të kosovarëve, të mos prekë dhe të mos trajtojë keq rininë heroike shqiptare, veçanërisht rininë studenteske, mësuesit, profesorët dhe gjithë inteligjencien e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, të mos i konsiderojë Universitetin e Prishtinës dhe shkollat fillore e të mesme shqiptare si çerdhe armiqsh, kundërrevolucionarësh, shovinistësh etj., të mos e sakatosë Universitetin e Prishtinës me pretekstin se ka superprodhim të të shkolluarve dhe t'i hallakatë studentët shqiptarë në të gjitha universitetet e Jugosllavisë. Askush nuk gënjehet dhe kushdo e kupton përse bëhet kjo. Shqiptari nuk e harron "vendin ku ka lerë dhe ku e ka nderë". Mos tentoni të këpusni kokën e rinisë, e lules së bukur shqiptare të Kosovës, se shqiptarët s'e kanë kursyer kurrë gjakun për dije dhe liri.

Asnjëherë nuk mund të ketë superprodhim të shkolluarish, në qoftë se shtohet prodhimi në Kosovën e pasur dhe të varfër njëkohësisht. Për këtë zhvillim të Kosovës duhen marrë masa serioze, pa ju lejojmë të bërtisni sa të doni se në Republikën popullore

Socialiste të Shqipërisë "populli s'ka të hajë, s'ka liri, s'ka kisha e xhami". Punëtori shqiptar kosovar, që punon thellë në minierat, nuk pranon që të shfrytëzohet nëntoka dhe mbitoka të braktiset, që vëllezërit e tij të varfërohen, të vriten nga plumbat.

Ua themi këto disa udhëheqësve jugosllavë, të cilët janë të arsyeshëm, që t'i kenë parasysh këto të vërteta, se vrapë që kanë marrë disa udhëheqës të tjerë të fantaksur, prepotentë dhe antishqiptarë, mund të shkaktojnë katastrofa akoma më të rrezikshme, që më vonë do të jetë vështirë t'u gjendet zgjidhje e drejtë.

Nuk duam t'ju japim mend dhe as të ndërhyjmë në punët e brendshme tuajat, por po jua themi për të mirën e përbashkët të të dy vendeve tona se shumë i keni acaruar çështjet me kosovarët, me shqiptarët e viseve tjera dhe me emigracionin ekonomik shqiptar jashtë Jugosllavisë. Ju po krijoni ndasinë të këta të fundit. S'janë "agjencitë diplomatike të RPSSH" zoti Miniç, që e bëjnë këtë dasi, por jeni ju.

Ne kemi bindjen e plotë se Kosova nuk mund të jetë për minimin e federatës. Por Federata duhet të studiojë dhe të zgjidhë me drejtësi çështjen e madhe të të drejtave të shqiptarëve të Kosovës, që vetë këta e kanë hedhur në tryezë, që vetë Titoja, Mosha Pijade, Miladin Popoviçi e kanë trajtuar nga ana teorike dhe praktike.

Kosova duhet të qetësohet,....po Kosova do të qetësohet po të hiqet shtettrrethimi, të hiqet ushtria dhe policia ndëshkuese serbe, të normalizohet gjendja, të lirohet të burgosurit e pafajshëm që kanë mbushur burgjet, t'u kthehen familjeve të vrarët e tyre në demonstrata, se kjo është një çështje e shenjtë dhe humanitare. Studioni me vëmendje dhe me drejtësi kërkesën e popullit të Kosovës për republikë, zgjidhni drejt problemet ekonomike të saj. Vetëm kështu do të qetësohet Kosova, vetëm kështu do të jetë një mike e republikave tjera, brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Kosova kërkon statusin e Republikës brenda Federatës Jugosllave. Ky status përfaqëson aspiratën e një populli të madh që kërkon me të drejtë "statusin e sovranitetit" dhe jo atë të "pakicës kombëtare", që padrejtësisht i ka pasë qenë caktuar që në Jajcë. Serbomadhi dhe armiku i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Millovan Gjillasi, në shkrimet e tij, ka zbuluar arsyet e kësaj padrejtësie, që mjerisht asnjëherë udhëheqja aktuale jugosllave nuk i ka përgënjeshtuar.

Kërkesa e Kosovës për të fituar statusin e republikës federale është e drejtë. Ajo këtë e ka merituar me luftën që ka bërë bashkë me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër fashizmit. Shovinizmi serbomadh e ka gjakosur rëndë Kosovën dhe ka krijuar një situatë të tillë, që me ekspedientë zor se shërohet.

A dëshironi ju, zotërinj udhëheqës jugosllavë, që kjo sëmundje të gangrenoset? Ju mendojeni vetë, por ne nuk e duam një gjë të tillë. Kjo sëmundje duhet shëruar menjëherë, drejt dhe me kurajo.

Me manevra, me kombinacione, me fokuse, me kërcënime që njerëzit të flasin atë çka u diktohet nuk shërohet plaga. Vëllazërimi vendoset me zemër të hapët, me çiltërsi, me sinqeritet, me njerëz që i do dhe ka besim populli shqiptar i Kosovës. Këta mund e duhet ta mbushin hendekun e madh që u krijua jo për fajin e popullit shqiptar kosovar. E ndjejmë për detyrë t'ju themi këto të vërteta miqësisht. Ju, po të doni, i hidhni poshtë, na ngjitni çfarëdo epiteti që t'ju vijë përdore. Bota e përparuar le të na gjykojë si ne, ashtu edhe ju.

Popujt e Jugosllavisë dhe populli shqiptar duan miqësi me njëri-tjetrin, por miqësia duhet të vendoset në baza të shëndosha.

"Etnia e pastër", "Shqipëria e vogël" dhe "Shqipëria e Madhe"

Ngritja e shpatave dhe e mburojave kundër nesh nga ana e udhëheqjes jugosllave u bë sigurisht për të mbuluar diçka të tmerrshme dhe të dënueshme që ngjau në rrugët e qyteteve dhe fshatrave të Kosovës, ku u derdh gjak i shumtë i popullit.

Sa u vranë dhe si u vranë? Kjo mbahet e fshehtë, por populli shqiptar i Kosovës i di djemtë dhe vajzat e tij që janë vranë, torturuar, zhdukur e burgosur. Sa më shumë të fshihet e vërteta, aq më e rrezikshme bëhet. Gjaku nuk bëhet ujë! Kjo nuk duhet harruar. E vërteta e plotë për tragjedinë e Kosovës do të dalë në shesh dhe ajo do të jetë e llahtarshme dhe me konsekuenca.

Zoti Stane Dolanci, në intervistën që u dha gazetarëve të huaj mbi ngjarjet në Kosovë, tha në mes të tjerave se "Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk ka gisht në këto ngjarje". Zoti Dolanci është një nga udhëheqësit kryesorë, në mos kryesori, në Komitetin Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Atë që afërmoi, ai e kishte të bazuar, të faktuar.

Por kush e fryu gënjeshtren? Kush e shtrembëroi të vërtetën? Kujt i interesonte që të akuzohej Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë se gjoja kishte gisht në trazirat e Kosovës? Këtë le ta zbulojë udhëheqja jugosllave, zoti Miniç dhe zoti Vidiç, por ajo që u kurdis ishte një vepër monstruoze, ishte një furtunë mërie që hapi një hendek të tillë, sa që çdo jugosllav i papjekur politikisht, emrin "shqiptar" mund ta barazojë me "armik të popujve të Jugosllavisë". Ata që hapën këtë hendek janë përgjegjës përpara popujve të tyre, duke përfshirë këtu edhe shqiptarët që jetojnë në jugosllavi. Ata janë përgjegjës përpara historisë.

I gjithë Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë i dënoi njëzëri pa të drejtë ngjarjet në Kosovë, dënoi kosovarët, dënoi shqiptarët e Jugosllavisë, dënoi Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë si nxitëse të këtyre turbullirave.

Por ne dijmë të bëjmë edhe dallime në mes atyre që morën fjalën në forumin e lartë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Ne konstatuam se udhëheqësit kryesorë të Republikës fqinje të Malit të Zi e të Maqedonisë, por edhe të Kroacisë e të Sllovenisë, megjithëse i dënuan ngjarjet, u treguan më gjakftohtë, më të përmbajtur, më tej pamës për situatat që do të zhvillohen më vonë në mes të shqiptarëve dhe të jugosllavëve, në mes të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Nuk mund të bëjmë të njëjtin vlerësim për udhëheqësit kryesorë të Serbisë, siç janë zotërinjtë Miniç, Vidiç, Stamboliç. Fjalimet e tyre karakterizohen nga një egërsi e shfrenuar, nga një dell shovinist serbomadh i paparë ndonjëherë kundër popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi dhe kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Për sa u përket atyre "udhëheqësve shqiptarë" që morën fjalën në këtë forum të lartë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ose jashtë këtij forumi, fjalimet e tyre u karakterizuan nga një histeri sa e madhe, aq edhe servile e shërbyese ndaj zotërinjve të tyre Vidiç, Miniç, Stamboliç, etj. Kuptohet se këta njerëz nuk mund ta qetësojnë Kosovën. Këta "udhëheqës" fantoshë i urren populli i Kosovës.

Në të gjitha mbledhjet e forumeve të larta shtetërore e partiake të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, pothuajse nga pjesa dërmuese e diskutantëve, u kërkua që të rishikohen marrëdhëniet me Shqipërinë etj. etj. Dy herë brenda tridhjetë vjetëve e keni thyer kupën me Shqipërinë Socialiste.

Mos mendoni të na frikësoni? Mos ju shkon ndërmend se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë merr frymë në saje tuaj? Ju gaboheni! Juve ju janë errur sytë nga megalomania jugosllavomadhe.

Ne e kemi mendjen e ftohtë dhe zemrën e zjarhtë. Ne bëjmë edhe me restriksionet që ju mendeni të shkaktoni në marrëdhëniet në mes të të dy vendeve tona. Tymi do të ecë drejt në oxhakun tonë, edhe sikur ju t'i prisni fare këto marrëdhënie.

Ne, nga ana jonë, nuk e duam në asnjë mënyrë një gjë të tillë, se s'jemi ne që i krijuam situatat e vështira në Kosovë dhe në tërë Jugosllavinë. Ato i keni krijuar vetë. Ne s'kemi të bëjmë fare me to. Prandaj akuzat që bëni kundër nesh janë një pretekst që ju e ngrini artificialisht për të mbuluar ngjarjet e shëmtuara.

Edhe një herë ju themi, kini kujdes! Jini gjakftohtë! Fajet tuaja mos i ktheni në konflikt me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, se kjo është në interes të armiqve tanë.

Zoti Miniç në Komitetin Qendror të LKJ bëri një provokim të rrezikshëm duke thënë se "udhëheqja shqiptare nëpërmjet eksponentëve, diplomacisë duke përfshirë edhe ambasadën në Beograd dhe agjentëve të saj nxiti grupet irredentiste shqiptare, që kishin për qëllim të destabilizonin dhe dezintegronin Jugosllavinë". Ne mendojmë se ky personalitet nuk flet në emër të Qeverisë së RSFJ, mbasi po të qëndronte puna siç pretendon zoti Miniç, që një ose dy persona, ose tërë një ambasadë bëjnë veprime subversive, atëherë qeveria jugosllave ka të drejtë, siç ka të drejtë edhe qeveria shqiptare e çdo qeveri tjetër në raste të tilla, t'i shpallë këta njerëz persona non grata, bile edhe të presë marrëdhëniet diplomatike.

Këtë gjë se kanë bërë as qeveria jugosllave, as qeveria shqiptare, sepse një veprimtari e tillë nuk ekziston.

Këtë praktikë zoti Miniç e di. Por ato që thotë ai janë të shpikura për të mbrojtur një kauzë të humbur.

Megjithatë pas fjalimit të zotit Miniç ne nxorëm konkluzionin se ky na paska vënë nën kontroll gjithë ambasadat tona në vende të ndryshme, pa le ambasadën e Shqipërisë në Beograd. Këtë gjë e konfirmoi ministri i Punëve të Brendshme të Jugosllavisë Franjo Herleviç, i cili gjithashtu, duke akuzuar përfaqësitë diplomatike shqiptare në vende të ndryshme dhe në Beograd se kanë nxitur ngjarjet e Kosovës, zbuloi se ambasadat tona kudo qenkan vënë nën kontrollin e policisë sekrete jugosllave. Kjo tregon se shërbimi sekret jugosllav duke gjurmuar ambasadat shqiptare vepron edhe në vende të tjera duke shkelur kështu sovranitetin e vendeve të tjera dhe ligjet ndërkombëtare. Kjo veprimtari është e palejueshme dhe e dënueshme.

Pretendimet e Herleviçit janë trillime të shërbimeve të tij, shpifje qëllimkeqe, që u leverdisin atyre qarqeve reaksionare të brendshme e të jashtme të interesuara për keqësimin dhe prishjen e marrëdhënieve midis Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Serbi Petër Stamboliç foli si një serbomadh i pakorrigjueshëm. Ai diti t'i mbrojë interesat serbe në kurriz të shqiptarëve dhe ndër të tjera tha se "përpyekja për pastërtinë etnike objektivisht çon në nacionalizëm". Këtë përpyekje ai e cilësoi fashiste. E pyesim zotin Stamboliç: populli serb a nuk është një etni? A nuk e konsideron ai edhe popullin shqiptar një etni? Pa dyshim që këta dy popuj janë dy etni. Në qoftë se zoti Stamboliç nuk e konsideron popullin serb një "etni të pastër", pse tok me të rrojnë edhe shqiptarë, malazezë, boshnjakë, turq, po ashtu edhe populli shqiptar nuk është një "etni e pastër", pse në Kosovë, ku shumica dërrmuese është e kombësisë shqiptare, rron tok me të edhe një minoritet serb, malazez e turk.

Në këto rrethana të njëllota zoti Stamboliç bën një fokus: etnia shqiptare është nacionaliste, fashiste, kurse etnia serbe nuk është e tillë. Por ky fokus nuk shkon: o të dyja etnitë çojnë "në nacionalizëm dhe në fashizëm; o të dyja nuk çojnë. Por në asnjë mënyrë nuk mund të ndodhë që njëra çon dhe tjetra nuk çon.

Pse zoti Stamboliç nuk e thotë më hapët se etnia më e madhe duhet të sundojë më të voglën, se e para duhet të jetë sovranë në Kushtetutë dhe e dyta jo, se kështu i vjen më mirë borgjezisë së etnisë më të madhe, që do të shfrytëzojë etninë më të vogël?

Ky teoricien serbomadh, që ndjek po atë vijë ultrareaksionare të akademikut famëkeq Çubrilloviç, duke dalë në tezën se "etnia e pastër" çon në fashizëm, në nacionalizëm, në praktikë do të thotë se "etnia shqiptare duhet të shpartallohet, të humbasë tiparet e kombit të vet, të degjenerohet pse na është bërë ferrë në këmbë".

Për zotin Stamboliç vetëm etnia serbe mund të rrojë në miqësi me popujt e tjerë, që ai i konsideron të dorës së tretë e të katërt, kurse etnia shqiptare sovranë në Kosovë nuk mund të rrojë në miqësi me minoritetet e Kosovës si serbë, malazezë e turq.

"Janë tronditur seriozisht marrëdhëniet midis shqiptarëve, serbëve dhe turqve", pohon zoti Stamboliç. Kjo është e vërtetë, por këto marrëdhënie janë tronditur vetëm ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Lexo fabulën e La Fontenit "Ujku dhe qengji" dhe do t'i gjesht arsyet zoti Stamboliç.

Nga mbledhja e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë sulmet kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë kaluan në mbledhje të ndryshme publike në Republikën e Serbisë, këtë herë me një virulencë të pashoqe. Ndonjë orator me frymë të tërbuar serbomadh dhe fashiste arriti deri atje sa të thotë "ta shpartallojmë regjimin stalinist të Shqipërisë".

"Delenda Kartago" bërtet në "sheshet serbe" ky Katon i ri. Mirëpo Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk është Kartagjena dhe nuk ka lindur akoma një Skipion serbomadh që të shkatërrojë Shqipërinë.

"Çdo gjë e kemi fituar me gjak", bërtiste ky Katon i ri. Po Shqipëria me se i ka fituar liritë? Pa gjak? Bile ajo i ka fituar vetëm me gjakun e saj. Ajo ka derdhur gjak edhe për lirinë e popujve jugosllavë. Për këtë as kemi qenë as do të jemi kurrë pishman. Po të jetë nevoja, përsëri do të derdhim. Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është e shëndetshme dhe plot dinamizëm. Dikush tjetër është e sëmura e Ballkanit.

Katonët e rinj të Serbisë na akuzojnë ne shqiptarët se e urrejmë popullin serb. Kjo është një shpifje monstruoze. Ne e kemi dashur dhe e duam popullin serb. Ne urrejmë vetëm shovinizmin serb, shovinizmin shqiptar dhe çdo shovinizëm tjetër, se jemi marksistë-leninistë, se jemi internacionalistë.

Shovinistët serbomëdhenj, për të maskuar shovinizmin e tyre, na vënë ne shqiptarëve titullin shqiptaromadh. Këtë parullë e krijoi Italia fashiste e Musolinit dhe janë të njohura qëllimet ekspansioniste-agresive të tij dhe ballistëve, siç janë të njohura edhe ato të çetnikëve serbë. Së toku të dy popujt tanë luftuan me heroizëm dhe i mundëm këta armiq të përbashkët.

Paslufta duhej të rregullonte marrëdhëniet në mes miqve dhe aleatëve shqiptaro-jugosllavë. Ne detyrën tonë internacionaliste e bëmë. Bashkë me partizanët jugosllavë luftuam për çlirimin e Jugosllavisë. Ju detyrën që duhej të bënit, për zgjidhjen në rrugë të drejtë të problemit të Kosovës s'e bëtë. Sikurse thamë më sipër, ju folët në parim për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi, por në praktikë zbatuat të kundërtën dhe vazhdoni të bëni demagogji.

Popullin shqiptar nuk e polli as Roma e Cesarëve, as sllavët e Stefan Dushanit, as sulltanët e Osmanëve dhe as Italia fashiste e Musolinit. Populli shqiptar ka historinë e tij shumëshekullore, plot me lufta për liri, për ekzistencë. U përpoqën armiqtë e tij ta zhduknin atë, po nuk mundën. Populli shqiptar luftoi dhe rrojti me shekuj. Ai qëndroi një etni kompakte, pavarësisht se e përçanë dhe e copëtuan. Kush e mohon këtë realitet, jo vetëm që shkakton të qeshura, por tregon dhe ndjenjat e tij të egra shoviniste. Shqiptarët e "Shqipërisë së vogël", prej gati tre milionësh, ose të "Shqipërisë së madhe", prej më tepër se pesë milionësh, janë të gjithë shqiptarë. Kësaj nuk keni se çfarë ti bëni zotërinj

shovinistë serbë. Ekzistojnë dy Gjermani, një e Lindjes dhe një e Perëndimit, ashtu siç ekzistojnë dy Kore, një e Jugut dhe një e Veriut. Por askush nuk dyshon se ekziston një popull dhe një komb gjerman i vetëm, ashtu siç ekziston një popull dhe një komb korean. Shqiptarët janë një etni, një popull, quaje "Shqipëri të vogël", ose "Shqipëri të madhe". Këta shqiptarë të kësaj "Shqipërie të vogël" ose "të madhe", që përbëjnë një popull kompakt dhe që kanë të gjitha tiparet e një kombi të vërtetë, as kanë zaptuar tokat e të tjerëve, as kanë shkelur të drejtat e ndokujt. Ata vetëm të drejtat e veta i kanë kërkuar dhe do ti mbrojnë. Këtë ju e gjeni të jashtënatyrshme, e quani "shqiptaromadhe", "nacionaliste", deri dhe "fashiste". Puna juaj. ("Zëri i popullit", 17 maj 1981)

Jusuf Gërvalla: *"Përmes shtypit jugosllav ke mundur të informohesh për një demonstratë të fuqishme të punëtorëve anë në Gjenevë, në të cilën qenë mbledhur më 30 maj më se 1000 punëtorë nga Zvicra e Gjermania dhe, të penguar për t'iu afruar ambasadës jugosllave, shkuan dhe demonstruan para selisë së Kombeve të Bashkuara. Kjo demonstratë i tërboi jugosllavët, të cilët këmbyen edhe replika bukur të ashpra të nivelit shtetëror me organet zvicerane, që kishin dhënë leje për mbajtjen e demonstratës. Pastaj, kur panë se s'ka gjë prej asaj pune, u kthyen në të shara e britma të egra kundër demonstrantëve gjoja se këta ishin gjysma ekstremistë (lexo: komunistë) dhe gjysma tjetër, ata të ardhur nga RFGJ, fashistë etj. Por, sido që të jetë, gjithë atë që kanë thënë deri më sot jugosllavët lidhur me demonstratat e punëtorëve kosovarë në mërgim, s'janë gjë tjetër pos klithma e përçarjeje të të dëshpëruarve."* (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981, Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 269)

10. GJENEZA SIPAS GJENAZEVE

GJENEZA E EMRIT "LËVIZJA NACIONALÇLIRIMTARE E KOSOVËS DHE VISEVE TJERA SHQIPTARE NËN JUGOSLLAVI" SIPAS GJENAZEVE

Partia Komuniste (PKMLSHJ): *"Pas pak ditësh Jusufi më njoftoi se „Zëri i Kosovës“ kishte dalë nga shtypi, por nevojiteshin 1.600 marka për ta tërhequr nga shtypshkronja. Më gëzoi fakti se gazeta kishte dalë jashtëzakonisht mirë, duke i përmbushur të gjitha standardet. Pas titullit me germa të mëdha - „Zëri i Kosovës“, shkruante: **Organ i Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ). Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte të „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe të Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 64)

Aktgjykim: *"Sepse për të kryer vepra penale kundër bazës së rregullimit shoqëror socialist vetëqeverisës, të sigurisë së RSFJ, e veçanërisht të cenimit kundër revolucionar të rregullimit shtetëror, të drejtuar në rrëzimin e pushtetit të klasës punëtore e njerëzve*

punues, shkatërrimin e bashkim-vllaznimit e të barazisë së kombeve e kombësive si dhe të ndërrimit antikushtetutar të rregullimit shtetëror federativ, gjatë vitit 1977 në Prishtinë, si një ndër organizatorët, në kontaktet e takimet e shpeshta me Sabri Novosellën dhe të akuzuarin Avdyl Lahu, me qëllim të masovizimit të grupit ilegal armiqësor të Kosovës dhe viset tjera të RSFJ ku jetojnë shqiptarët, merren vesh për formimin e organizatës **“Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës”** të cilën edhe e formojnë në vitin 1978 dhe vendosin që të njëjtën ta udhëheqë **“Komiteti Qendror”** e që njëri prej anëtarëve të tij të bëhet i akuzuari **Shefqet Jashari**” (AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË P - nr. 137/80, datë 4 qershor 1980, www.pashtriku.org)

Në këtë aktgjykim emri i organizatës thuhet se është: **“Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës”**

Aktgjykimet e përgatitura nga UDB-a mund të përmbajnë shumë të vërteta por në to ka edhe të pavërteta. Në këtë rast emri i Organizatës nuk është i plotë dhe askujt nuk i mbetet hatri pse UDB-a nuk e jep emrin e plot.

Emrin e plot e kemi të dhënë, apo sqaruar me shkrim, shtatë herë prej Jusufit, para datës 12 shtator 1981.

1. Jusuf Gërvalla: *"Prandaj, pasi ne nuk kemi pse të frikësohemi për "teorizime", do të thoshim se na duhet një program i denjë për një lëvizje të denjë. Me këtë rast duhet të vëmë në dukje se ne ende nuk kemi qenë në gjendje ta formojmë partinë tonë komuniste marksiste-leniniste, pa të cilën gati do të jetë e pamundshme hyrja konkrete në luftën e ardhshme nacionalçlirimtare dhe në revolucionin tonë. Kjo na nxjerr te një çështje tjetër që kërkon sqarim. Ishte Partia Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës e Shqipërisë) ajo që e pat themeluar Frontin Nacional Çlirimtar (sot Fronti Demokratik). Dhe kjo ishte rruga e drejtë. Te ne ka ngjarë e kundërta. Fronti i Kuq Popullor, i themeluar prej forcash patriotike, pret themelimin e partisë sonë komuniste marksiste-leniniste e cila do të vihet në ballë të luftës dhe të revolucionit. Sipas vlerësimeve të Frontit, arsyeja për këtë inverzion qëndron në kushtet konkrete, të cilat kanë ndikuar që forcat patriotike të masave të gjëra të ecin një hap përpara organizimit të komunistëve tanë. Në kësi konteksti e shohim aktivitetin e **Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe të Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi - një organizatë e hershme**, që ka mbledhur dhe mban rreth vetes njerëz me eksperiencë patriotike e revolucionare dhe me të cilën jemi duke bërë përpjekje për njohje reciproke dhe për bashkim. Në kësi konteksti jemi duke përcjellë gjithashtu edhe aktivitetin e Marksist-leninistëve të Kosovës, që po shfaqen këto kohët e fundit me organin e tyre "Liria". Duke u nisur nga kryeartikulli në numrin e parë të këtij organi, si dhe nga përmbajtja e tij përgjithësisht e nga trajtimi marksist-leninist i problemeve nga ana e krijuesve të "Lirisë", ne e vlerësojmë shumë të drejtë punën e Marksist-leninistëve kosovarë. Kjo na jep shpresë që së shpejti, ndoshta pikërisht nga radhët e tyre, do të realizohet edhe kërkesa e domosdoshme për themelimin e vetë partisë komuniste marksiste-leniniste." (Bashkimi bënë fuqinë, Bashkimi-Organ i Frontit të Kuq Popullor, **janar 1981**, faqe 2, shtylla 1)*

"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."

Pyetje e drejtpërdrejtë për Partinë Komuniste-PKMLSHJ, për të sqaruar në detaje:

Cila datë është më e hershme: Janari 1981 apo 12 shtatori 1981?

Në Lajmëtarin e lirisë, janar 1981 gjendet shkrimi "Një komb shqiptar, një shtet shqiptar", prezantimin e të cilin Jusufi e bënë në këtë mënyrë:

2. Jusuf Gërvalla: *"Ky artikull paraqet një trakt të Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi, i cili qarkullon që një kohë të gjatë në radhët e patriotëve dhe të revolucionarëve tanë."* (Lajmëtar i lirisë, janar-shkurt 1981, faqe 12)

"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."

Pyetje e drejtpërdrejtë për Partinë Komuniste-PKMLSHJ, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: Janari 1981 apo 12 shtatori 1981?

3. Jusuf Gërvalla: *"Gjëja më e rëndësishme lidhur me "Lajmëtarin" është se, duke qenë krejt i vetmuar, nuk e mora dot guximin ta emëroja atë si organ të LNÇKVSH. Kjo është e vetmja arsye pse në të nuk flitet e brohoritet në emër të Lëvizjes sonë. Mjafton ta përmend faktin se dy materialet e Lëvizjes, që i botova në numrin 3, i lëshova me njëqind druajtje, ngase nuk isha në gjendje të gjykoja vetë dhe të fitoj bindjen e plotë se a bëja mirë apo keq."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; E Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 263)

"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."

Pyetje e drejtpërdrejtë për Partinë Komuniste-PKMLSHJ, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: 13 maji 1981 apo 12 shtatori 1981?

4. Jusuf Gërvalla: *"Tash për tash po theksoj se udhëheqësi i këtij grupi (Rizah Salihu, nga Mushtishti, një provokator ose njeri shumë naiv dhe i rrezikshëm), provoi të organizonte me shokë likuidimin tim dhe të vëllaut tim, duke na quajtur " të dërguar specialë të UDB-së ", pikërisht për arsyen se i pata thënë që " Zëri i Kosovës " është organ i LNÇKVSH, kurse ai e kishte marrë për emër të grupit të vet."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; E Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 263)

Pyetje e drejtpërdrejtë për Partinë Komuniste-PKMLSHJ, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: 13 maji 1981 apo 12 shtatori 1981?

5. Jusuf Gërvalla: *"Sipas të gjitha gjasave, edhe LNÇKVSHJ edhe Marksistë-leninistët e Kosovës janë dy degë të të njëjtit trung."* (Letër Sabri Novosellës më 16 qershor 1981. E Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271).

"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."

Pyetje e drejtpërdrejtë për Partinë Komuniste-PKMLSHJ, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: 16 qershori 1981 apo 12 shtatori 1981?

6a. Jusuf Gërvalla: *"Thuajse rregullisht, veprimtaria e tyre është zbuluar dhe është ndëshkuar që në gjysmë të rrugës. Atyre u ka munguar konspiracioni i thellë, i domosdoshëm në veprimtarinë ilegale. Organizimi i tyre është bërë shpesh në suaza regjionesh të caktuara, të ngushta dhe vetëm në ndonjë rast të rrallë ato (si bie fjala më 1964) janë përhapur në ndonjë trevë më të madhe të tokave tona. Përfundim bën **Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi, për të cilën mendoj se jeni në dijeni dhe anëtar i së cilës jam dhe unë.** Kjo lëvizje vazhdimisht ka pasur parasysh si një nga qëllimet kryesore përfshirjen në gjë të vet të patriotëve dhe revolucionarëve nga të gjitha viset shqiptare. Pos kësaj, edhe anëtarët e saj kanë qenë nga të gjitha strukturat shoqërore, gjë që organizatës i ka dhënë një karakter të përgjithshëm shoqëror. Megjithatë të metat që janë përcjellë në aktivitetin e grupeve dhe të organizatave patriotike revolucionare të shqiptarëve në Jugosllavi, ne, para se t'i sulmojmë me kritikën tonë lidhur me ndonjë aspekt të posaçëm të tyre më në fund, siç është fare e natyrshme, ka qenë në përputhshmëri me mundësitë që afrojnë kushtet e përgjithshme shoqërore ndër ne."* (Letër Enver Hoxhës më 19 gusht 1980. Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99)

"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."

Pyetje e drejtpërdrejtë për Partinë Komuniste-PKMLSHJ, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: 19 gushti 1980 apo 12 shtatori 1981?

6b. Jusuf Gërvalla: *"Përfundim bën **Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi (LNÇKVSHJ), për të cilën mendoj se jeni në dijeni dhe anëtar i së cilës jam edhe unë.**"* (Letër Enver Hoxhës më 19 gusht 1980. Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 23)

"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."

Pyetje e drejtpërdrejtë për Partinë Komuniste-PKMLSHJ, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: 19 gushti 1980 apo 12 shtatori 1981?

7. Jusuf Gërvalla: *"Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina"*

RAPORT

mbi disa çështje rreth punës së organizatave Grupi komunist "Zëri i Kosovës" dhe Fronti i Kuq Popullor

Me përfaqësuesin kryesor të Grupit komunist "Zëri i Kosovës" jam njohur, pra, në fund të dhjetorit 1979. Quhet Riza Salihu, nga fshati Mushtisht. Ra fjala për organin e LNÇK "Zëri i Kosovës" dhe ai, me një ton të ashpër, shprehu dyshimin jo vetëm në

ekzistencën e këtij organi dhe të **LNÇKVSH**, por edhe në besnikërinë time. Arsyeja ishte se ai qëndronte vetë në krye të Grupit me të njëjtin emër dhe, meqë, siç del logjikisht, nuk dinte për ekzistimin e LNÇKVSH dhe kishte edhe vetë një logjikë të kufizuar, kurrësi nuk ia kapte rradakja të bënte dallimin në mes një organizate me emrin "Zëri i Kosovës" dhe një organi me titull "Zëri i Kosovës" që i takonte koincidentalisht një organizate krejt tjetër." (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."

Pyetje e drejtpërdrejtë për Partinë Komuniste-PKMLSHJ, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: korriku 1981 apo 12 shtatori 1981?

Ashtu siç qëndron puna me gënjeshtren rreth emrit të plotë të Organizatës, në të njëjtën mënyrë vlen edhe gënjeshtra e mëposhtme në fjalinë e cila fillon citatin e faqes 64, të cilin e kemi shqyrtuar:

"Pas pak ditësh Jusufi më njoftoi se „Zëri i Kosovës“ kishte dalë nga shtypi, por nevojiteshin 1.600 marka për ta tërhequr nga shtypshkronja."

Këtë shprehjen për ta tërhequr nga shtypshkronja do ta analizojmë në një pikë tjetër më poshtë.

**Jusuf Gërvalla e Xhafer Durmishi: "K O M U N I K A T Ë
E KOMITETIT QENDROR TË LËVIZJES NACIONALÇLIRIMTARE
TË KOSOVËS**

Për të fshehur shkakun e vërtetë të demonstratave dhe trazirave të sivjetme në Krahinën e Kosovës, skamjen e mjerimin, shtypjen nacionale, sociale e kulturore të popullsisë vendëse, qeveria shoviniste e Beogradit, me kryepolicin Herleviç në krye, u hodh në të katër anët për të kurdisur arsye të paqena, si "romantizëm nacional" dhe "nacionalizëm e shovinizëm shqiptar" si dhe për të gjetur "organizatorin" e demonstratave, duke fajësuar herë një "grup huliganësh", herë "ekstremistët" shqiptarë, (duke pasur në këtë rast parasysh Marksistë-Lenistët e Kosovës) herë organizatën Fronti i Kuq Popullor etj., në mënyrë që pastaj të kthehet e t'ia ngarkoj fajin kryesor Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Ndër "organizatorët" e shumtë, kryepolici Herleviç, zuri ngoje edhe organizatën tonë patriotiko-revolucionare me emrin Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës, duke e fajësuar atë për shumë "vepra" që nuk përkojnë aspak me veprimtarinë e saj.

Stane Dolanc: "I njohim cilët janë organizatorët. Ata janë në Shtutgart , në Bruksel, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës."

E kemi parë të udhës që, pasi në mjetet e informimit publik të Perëndimit u publikuan "informatat" e përpunuara nga agjencitë gazetare jugosllave, t'ju drejtohem me një kërkesë demokratike edhe ne: për dezinformimet e ndryshme rreth ngjarjeve tragjike të Kosovës; ne do të kishim pasur një satisfaksion, po që se do ta transmetoni në organet

tuaja edhe këtë komunikatë nga ana e Komitetit Qendror të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës.

1. Demonstratat e Kosovës të këtij viti nuk i ka organizuar LNÇK. Ato kanë shpërthyer spontanisht, së pari në Universitetin e Kosovës, e pastaj janë përhapur në të gjitha viset e Kosovës. Shkaku dhe arsyeja e shpërthimit të tyre nuk mund të kërkojnë askund tjetër, pos në revoltën e grumbulluar me dhjetëra vite te popullsia shqiptare për shkak të skamjes, mjerimit dhe padrejtësive nacionale që i bëhen popullit tonë nga ana e qeverisë shoviniste të Beogradit.

2. Kërkesa për t'iu njohur Kosovës statusi i republikës së federuar jugosllave nuk është kërkesë e LNÇK. Organizata jonë lufton për çlirimin e tokave shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me vendin amë, Shqipërinë, dhe kështu për krijimin e shtetit unik shqiptar brenda kufijve kombëtarë. Kjo shihet nga Statuti dhe Programi, nga të gjitha dokumentet e LNÇK të botuara në organet "Zëri i Kosovës" dhe "Lajmëtari i lirisë", si dhe në të gjitha traktet tona.

Kërkesa për republikën e Kosovës është kërkesë e një pjese të inteligjencies së Kosovës. Çështja e saj është shtruar më herët, sidomos më 1968. Pasi ajo u refuzua nga ana e Titos dhe e qeverisë jugosllave, në Kosovë patën shpërthyer në nëntor të vitit 1968 demonstrata të fuqishme. Edhe atëherë edhe sot, kjo kërkesë u përkrah nga mbarë populli shqiptar në Jugosllavi. Por, LNÇK mbetet pranë kërkesës së saj të vetme – luftës për bashkimin e ligjshëm të të gjitha trojeve shqiptare të robëruara nga Jugosllavia dhe bashkangjitjen e tyre shtetit amë.

3. Nga Statuti, Programi dhe të gjitha dokumentet e LNÇK del qartë se ne nuk e aprovojmë dhe nuk e aplikojmë asnjë formë terrori dhe anarkie. As sot LNÇK nuk merr përsipër as përgjegjësinë më të vogël për aktet e "terrorit" e të "anarkisë", që i trumbeton me të madhe policia sekrete jugosllave, siç është djegia e ndonjë fabrike a ndërmarrjeje, përdhunimi i monumenteve kulturo-historike, i varrezave serbo-malazeze etj. (...)Komiteti Qendror

i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës

Kjo komunikatë u përpilua nga Jusuf Gërvalla e Xhafer Durmishi në korrik 1981, në Untergruppenbach dhe u nënshkrua si: "Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës". (www.pashtriku.org)

Shtrohet pyetja: pse në korrik 1981, Jusufi dhe unë e përdorim emrin Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës?

Këtu duhet të kihet parasysh se kjo Komunikatë është përgjigje direkte kryepolicit Franjo Herleviç (në këtë kohë eprori kryesor i Abdullah Prapashticës). Herleviçi akuzon organizatat e ndryshme për organizimin e demonstratave, e në mesin e tyre edhe Lëvizjen e Jusufit. Në këtë rast eprori i Abdullah Prapashticës e përdor atë emër që e ka përdorur UDB-a në përgatitjen e aktgjykimit të 4 qershorit 1980, d.m.th. Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës. Këtë emër (Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës) e transmetojnë agjencitë e gazetat e ndryshme botërore.

Komunikata e mësipërme ishte pikërisht një dokument që iu drejtohej agjencive të lajmeve dhe gazetave të ndryshme. Për të mos shkaktuar huti se për cilën organizatë është fjala Jusufi dhe unë e përdorim vetëm emrin Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës.

Kjo është e vërteta në këtë pikë. Këtu është shumë interesant të shohim se si Abdullah Prapashticës (përndryshe 'organizator' i demonstratave të vitit 1981) i ka bërë përshtypje më vendimtare lufta dhe nomenklatura e përdorur ndaj Herleviçit se sa letra dërguar Enver Hoxhës. Por është e kuptueshme që Partia Komuniste (PKMLSHJ) të tregon më tepër respekt për emrin e përdorur me eprorin e saj Herleviçin se sa me Enver Hoxhën.

Dhe në fund të kësaj pike është me rëndësi të përgjigjemi në pyetjen: Pse Abdullah Prapashtica është aq shumë i angazhuar në punët e brendshme të LNÇKVSHJ-së, dhe mundohet ta sqaroj **në detaje** (në të cilat therret aq keq) me pocërkën e vet, gjenezën e mbaresës 'Viseve shqiptare në Jugosllavi'.

"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."

Abdullahu është i interesuar në këtë pikë sepse po të ishte si thotë ai, rrjedhimi do të ishte: OMLK-ja është marrë vetëm me çështjen e shqiptarëve për atë territor që është quajtur Krahina Socialiste Autonome e Kosovës. Jusuf Gërvalla dhe Lëvizja e tij e kanë bërë të njëjtën gjë. Ushtruesi i profesionit të policit politik, Abdullah Prapashtica është i vetmi që me partinë e tij "komuniste" është brengosur e ka luftuar për të gjithë shqiptarët në Jugosllavi.

Shefqet Jashari: *"Hetimet zgjatën 7-8 muaj. Është vështirë të përmenden gjithë hetuesit që merrnin pjesë në maltretime. Veçmas kanë qenë të pashpirt Asllan Sllamniku, Sllavkoviqi dhe njëfarë Muharremi. Kam pasur rastin ta njoh edhe Abdullah Prapashticën, e cili e shikonte duke më rënë me këmbë në këmbë i pashpirti Asllan Sllamniku."* (Gjatë vitit 1980 -shën. i Xh. D.)

11. KËRKESA "KOSOVA – REPUBLIKË" NUK MUND TË SHUHET AS ME DHUNË, AS ME TEORIZIME BOSHE

"Zëri i popullit", 12 shtator 1981 - Nga Arbër Korabi

Ngjarjet e mars-prillit të këtij viti shtruan me një mprehtësi të veçantë një çështje të madhe – atë të pozitës kushtetuese të Kosovës dhe përgjithësisht të popullsisë shqiptare në Jugosllavi në kuadrin e federatës. Parulla "Kosova – republikë", e ngritur në mënyrë të ndryshme edhe më parë, tani ka pushtuar masën e gjerë. Ajo ka dalë tani sheshit, flitet me zë të lartë, atë e gjejmë në traktet dhe thirrjet, në sheshet dhe rrugët e qyteteve, në rrugicat e fshatrave, në muret e shkollave dhe të ndërtesave publike, kudo në Krahinë. Më kot skuadrat shetitëse të "mbrojtjes territoriale" ta shuajnë e ta mbulojnë, me gjithë terrorin në ngritje, ajo shfaqet prapë. Çka është kryesorja, ajo është rrënjësuar tanimë thellë në zemrat dhe mendjet e njerëzve që përbëjnë shumicën dërmuese të popullsisë.

Muajt që kanë kaluar që prej pranverës, kanë nxjerrë në shesh se "Kosova – republikë" është një kërkesë reale, e kohës, është një kërkesë së cilës nuk mund t'i bëhet bisht. Duan ose nuk duan serbomëdhenjtë të pranojnë, ajo po bëhet një nga problemet më djegëse në jetën e brendshme të Jugosllavisë. Si problem i shtruar për diskutim ajo ka fituar të drejtën e qytetarisë. Ajo nuk është më një temë tabu. Dhe po të kemi parasysh gjerësinë dhe forcën e lëvizjes, mund të themi me plot bindje se ajo nuk do të bjerë nga rendi i ditës deri sa të marrë zgjidhjen e saj më të drejtë.

"Kosova-republikë", përpara se të jetë një aspiratë shpreh një protestë. Është një protestë e fuqishme e një popullsie prej dy milionësh, e cila tani ka jo vetëm vetëdijen e numrit, të madhësisë, por edhe ndjenjës e drejtësisë së kauzës së saj. Është zëri i një popullsie që ka një përvojë të gjatë ndjekjesh e keqbërjesh në kurriz të saj, bashkë me një traditë të shkëlqyer të qëndresës së pamposhtur e kryelartë. Mesazhi i saj, i përhapur tanimë gjithandej nëpër botë, është i thjeshtë dhe i qartë: ajo nuk do të pranojë të merret nëpër këmbë, nuk do të lejojë të trajtohet si një racë inferiore përkundrejt kombeve ...

*
* *

Shtypi jugosllav i rangut republikan apo federativ qoftë, u përpoq për një kohë të gjatë ta minimizoj ose ta injoroj këtë parullë. Të gjithëve u kujtohet nënvlerësimi dhe mospërfillja me të cilën e pritën atë fillimisht në Beograd e gjetkë. Ngjarjet e Kosovës u përshkruan gati-gati si një akt rebelimi të thjeshtë, si një shpërthim brutal rrugësh i turmës së pavetëdijshme, pa shkak dhe pa ndonjë qëllim të qartë. Përrallat mbi "shpirtin retrograd shkatërrues" të shqiptarit u përhapën gjerësisht në një orvatje për të përligjur kundërveprimin e përgjakshëm të policisë.

Është një tjetër provë e forcës së lëvizjes, e pjekurisë së saj, e vitalitetit të kërkesës, në qoftë se sot në shtabin drejtues të propagandës antishqiptare janë detyruar të bëjnë një kthesë. Krahas reprezaljeve të rënda, që bien mbi krye të demonstruesve kosovarë dhe në kuadrin e gjithë fushatës propagandistike që shoqëron aksionin ndëshkues në Kosovë, po bëhen përpjekje për t'i shkuar në ndihmë "diferencimit ideopolitik" duke shpjeguar "pse Kosova nuk mund të bëhet republikë".

Pikërisht ky është titulli i përgjithshëm me të cilin "Borba" organi qendror i Lidhjes Socialiste të Punonjësve të Jugosllavisë, ka dalë këto kohët e fundit me një varg artikujsh, me çka ajo mund të themi i jep fund njëfarë qëndrimi "të distancuar", "nga lart" e "nga larg" rreth ngjarjeve të Kosovës, duke u përpjekur të na japë njëkohësisht një analizë dhe një sintezë. Artikujt i janë besuar penës së publicistit Jovan Rajçeviç, i cili merr mundimin të nxijë faqe të tëra për t'i dhënë përgjigje pyetjes që është ngritur jo vetëm në Kosovë, por edhe në opinionin e gjerë botëror: pse Kosova nuk mund të jetë republikë, cilat janë arsyet që e shtyjnë udhëheqjen jugosllave të tregohet kaq e ngurosur në këmbënguljen e saj për të hedhur poshtë një kërkesë, e cila, në mos është në germën, është padyshim në frymën e Kushtetutës së Jugosllavisë (po që se sigurisht e marrin seriozisht këtë Kushtetutë).

Jusuf Gërvalla: <i>"Kërkesa e shqiptarëve për Republikën e Kosovës, siç tha Arbër Korabi, edhe në mos qoftë në germën, është në frymën e Kushtetutës jugosllave."</i> (Zëri i Kosovës, Nr.2, Janar 1982, faqe 4)
--

Vërejtja e parë që vjen në mendje nga leximi i një materiali të tillë është se, ndërsa aty përpara këtë çështje nuk denjonin as ta zinin në gojë, tani sidoqoftë janë të shtrënguar të diskutojnë, të arsyetojnë. Po merret me të vetë organi qendror i Lidhjes Socialiste të Punonjësve të Jugosllavisë.

Bie në sy, së dyti, se artikujt kanë pretendimin të jenë më tepër sesa një shkrim publicistik i thjeshtë: ato paraqiten si njëllot studimi pseudoshkencor me trajtime teorike-doktrinare, në të cilën faktorët politik, ekonomikë, juridikë, etnikë, psikologjikë mbledhen bashkë për të rrëzuar "Kosovën – republikë".

Ajo që i karakterizon artikujt e Borbës në mënyrë të veçantë, ideja kryesore që i përshkon tej e mbanë është teza, se çështja kombëtare në Jugosllavinë e pasluftës ka gjetur

zgjidhjen më të drejtë e më të plotë, se madje federata jugosllave përbën një shembull të papërsëritur nga kjo anë, një model të paarritshëm deri më sot në botë. Diku Rajçeviçi lëshon sfidën: "a ka vallë sot në përgjithësi në botë, qoftë në Lindje apo në Perëndim apo edhe në vendet e ashtuquajtura në zhvillim" një rast tjetër që, në pikëpamje të trajtimit të çështjes kombëtare, t'i afrohet atij të Jugosllavisë?

Kështu, shpjegimi i parë e më i përgjithshëm që jepet se "pse Kosova nuk mund të jetë republikë" është se çështja kombëtare sot në Jugosllavi nuk ngrihet, sepse ajo është zgjidhur me kohë, se ngjarjet në Kosovë nuk janë gjë tjetër veçse një "aksident në rrugë e sipër", që nuk mund ta prishë harmoninë e "bashkësisë", atmosferën e "bashkim-vëllazërimit" që mbretëron në marrëdhëniet midis popujve dhe kombeve të Jugosllavisë. Nga kjo lihet të kuptohet se aksioni i shqiptarëve të Kosovës është një fenomen krejt i izoluar, që stonon, që përbën një "nonsens" përkundrejt tablosë tërësore të paqes kombëtare të realizuar në federatë. Njoftimet e shtypit të huaj vënë në dukje se si në opinionin jugosllav po krijohet e po kultivohet një psikozë fajësimi të shqiptarëve: këta janë vënë në shënjestër dhe tregohen me gisht si burimi kryesor, në mos i vetmi, i të gjitha të këqijave që po kalon Jugosllavia në këtë fazë.

Ky vlerësim global na jepet si një postullat, si një e vërtetë absolute. ... Ne kemi pasur dhe kemi opinionin dhe pozicionin tonë, ne kemi thënë dhe themi se revizionizmi jugosllav as në teori e as në praktikë, nuk jep bazë për një trajtim të shëndoshë të çështjes kombëtare. I nisur e i kristalizuar si një deformacion i thellë i doktrinës marksiste – leniniste në planin më të gjerë, ai nuk mund të mos soset me një dështim edhe në këtë fushë. Në të vërtetë politika nacionale në Jugosllavinë titiste nuk është vendosur asnjëherë në themele të qëndrueshme, në parime solide të përshkuara nga ideale socialiste. Ajo ka qenë një politikë e inspiruar e inspiruar nga pragmatizmi, një politikë koniukturash, ekuilibri të kontradiktave dhe grindjeve ndërnacionale. Kjo është arsyeja që rivalitetet midis kombeve e grupeve të ndryshme etnike sllave e jo sllave përbëjnë një nga tiparet më karakteristike të jetës së brendshme të federatës jugosllave. Kjo ka çuar shpesh në zhvillime të bujshme, si rënia e Rankoviçit më 1966 dhe spastrimet e viteve 70 në dy republikat më të rëndësishme – atë serbe e kroate. Të gjitha këto shpërthime tronditëse kanë pasur në themel çështjen kombëtare. Nuk bindin asnjëri mburrjet e "Borbës" se në këtë fushë "zhvillimi i Jugosllavisë ka shkuar normalisht e pa tronditje".



"Pianoja" e Jusuf Gërvallës në Shtutgart pas mesit të shtatorit 1981

Ajo që ka më tepër rëndësi – dhe këtu do të përqëndrohet doemos vëmendja jonë më e madhe – është se operacionet kryesore për "zgjidhjen e çështjes kombëtare" në Jugosllavi pas lufte, ujdite dhe koncesionet e ndryshme janë kryer në kurriz të kombësisë shqiptare. Të drejtat themelore të saj janë bërë fli në "altarin e paqes kombëtare" në federatën jugosllave. Asgjë tjetër nuk e nxjerr në pah më mirë natyrën e vërtetë të politikës nacionale të në Jugosllavinë titiste. Shqiptarët dhe viset e banuara prej tyre janë përdorur si gur shahu në lojën e paprincipitë për të platitur grindjet midis republikave sllave. Zhvillimet e mëtejshme janë të njohura, por përsëritja është ilaçi më i mirë kundër kujtesave të shkurtra e të zbehta. Pjesa më e madhe, trangu – Kosova – u la nën sqetullën e Serbisë, kurse resti – degët – u ndanë midis Maqedonisë dhe Malit të Zi. Për mendimin dhe dëshirën e shqiptarëve as që u pyet fare. gjeneza)

Shqiptarët në të në të dy anët e kufirit i janë përmbajtur kurdoherë një vije konsekuente. Ata nuk ranë në grackën e "Shqipërisë së madhe" të markës fashiste, ata besuan në idealet e Luftës Nacionalçlirimtare, në parimin e vetëvendosjes së kombeve dhe mbi këtë bazë në Bujan, në Dhjetor 1943 – Janar 1944, shqiptarët e asaj ane në formën dhe në instancën e duhur kërkuar bashkimin me Shqipërinë si një të drejtë të fituar me luftën e tyre. Vetë Titoja në takimin me shokun Enver në vitin 1946 deklaronte se Kosova ishte shqiptare. Por shpejt doli se për udhëheqjen e Partisë komuniste jugosllave njohja gjatë Luftës Nacionalçlirimtare e parimit të vetëvendosjes deri në shkëputje për popullin e Kosovës ishte në fakt, dhe këtë e tregoi rrjedha e ngjarjeve, thjesht një çështje taktike. Nuk u pranua as varianti i republikës "punëtore – fshatare" të Kosovës të parashtruar që më 1940 nga një figurë e tillë e PKJ si Mosha Pijade. Deklarata e premtje solemne u hodhën prapa krahëve dhe Kosova, pas shkëputjes nga trangu shqiptar, copëtohej sërish brendapërbrenda federatës jugosllave.

*
* *

Gjatë këtyre muajve kemi dëgjuar të thuhet se akordimi i statusit të republikës Kosovës do të minonte nga themelet federatën jugosllave, se një gjë e tillë do të vinte në pyetje vetë strukturat federative. Në këtë rast arsyetimi është zhvilluar në një vijë juridike kushtetuese dhe mbi këtë bazë kërkesa "Kosova – republikë" është cilësuar si e kundërligjshme, antikushtetuese.

"Borba" i përsërit pak a shumë këto parashikime apokaliptike. Edhe Rajçeviçi bën fjalë për një "pështjellim" të madh që gjoja do të krijohej në sistemin federativ jugosllav po të pranohej kërkesa e popullsisë shqiptare. Po si mund të hidhet poshtë seriozisht një kërkesë e drejtë me argumente formale juridike? Federata jugosllave me ndarjet e nënndarjet e saj të brendshme, është ngritur pa pjesëmarrjen e shprehjen autentike të vullnetit të shqiptarëve në etapat e ndryshme të krijimit të Jugosllavisë federative, as gjatë Luftës Nacionalçlirimtare (në mbledhjen e AVNOJ-it në fund 1943 shqiptarët jo vetëm nuk morën pjesë, por as u përmendën fare) e as pas lufte kur iu hodh çatia ndërtesës federative. I vetmi akt që u përket shqiptarëve është vendimi i Bujanit, pavarësisht se serbomëdhenjtë sot mund ta quajnë atë një episod fatkeq, madje një njollë të zezë në historinë e Luftës Nacionalçlirimtare. Rrjedhimisht, edhe kur çështja të përballohet nga pozita formaliste rigoriste kemi të bëjmë me një "ves juridik" në procesin e krijimit të federatës në atë pjesë që ka të bëjë me të drejtat e popullsisë shqiptare, një "ves" që përjashton përgjegjësinë e saj për gjithçka është vendosur **lidhur me të**, në etapat dhe instancat e ndryshme. Apo mos vallë "Borba" i referohet "legalitetit" të Jugosllavisë së

kralëve për të zhvleftësuar kërkesën për ndryshimin e pozitës së shqiptarëve në Jugosllavinë e sotme.?!)

Në përgjithësi është vënë re qartë tendenca e propagandës jugosllave për të vënë përballë kërkesës "Kosova – republikë" disa vështirësi të natyrës kushtetuese, të cilat zmadhohen qëllimisht jashtë çdo mase. Kjo mund të duket një strehë komode, por është krejt e paqëndrueshme. Këtu problemi kthehet me kokë poshtë; për mendjen e shëndoshë premisa e arsytimit në këtë rast duhet të jetë: a është e drejtë kërkesa dhe jo çfarë pengesash mund të dalin eventualisht për realizimin e saj në praktikë. Po të jetë vullneti i mirë, pengesat janë të kapërcyeshme. Pastaj ç'është ky fetishizim juridikoformal i akteve kushtetuese?

Kushtetutat, edhe pse akte themeltare, nuk janë të pandryshueshme, të përjetshme. Nuk ka kushtetutë në botë që krahas dispozitave kryesore, të mos parashikoj edhe procedurat përkatëse për korrigjimet apo plotësimet e nevojshme. Nuk bën përjashtim në këtë drejtim as Kushtetuta e federatës jugosllave. Federata jugosllave ka në themelin e vet një padrejtësi që i është bërë popullsisë shqiptare, prandaj çështja shtrohet në thelb dhe nuk mund të vlejnjë konsideratat procedurale. Shqiptarët nuk mund të mbajnë mbi supe barrën e kombinacioneve që janë kryer në kohën e vet në dëm të tyre. Shqiptarët në kërkesën e tyre nuk nisen aspak nga një dëshirë e thjeshtë për të shpërthyer kornizat kushtetuese jugosllave, synim është të vënë në vend të drejtat e tyre. Përfundimi del vetvetiu: autorët e këtyre kombinacioneve duhet ta zgjidhin nyjen mbi bazën e zgjidhjes së drejtë të çështjes kombëtare në Kosovë, duke i njohur asaj statusin e republikës, të pjesëtares së barabartë të federatës jugosllave.

Një arsye që është përmendur shpesh për t'ia kundërvënë kërkesës "Kosova – republikë" është edhe ajo e "autonomisë specifike", e cila na përshkruhet si fenomen unikal, "i panjohur deri më tani nga teoria dhe praktika politiko-ligjore". Që fraza të tingëllojë më bindëse shtohet aty për aty se "vërtet krahina e Kosovës është pjesë e Republikës serbe", por është njëkohësisht edhe një "element konstituiv i federatës" me disa të drejta "që krahasohen me ato të republikave". Me këtë rast bëhet një listë e gjatë e posteve dhe përgjegjësi që mund të marrin pjesëtarët (sigurisht të seleksionuar) të kombësisë shqiptare në të gjitha strukturat shtetërore në shkallë republike apo federative. Natyrisht, kjo e tëra është e llogaritur për mendjen naive, me shpresë se opinioni mund t'i hajë të tilla truke të tejdukshme.

Këtu spekulohet me të ashtuquajturin "element konstituiv federal" që ka një karakter deklarativ e formal, por nuk ndryshon thelbin, domethënë le të paprekur pozitën e Kosovës, e cila ka si përmbajtje jo autonominë politike shtetërore, por autonominë administrative. Krahina e Kosovës sot në sistemin e federatës është edhe juridikisht një komponentë subalterne e Republikës Serbe. Padyshim që autonomia administrative që ka sot Kosova është një arritje, fryt i përpjekjeve dhe i luftës së vetë kosovarëve kundër tendencave centralizuese që kanë synuar gjithnjë ta reduktojnë në një njësi të thjeshtë të ndarjes territoriale të brendshme. ... por ato mund të ndryshojnë sipas rrethanave, sipas presioneve të kësaj ose asaj rryme që merr sipërinë në jetën politike.

Nuk është për t'u çuditur që në mbledhjet e panumërta në forumet e shtetit e të partisë të të gjitha niveleve, në korin e rekriminacioneve për "lëshimet" që gjoja u janë bërë kosovarëve, diskutues të ndryshëm, zëdhënës të klanit shovinist serbomadhi, kanë ngritur fort zërin për rishikimin dhe ngushtimin e kësaj autonomie. Dhe nga fjalët tani po kalohet në vepra. Shovinizmi serbomadhi po godet me kopaçe të madhe. Një aspekt i politikës represive që po bie mbi krye të popullsisë shqiptare janë terrori policor, ndjekjet gjyqësore e administrative, përjashtimet në masë, hedhjet në mes të katër rrugëve. Një aspekt tjetër jo më pak i rëndësishëm është goditja frontale kundër realizimeve arsimore, kulturore e shkencore të arritura në krahinën e Kosovës. "Borba" nuk mungon t'i

përmendë këto arritje si një dëshmi të rëndësishë së kësaj autonomie, si një provë të vlerës së saj për afirmimin e popullsisë shqiptare. Por fjalët e saj tingëllojnë sot si një tallje cinike, kur janë vënë në shënjestër Universiteti i Prishtinës, shkollat, institucionet shkencore e kulturore, kur është në zhvillim e sipër një ofensivë e përgjithshme kundër vlerave të historisë dhe kulturës kombëtare. Në maskën e luftës kundër "miteve të së kaluarës" dhe "romantizmit nacional" po zhvillohet një aksion në shkallë të gjerë, që ka për qëllim tek e fundit privimin e popullit të Kosovës nga historia e tij, mohimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve, shkrirjen e tyre me masën sllave. Po nxjerr krye një tendencë e fortë për rikthimin të politika e asimilimit, megjithëse ajo nuk ka sjellë veçse dështime dhe bile tronditje.

Është qesharake orvatja e "Borbës" për t'i paraqitur ngjarjet e Kosovës si rezultat i një deviacioni nga politika zyrtare, deviacion që i mvishet së ashtuquajturës "burokraci nacionale" të Krahinës. Me këtë kuptohet shtresa e nëpunësve shqiptarë të strukturave lokale, shtetërore e joshtetërore, të cilët gjithnjë sipas "Borbës", të asistuar nga "inteligjencë me prirje të theksuara nacionaliste", paskan lejuar dhe bile nxitur një proces largimi nga "bashkësia socialiste" që ka përfunduar në një vetëmbyllje në guaskën e ngushtë kombëtare. Jo, zotërinj të Borbës, nuk kalojnë të tilla mistifikime! Kursi që është ndjekur kundërt popullsisë shqiptare, ka qenë studiuar mirë, ka qenë përcaktuar me kohë e me vetëdije të plotë në instancat më të larta jugosllave. Me këtë kurs lidheshin disa synime "me qitje të afërt e të largët" si kundërt popullsisë shqiptare në Jugosllavi (si një element i kalkulimeve politike në jetën e brendshme), ashtu edhe në raport me Shtetin Shqiptar të pavarur që shpresohet të binte, në fund të fundit, si një pemë e arrirë në "shportën" jugosllave. Udhëheqja supreme jugosllave mund të jetë zënë në befasi nga rezultatet konkrete të kësaj politike, por jo nga fakti i zbatimit të kësaj politike, që ka qenë formuluar prej saj në të gjitha hollësitë dhe detalet e mundshme. Asgjë nuk është bërë në krahinën e Kosovës që të mos kenë pasur dijeni organet e pushtetit qendror në Beograd. Sa për një shembull: edhe Konferenca e 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, së cilës tani shtypi jugosllav i rikthehet për t'i dhënë disa ngjyra skandaliste, ka pasur **nulla osta-n** e organeve më të larta federative. "Borba" hesht për këto dhe ia hedh fajin njëfarë "burokracie nacionale", se paska shpërdoruar "autonominë specifike"! Sot e vërteta është: kjo politikë i është nënshtruar një rishikimi rrënjësor që ka dy karakteristika kryesore: në njërin anë sulmi, sulmi kundër arritjeve të shqiptarëve dhe, në anën tjetër, fushë e lirë revanshit të rrymës shoviniste serbomadhe.

Në kërkim të argumenteve për ta hedhur poshtë kërkesën "Kosova – republikë" si teorikisht të pathemeltë dhe praktikisht të parealizueshme, "Borba" e atakon atë duke pretenduar se ajo implikon atë që ajo quan "lidhje vertikale të të gjithë pjesëtarëve të kombësisë shqiptare" në Jugosllavi, pavarësisht nga vendbanimi i tyre. Fjala është për një "lidhje" pushteti që do të përfshinte jo vetëm popullsinë e Kosovës në kufijtë aktual Krahinës autonome ...jo sipas parimit territorial që është baza e çdo organizimi të mirëfilltë të jetës shtetërore. Këtu gazeta e Beogradit kujton se i lan duart duke bërë aluzion për luftën që pati bërë në kohën e vet Lenini kundër orvatjes së Bundit për të dalë si një qendër përfaqësuese e të gjithë punëtorëve çifutë të Rusisë duke u bazuar pikërisht në parimin e "lidhjes vertikale kombëtare". Së pari nuk mund të mos bëhet vërejtja: derisa hidhet poshtë në bllok kërkesa "Kosova – republikë", nuk kuptohet pse mirret mundim të diskutohet për disa implikime të saj të mëtejshme. Kur hiqet koka, ç'rëndësi kanë gjymtyrët? Së dyti, edhe pse trashëgimia leniniste ka pësuar në duart e revizionistëve jugosllav shtrembërimet më të pabesueshme, prapëseprapë të habit guximi i tyre, kur duan të nxjerrin Leninin si dëshmitar për të përligjur një vepër shtypjeje kombëtare! E kë? Leninin që ishte një mbrojtës plotë pasion i më të vegjëlve dhe që fshikullonte pa mëshirë në radhë të parë borgjezinë "e vet" rusomadhe!

Sa për thelbin e çështjes, ky është një falsifikim trashanik, një mashtrim përpara syve. As problemi i shqiptarëve në Jugosllavi nuk krahasohet me atë të çifutëve në kohën e Rusisë cariste, as kërkesa "Kosova – republikë" nuk ngjan as prej së largu me pretendimet e Bundit për bashkimit e të gjithë çifutëve nën një "lidhje vertikale kombëtare". Punëtorët çifutë aso kohe ishin të shpërndarë në vise të ndryshme të Perandorisë ruse, kurse popullsia shqiptare në Jugosllavi paraqitet kompakte jo vetëm nga pikëpamja etnike, por edhe nga ajo territoriale. Viset e banuara prej shqiptarëve në Jugosllavi përbëjnë, kryesisht, një tërësi territoriale natyrore. Gjeografia flet në favor të shqiptarëve. Kurse pikërisht këtu e shikon "rrezikun" më të madh "Borba": se "republika e Kosovës" do të çonte në përqëndrimin territorial të kombësisë shqiptare në Jugosllavi nën "një ombrellë të vetme", dhe kjo do të bënte që disa vise të banuara nga popullsi shqiptare) do të shpërpulleshin nga Serbia, Mali i Zi e Maqedonia për t'iu bashkuar "rajoneve kompakte shqiptare". Por, a ka kërkesë më të drejtë e të arsyeshme? Pse shqiptarët e Jugosllavisë duhet të jenë të shpërndarë nën tri "ombrella" të ndryshme dhe të mos bashkohen nën një "ombrellë" të vetme, atë të republikës së tyre, gjithmonë brenda federatës jugosllave? Dhe ja ku na vënë përpara, si një pengesë tjetër të pakapërcyeshme, ndarjen territoriale ekzistuese brenda kësaj federate. Vërejtja që u bë më lart lidhur me statusin e Krahinës është një lloj e vlefshme edhe për ndarjen territoriale: kjo ndarje është bërë pa popullsinë shqiptare. Pas lufte u shpall se ndarja e re administrative në Jugosllavinë e çliruar do të bëhej mbi bazën e kriterit kombëtar. Mirëpo, për sa i takon popullsisë shqiptare, ky kriter u shkel me të dy këmbët. Territori i banuar nga shqiptarët u copëtua në tri republika dhe në një krahinë autonome. kjo u bë për dy qëllime kryesore: së pari, ishte një lëshim që i bëhej konceptit të "Serbisë së madhe" dhe krijoheshin kushte për një politikë shtypëse e asimiluese kundrejt shqiptarëve; së dyti, përdoreshin viset e banuara nga popullsi shqiptare për t'i dhënë konsistencë demografike dhe territoriale dy republikave më të vogla – Malit të Zi dhe Maqedonisë. Pra, edhe ky operacion gërsërësh hyn në kuadrin e politikës pragmatiste që u adoptua për kapërcimin e kontradiktave të lindura në terrenin e çështjes kombëtare. Edhe këtu popullsia shqiptare u dënua të hiqte shpenzimet e këtyre kombinacioneve. Por këto nuk janë të dhëna një herë e përgjithmonë, nuk janë të pandryshueshme. Kjo është çështje vullneti politik dhe jo vështirësish të natyrës kushtetuese.

*
* *

Në më se një rast, pas ngjarjeve të Kosovës, disa qarqe në Jugosllavi kanë zgjedhur organe të shtypit perëndimor për të shprehur në "konfidencë" disa ndjenja dhe mendime të tyre më "intime" lidhur me këto probleme. Tërheq vëmendjen në mënyrë të veçantë gazeta franceze "Lë Mond" ... Kohët e fundit ajo botonte një shkrim të ... Që në fillim Jankoviçi prek çështjen e statusit të Kosovës dhe bën të njohur përgjigjen "e prerë, definitive" që i është dhënë në Beograd kësaj çështjeje. Kosova, – shton ai, – "nuk do të fitoj kurrë" pozitën e republikës në federatën jugosllave.

Shpjegimi që jepet në këtë refuzim kategorik përveç që është i padëgjues, ka edhe meritën të jetë mjaft domethënës. Pra: Kosova nuk mund të bëhet republikë, sepse, **"Jugosllavia është mëmëdheu i popujve të saj sllavë dhe jo i shqiptarëve të Kosovës që e kanë mëmëdheun matanë kufirit, në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë"**. A mund të thuhet më troç? A mund të shpallet më qartë pabarazia e shqiptarëve në kuadrin e federatës jugosllave? Asnjëherë nuk është thënë deri më sot se Jugosllavia është federatë e republikave sllave. Nuk e gjejmë këtë as në kushtetutë. Si duket, disa qarqe influente, në nivel republikan apo federativ qoftë, të ndodhura përballë

presioneve të shumanshme, të kapura nga euforia represive, e kanë humbur toruan dhe po hapin e po hedhin në tryezë shumë letra që i mbanin fshehur thellë. Sigurisht, kur thuhet se mëmëdheu i shqiptarëve të Kosovës (e të gjithë Jugosllavisë, shtojmë ne) është RPS e Shqipërisë, thuhet një e vërtetë dhe kësaj nuk i hiqet asnjë vizë. Por është afër mendjes se "Borba" nuk e përmend këtë për të denoncuar ndarjen e kombit shqiptar më dysh si një padrejtësi të madhe historike. Sot konsiderohen si herezi edhe ato që ka thënë për këtë një socialdemokrat internacionalist serb si D. Tucoviçi që në kohën e Luftës së Parë Botërore. Qëllimi këtu është, as më pak e as më shumë, që të përdoret lidhja etnike e popullit shqiptar të Kosovës me popullin shqiptar në Shqipëri, si një argument për t'i mohuar të parit të drejtën të jetë i barabartë me popujt e tjerë brenda federatës jugosllave. Kjo merr ngjyra raciste. Këtu kemi të bëjmë me një orvatje që synon të justifikojë njëlloj "apartheid"-i kundrejt popullsisë shqiptare, pikërisht për shkak të përkatësisë etnike. Nga kjo del, atëherë, se Krahina e sotme e Kosovës nuk është aspak një formë e organizimit shtetëror që i hap fushë afirmimit të kësaj popullsie, por një mjet diskriminimi, mënjanimi që duhet ta mbaj atë të mbërthyer fort në pozitën inferiore aktuale. Ja, ky është kuptimi i "autonomisë specifike"!

"Borba" në serinë e artikujve të saj ruhet ta zërë në gojë drejtpërsëdrejti këtë lloj arsyetimi. Por i bën padyshim jehonë duke manovruar me disa konsiderata të natyrës – do të thoshim – juridikondërkombëtare. Këto nuanca duket se merr teza se "një komb nuk mund të ketë dy shtete kombëtare", se derisa ekziston një shtet më vete i kombit shqiptar nuk mund të krijohet një shtet shqiptar i dytë, nuk mund të ketë vend për dy shtete paralele të të njëjtit komb. Lidhur me këtë duhet bërë e qartë se në rastin tonë nuk është aspak fjala për krijimin e dy shteteve kombëtare shqiptare. Propagandistët e Beogradit edhe këtu bëjnë një hile. Ata shtiren sikur nuk e kuptojnë se kërkesa për republikën e Kosovës nuk shtron aspak krijimin e një shteti të dytë kombëtar shqiptar me atributet e një subjekti me vete në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ajo synon vetëm ndryshimin e statusit të Kosovës, ngritjen e saj nga krahinë autonome në rangun e një republike, por gjithmonë brenda kuadrit të federatës jugosllave. "Borba" u referohet rasteve të krijimit të shteteve kombëtare "duale" pas Luftës së Dytë (dy Gjermanitë, dy Koretë), të cilat i cilëson si rezultat i luftërave me "pasoja të rënda në marrëdhëniet ndërkombëtare" dhe si "vija të para të frontit të konflikteve midis blloqeve". Pavarësisht se krahasimi këtu nuk qëndron, sepse republika e Kosovës nuk do të ishte një shtet më vete, siç dalin dy Gjermanitë dhe dy Koretë në kohën e sotme, prapë është me vend të bëhet pyetja: mos vallë copëtimi i popullit shqiptar më dysh është rezultat i proceseve paqësore? Shkëputje e Kosovës nga trugu shqiptar është poashtu pasojë e luftërave, konkretisht e luftërave ballkanike dhe e Luftës së Parë Botërore.

Propaganda e Beogradit, dhe në këtë pikë "Borba" ndalet në mënyrë të posaçme, u bie këmbanave të alarmit lidhur me ngjarjet në Kosovë duke valëvitur jo vetëm rreze të brendshme të federatës jugosllave, por edhe zhvillime kërcënuese në planin e politikës ndërkombëtare, në shkallë ballkanike dhe bile evropiane. Çështja paraqitet sikur jo vetëm stabiliteti i Jugosllavisë së "paangazhuar" e "jashtëbllokiste", por edhe paqja në këtë zonë janë të lidhura me një pe të hollë me strukturimin e brendshëm të federatës jugosllave. Pas kësaj vjen një breshëri akuzash "të tmerrshme" në adresë të RPS të Shqipërisë, e cila, duke dalë në mbrojtje të bashkatdhetarëve të vet, jo vetëm "ndërhyn në punët e brendshme të një shteti të huaj", "minon rendin e tij të brendshëm", por edhe rrezikon paqen, prish ekuilibrin në Ballkan e në Evropë, u hap rrugën komplikacioneve ndërkombëtare dhe ndërhyrjes së superfuqive! Politika e jashtme e vendit tonë shpallet "aventuriste", "ekspansioniste".

Bllofet janë një metodë e njohur në politikën e jashtme jugosllave, por jo deri në të tilla kulme. RPS e Shqipërisë ka deklaruar më se një herë, me gojën e përfaqësuesve të

saj më të lartë, se nuk është e interesuar për dobësimin e Jugosllavisë, për destabilizimin e saj, se, përkundrazi, populli shqiptar do të luftojë përkrah popujve të Jugosllavisë në rast agresioni nga kushdo qoftë. Por, mos vallë stabiliteti i Jugosllavisë qëndron në statuskuonë juridike të brendshme? Arsyeja e shëndoshë nuk mund ta kapë që themelet e federatës jugosllave mund të minohen nga ndryshimi i thjeshtë i pozitës së një krahine që kërkon të ngrihet në rangun e republikës në federatë. Duke përkrahur kërkesat e vëllezërve tanë në Jugosllavi, ne veprojmë brenda caqeve të normave ndërkombëtare, që i njohin "Shtetit-amë" të drejtën e kujdesit për bashkatdhetarët jashtë kufijve. Veç kësaj, ne kemi bindjen se plotësimi i kërkesës së popullsisë shqiptare do të eliminonte një burim pakënaqësie e trazirash dhe do të çonte, në fund të fundit, jo në dobësimin, por në forcimin e gjendjes së brendshme në Jugosllavi. Interesi i popujve të Jugosllavisë dhe i gjithë zonës ballkanike, po të kuptohet drejt, e do që problemi i shqiptarëve në Jugosllavi të mos lihet të bëhet gangrenë. Kjo mund të arrihet jo me anë të reprezaljeve të egra policore, as me fushata propagandistike denigruese, por duke i njohur popullsisë shqiptare një pozitë me dinjitet në sistemin e federatës jugosllave.

Në vijim të kësaj bisede të zgjatur e të fryrë rreth ndërlkimeve të brendshme e të jashtme, që do të shoqëronin gjoja detyrimisht plotësimin e kërkesës së shqiptarëve, është edhe teza e "Borbës" që i identifikon ata (shqiptarët e Jugosllavisë) me një "pakicë kombëtare". Ajo përpiket të zbërthejë konceptin e "pakicës kombëtare" duke na dhënë përmbajtjen e regjimit të kësaj pakice.

"Çështja themelore e jetesës për një pakicë kombëtare në kuadrin e një shteti tjetër", thotë gazeta e Beogradit është që të ketë "të drejta të plota kombëtare", si p.sh., "përdorimin e gjuhës amtare dhe të shkollave në gjuhën e vet" dhe që këto "të jenë të garantuara me ligj". Një pakicë kombëtare, shton ajo, nuk mund të pretendojë të ketë shtetin e vet në kuadrin e shtetit tjetër. "Borba" manifeston edhe një shije për këshilla e moralizime, kur thotë se "pakicat kombëtare janë një aspekt i pashmangshëm i procesit të krijimit të shteteve", se "nuk është e mundur të caktohen kufijtë e shteteve në mënyrë të tillë që në përbërje të tyre të përfshihet një popullsi kombëtare plotësisht "e pastër" dhe "homogjene"; prandaj... "pakicat kombëtare nuk duhet të jenë mollë sherri, por ura afrimi midis popujve".

Ky arsyetim për ne është i ngritur mbi një themel të kalbët, ai çalon që në nisje. Popullsia shqiptare në Jugosllavi nuk është pakicë kombëtare. Deri tani vetë propaganda jugosllave mburrej se termi "pakicë kombëtare" ishte fshirë nga terminologjia zyrtare, sepse, thuhej, shpreh njëfarë qëndrimi nënvleftësues kundrejt disa grupeve etnike, njëfarë gjendjeje inferioriteti të tyre në krahasim me pjesët e tjera të "bashkësisë". Nuk e gjejmë këtë term as në kushtetutën jugosllave. Tani ndofta janë penduar, dhe ja ku na nxjerrin përsëri "pakicat kombëtare". Shumëkujt mund t'i përshtatet koncepti i pakicës kombëtare dhe natyrisht nuk shtrohet çështja që të eliminohet ai as nga praktika e brendshme shtetërore, as nga ajo ndërkombëtare. Por për popullin shqiptar në Jugosllavi ky koncept është tepër i ngushtë. Këtu është fjala për gati gjysmën e popullit shqiptar që ndodhet brenda federatës jugosllave. "Borba" preferon t'u referohet shifrave për të vërtetuar tezën e saj dhe llogarit se popullsia shqiptare në Jugosllavi përbën 7-8 për qind të popullsisë së përgjithshme, ndërsa arrin në 14-15 për qind në Republikën e Serbisë. Sidoqë përqindjet janë "retushuar" në njëfarë mase, kemi të drejtë të bëjmë pyetjen: pse të mos shkohet me të tilla llogaritje? Çfarë vendi zënë popullsia e Malit të Zi, ajo e Maqedonisë në numrin e përgjithshëm të popullsisë jugosllave? Nga pikëpamja e numrit popullsia malazeze dhe ajo maqedone vijnë në fund fare të tabelës së klasifikimit e, megjithatë, nuk janë pakica kombëtare dhe kanë republikën e tyre. "Borba" mban heshtje për faktin se popullsia shqiptare sot në Jugosllavi arrin në rreth dy milionë frymë dhe, pra, për nga madhësia është e treta në gjithë federatën jugosllave. E dimë tani se është një "argument" tjetër: kjo

popullsi nuk është sllave. Atëherë edhe njëherë bëhet e qartë se pengesë nuk është konsistenca numerike, por diskriminimi mbi baza kombëtare.

Zëdhënësit e shovinizmit serbomadhi shikojnë edhe të tjera "rreziqe" në eventualitetin që popullsisë shqiptare t'i njihej e drejta të organizohej në një republikë më vete. Kështu "Borba" thotë se republika e Kosovës, po të pranohej, do të ishte një formë shtetërore për mbylljen e kombësisë shqiptare në kornizat e ngushta të "etnisë" së vet, gjë që do të çonte në "një shkëputje izoluese nga jeta dhe komunikimi me pjesët e tjera të federatës". Në këtë rast, sipas parashikimeve të "Borbës", pjesëtarët e kombësisë shqiptare "do të shfrytëzonin shtetin kombëtar të porsakrijuar" "për t'u çliruar nga kompleksi i pakicës", për të vendosur hegjemoninë e vet, "për të absolutizuar interesat e kombësisë shqiptare". Kjo do të bënte që pjesëtarët e kombeve dhe kombësive të tjera në këtë shtet të porsakrijuar do të gjendeshin në pozitën e pakicave kombëtare në raport me kombësinë shqiptare. Do të vijonin orvatje për shpërnguljen e këtyre pakicave dhe përgjithësisht grindje e përleshje reciproke. E gjithë kjo vetëm sepse do t'u jepej shqiptarëve e drejta për të pasur republikën e vet.

Me një fjalë, po të bëhet Kosova republikë, pakica serbe që jeton atje do të shtyhet, nuk do të ketë asnjë të drejtë. Zotnia i "Borbës" në gjykimin e tij nisët nga një fakt konkret, që shqiptarëve aktualisht, duke qenë si pakicë në Republikën e Serbisë, u janë mohuar të gjitha të drejtat. Dhe ai mendon se pozita e sotme e shqiptarëve në Kosovë nesër do të jetë e serbëve. Prandaj e vetmja alternativë për të është mohimi i të drejtave të tyre.

Pretendimi për të ashtuquajturën "ksenofobi" të shqiptarëve, për "paaftësinë" e tyre për një bashkëjetesë qytetare me grupet e tjera etnike është më tepër se shpifje. Duhet jo vetëm një mospërfillje për të vërtetën, por edhe një ngarkesë jo e vogël djallëzie që të bëhen insinuata të tilla për një popullsi që ka qenë vazhdimisht viktimë e ndjekjeve, që ka provuar në kurrizin e saj të gjitha llojet e shpërthimeve të idesë serbomadhe. Jo, zotërinj të "Borbës", ju nuk e cënoni dot nderin dhe emrin e mirë të shqiptarëve edhe në sjelljet e tyre me grupet e tjera etnike. Mjaft të kujtojmë kohën e Luftës Nacionalçlirimtare: mund të përmenden me qindra raste masakrash të ustashëve, të çetnikëve në pjesë të ndryshme të Jugosllavisë në dëm të popullsisë sllave, por jo në Kosovë, përgjithësisht në viset e banuara prej shqiptarëve. Jo rrallë kosovari shkeli mbi të kaluarën e hidhur dhe e mori komshiun e tij sllav nën mbrojtje për t'i shpëtuar atij jetën, pasurinë prej pushtuesve.

Së fundi, zëdhënësit e shovinizmit serbomadhi nuk pushojnë të na çuditin me logjikën e tyre: shqiptarët mund të jenë pakicë kundrejt të tjerëve (është gati një fat i tyre), kurse të tjerët nuk mund të jenë pakicë kundrejt shqiptarëve! Edhe këtu notat raciste nxjerrin krye. Ne e kemi pasur gjithnjë të qartë se ideologjia shoviniste serbomadhe ka si element të pandarë paragjykimet antishqiptare që arrijnë deri në absurde.

*
* *

Makina propagandistike jugosllave është vënë e gjitha në lëvizje lidhur me ngjarjet në Kosovë. Mjetet kryesore të komunikimit publik: shtypi, radioja, televizioni janë hedhur në veprim me ngarkesë të plotë. Fjalime, artikuj, biseda dhe emisione të panumërta kanë për qëllim të shtrembërojnë kuptimin e vërtetë të ngjarjeve, të banalizojnë kërkesat e shqiptarëve, të hedhin baltë kundër RPS të Shqipërisë, për qëndrimin që mbajti në mbrojtje të këtyre kërkesave. Tani "Borba" sjell "kontributin" e

vet në këtë fushë, duke parashtruar një "platformë" të tërë që mund të pagëzohej "antirepublika". I gjithë ky është një arsyetim i mjerë, i zhveshur nga çfarëdo forcë bindëse, pa kurrfarë themeli, që nuk u shton asgjë frazave të thata të thëna me kohë dhe që vjen të provojë edhe një herë sesa legjitime është kërkesa e shqiptarëve të Jugosllavisë dhe sesa boshe e të pafuqishme deri qesharake janë "argumentet" për të errësuar dhe për ta likuiduar këtë parullë. Në të vërtetë duhet pranuar ajo që është vënë re nga shumë anë, se revizionistët jugosllavë rrallë herë janë ndodhur në një pozitë kaq të ngushtë si ajo që është krijuar pas ngjarjeve në Kosovë: zor se gjendet një rast flagrant si ky, që të ketë zbuluar aq qartë hendekun e madh që ndan fjalën, teorizimet savante, frazeologjinë demokratike e socialiste nga vepra dhe realiteti i gjallë. Është fakt i pamohueshëm, se nën dritën e ngjarjeve të Kosovës dhe të qëndrimeve që po mbajnë udhëheqësit e Beogradit, Jugosllavia e sotme po del përpara opinionit përparimtar më të gjerë vërtet si ç'është, e kalbur, një shtet antidemokratik, që shtyp e vret nënshtetasit e saj.

Propaganda e Beogradit mund të lëshoj perde tymi me shumicë për të ruajtur atë mund të ruhet nga "prestigji" i Jugosllavisë "vetadministruese" e të "paangazhuar" në botën e jashtme. Por ajo nuk mund të mbulojë faktin se sot në Kosovë dhe në vise të tjera të banuara prej shqiptarëve është duke u kryer një vepër represive, shkombëtarizuese, antidemokratike dhe çnjerëzore kundër një popullsie kompakte. Kërkesa "Kosova – republikë" do të jehojë akoma me të madhe. Ashtu siç nuk mund të hiqet qafe një popullsi 2-milionshe me masa të ashtuquajtura "drastike", poashtu nuk mund të shuhet një kërkesë e drejtë me sofizma e teorizime boshe.

(Arbër Korabi, "Zëri i popullit", 12 shtator 1981)

Jusuf Gërvalla: *"Por natyrisht në drejtimin e asaj, që të realizohen të drejtat e ligjshme të të gjithë popullit Shqiptar në Jugosllavi, për përfshirjen e të gjithëve brenda kufijve të ardhshëm të Kosovës, kjo varet shumë siç thashë edhe më parë, nga vetë aktiviteti që do të zhvillojnë vëllezërit tanë në regjionet përkatëse. Por duhet ta kemi guximin e të flasim objektivisht e të themi, se vetë kërkesa që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës, siç e tha kohë më parë Zëri i Popullit, pikërisht Arbër Korabi, që kjo kërkesë para se të jetë një aspiratë, një qëllim të fundit të popullit shqiptar në Jugosllavi, paraqet më parë një protestë që do të thotë se vetë kërkesa që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës është një kërkesë, e cila flet qartë se në këtë moment popullit shqiptar në Jugosllavi ka përqafuar idetë e luftës, për një autonomi të vërtetë të shqiptarëve në Jugosllavi.*

A është e drejtë kjo, mund të kthehemi mbrapa në histori. Në kohën e Lidhjes së Prizrenit, apo në kohën e kryengritjeve të mëdha të Kosovës, më 1908/10/11 ku 12 kushtet objektive nuk lejonin, që populli në atë kohë të dilte menjëherë me kërkesën për pavarësinë e plotë të Shqipërisë. Por populli u detyrua të dalë për një autonomi në radhë të parë, që do të jetë themeli i shëndoshë edhe për luftën e mëtutjeshme edhe për fitoren e pavarësisë së plotë të popullit shqiptar.

Një rrugë e tillë, sa do që historia nuk përsëritet na imponohet sot edhe ne popullit shqiptar në Jugosllavi dhe gjithë kombit tonë kur është fjala për realizimin e të drejtave tona qoftë në kuadër të kufijve jugosllavë, qoftë me bashkimin e plotë që do të bëhet nesër patjetër në mes gjithë shqiptarëve që jetojnë kudo në tokat e tyre." (Faridin Tafallari: ÇFARË THA JUSUF GËRVALLA PËR KOSOVËN, SHQIPËRINË DHE TROJET SHQIPTARE, NË DITËN E FLAMURIT, 28 NËNTORIN E VITIT 1981; www.albaniaexpress.com, 22 nëntor 2008)

12. KOSOVËS PO I VRITEN DJEMTË NGA SERBOMËDHENJTË

TIRANE, 19 janar 1982 ATSH, - Sikurse njofton agjensia gjermanoperëndimore e lajmeve, DPA, të dielën më 17 janar, natën vonë, në fshatin Untergruppenbah, në afërsi të qytetit të Shtutgart të Gjermanisë Perëndimore, u vranë kosovarët Bardhosh Gërvalla, Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka. Sipas burimeve zyrtare gjermanoperëndimore, sulmi u krye të dielën natën, pak kohë pasi të tre kosovarët dolën me makinë nga një garazh. Vrasësit e armatosur hapën zjarr kundër makinës dhe vranë në vend Kadri Zekën (28 vjeç) dhe Bardhosh Gërvallën (31 vjeç). Jusuf Gërvalla (36 vjeç), i plagosur rëndë vdiq më pas në spital.

Agjencia gjermanoperëndimore e lajmeve, DPA, agjencia franceze e lajmeve, AFP, dhe agjencia amerikane e lajmeve, ASPRESS, duke dhënë lajmin e vrasjes së tre shqiptarëve, theksojnë se, sipas deklaratave të zyrtarëve të sigurimit gjermanoperëndimor të Shtutgartit dhe sipas shërbimit lokal të hetimeve kriminale, Jusuf Gërvalla duke dhënë shpirt në spital, akuzoi policinë sekrete jugosllave se qëndronte pas këtyre tri vrasjeve.

Ndërsa agjencia jugosllave e lajmeve TANJUG, lajmin që dha për vrasjen e tre djemve kosovarë e cilëson si “ larje hesapesh ” midis emigrantëve, shprehje kjo që e kemi dëgjuar shpesh nga udhëheqësit kryesorë jugosllavë dhe ata të Kosovës, kur është fjala për masa shtypëse e terroriste kundër shqiptarëve në Jugosllavi.” (Zëri i Popullit, 20 janar 1982)

13. ZËRI I JUSUF GËRVALLËS

*"Në orën 21.10 të datës 17 shkurt 1982 (në Ankara – vërejtja ime) filluan bisedimet për bashkimin e organizatave **MOTRA**, **LNÇKVSHJ** dhe **PKMLSHJ**, gjegjësisht për shkrirjen e këtyre dy organizatave **NË NJË TË VETME**."*

Të pranishëm ishim Fatoni, unë (Xhafer Durmishi), Osman Osmani, Abdullahu dhe Sabriu. Askush tjetër nuk ka qenë i pranishëm.

Pasi Sabriu u tregoi se fusha ime e interesit ishte teoria, Abdullahu me shokë nuk u interesuan fare të rrahin asnjë mendim në këtë fushë dhe thanë se në atë drejtim ideologjia e Partisë "Komuniste" përputhet pikë për pikë me ideologjinë e Lëvizjes dhe se diskutimi të bëhet vetëm rreth emrit të Organizatës dhe emrit të gazetës. Abdullahu tha se është shumë me rëndësi me ia fillua prej zeros, le të kuptohet që kemi të bëjmë me një fillim të ri dhe se kjo duhet të shprehet në emrin e Organizatës dhe të gazetës. Duke ia nisë prej zeros, ne me shembull konkret po tregojmë se çfarë sakrifice të madhe jemi duke bërë para shokëve tanë dhe gjithë të tjerëve. Ky shpirt i sakrificës e i bujarisë dëshiroj të vjen në shprehje edhe te Baci Sabri.

*Osmani propozoi që **ORGANIZATA E VETME** që do të dalë nga bashkimi të quhet **LËVIZJE**, për hir, apo si vazhdim i drejtpërdrejt i **LËVIZJES SË JUSUF GËRVALLËS**. Sabriu, shumë i kënaqur me propozimin e Osmanit dhe për ta bërë idenë e tij më komplete tha: "Pasi që deri në momentet e fundit të jetës së tij që ra nga plumbat e shovinistëve serbomëdhenj e redatoi dhe udhëhoqi me plot sukses e edhe pas tashit do të punohet me atë teknikë të përsosur të Jusuf Gërvallës, propozoi që organi i **LRSNJ** të mbaj emrin "Zëri i Kosovës".*

Abdullahu me sekretarin dhe nipin iu drejtuan Sabriut: Baci Sabri, pajtohem i me propozimin tënd, megjithëse duhet ta them atë që na e ndjen shpirti ("komunist" - se komunistët i thonë gjërat hapur), se shpirti i sakrificës e bujaria për të cilën fola më parë dhe të cilin kisha dëshirë ta shihja kah vjen në shprehje, sikur po mungon prej anës tënde. Nëse pajtohem i krejtësisht me ty, kjo do të linte hapësirë për kritika ndaj nesh prej komunistëve tanë kur të takohemi me ta ndonjëherë në të ardhmen. A ke ndonjë ide se si duhet ta parashtrojmë para tyre e qëndrimin e Partisë "Komuniste"?

Sabri Novosella: Nuk pajtohem me mendimin tënd Abdullah se shpirti im i sakrificës nuk ka ardhur në shprehje, as me akuzën tënde krejt të pabazë se jam tahmaçar. Përkundër përdorimit me zgjuars i të kërbaçit, unë, si shok i Adem Demës-Demaçit, Shefqet Jasharit, Jusuf Gërvallës po pranoj me bisedua me ty nga pozita të barabarta. A sakrificë e vogël po të duket kjo! A e meritoj vërtetë me thënë tahmaçar?! Nuk e di se a je i vetëdijshëm se çka do të thotë kjo për reputacionin tim? Ku kam fytyrë me u dalë përpara Mulla Hamitit, Mulla Ramës apo futuristit-Mulla Izetit, po ta dinin ata, se unë po bisedoj me komunistë për çështje të Kosovës?!

Sa i përket çështjes se çka t'u thoni "komunistëve" kur t'i takoni në të ardhmen, nëse u bien rasti me takua ndonjë, unë kisha me ua propozua këtë formulim: *"Në natën e 17 shkurtit 1982, në Ankara të Turqisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën; 1. Në bazë të Lëvizjes dhe Zërit të Jusuf Gërvallës u arritë marrëveshja për bashkimin e Dy Organizatave çlirimtare shqiptare; 2. U nderuan me një përkujtim të veçantë në ditën e njëmujorit të rënies edhe në këtë mënyrë të vrarët në Kështjellën e Jusuf Gërvallës dhe 3. Pushoi së vepruari Partia "Komuniste".*

Mehmet Hajrizi (Strofc i): *"Pas rënies së Kadri Zekës, Hasan Malaj dhe veprimtarët e tjerë e autorizojnë Xhafer Shatrin, i cili pas arratisë nga burgu kishte arritur në mërgatë, për ta përfaqësuar OMLK-në në marrëveshjen e bashkimit të organizatave. Më 15 maj 1982 është mbajtur mbledhja për bashkim në fshatin Lanovil, afër Bielit, në banesën e Hasan Malajt. Nga ana e OMLK-së ka marrë pjesë Xhafer Shatri, nga ana e LNÇKVSHJ-së, Skënder Durmishi, kurse nga ajo e PKMLSHJ-së, Osman Osmani. Në atë mbledhje është arritur bashkimi dhe prej asaj date organizata është quajtur "Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi" (LRSSHJ), kurse organi i saj "Zëri i Kosovës." (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 389)*

Ibrahim Kelmendi: *"Nuk mund të quhet bashkim, por bashkëngjitje" (Atentatet, f.380) "Ia thashë troç se ata nuk ishin bashkuar, por Xhabiri ia kishte bashkëngjitur OMLK-në" (Atentatet, f.392)*

Partia Komuniste (PKMLSHJ): *"Me Skënder Skënderin (Xhafer Durmishin - shën im) isha takuar vetëm njëherë në familjen Gërvalla, në shtator të vitit 1981, në prezencën e Islam Rafunës. Pastaj, as nuk e kam parë, por as nuk kam dëgjuar më për të. Nuk e mora vesh se nga erdhi, nga Kosova apo nga ndonjë vend tjetër, ndodhej ilegal në Gjermani, apo kishte ndonjë leje qëndrimi. Në fillim mendova se qëllimi i vizitës së tij ishte ngushëllimi, por pak kohë më vonë, për befasinë time, Suzana ma prezantoi si „zëvendës“ të Jusufit! Tani e kuptova qëllimin e vërtetë të ardhjes së tij. I çuditur, ia ktheva Suzanës, se Jusufi nuk ka qenë në dijeni se do të vritej dhe të parapërcaktonte një zëvendës... as nuk ishte mbret që të linte në fron trashëgimtarin." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 88)*

Shefqet Jashari (Strofc i): **"Kam lindur më 15 maj 1944 në fshatin Strofc, KK Vushtëri."**

Xhafer Shatri: "Po që se ju jepet rasti, ju lutem që t'ia përcillni Kamberit (Sabri Novosellës - shën i Xh. D.) argumentimet tona lidhur me nevojën **E NDRYSHIMIT TË EMRIT TË ORGANIT (REVISTËS "ZËRI I KOSOVËS" -shën i Xh. D.)** dhe përpikuni të jeni sa më origjinal dhe sa më të arsyeshëm dhe këtë mos e bëni sa për ta bërë, por vetëm pse **ËSHTË SHUMË E NEVOJSHME.**" (Letër Xhafer Durmishit e Osman Osmanit, 16 maj 1982; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 163)

"KOMUNIKATE

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mbledhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave **NË NJË TË VETME.** Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982. Me një shkallë të lartë të unitetit të mendimit, përfaqësuesit e tri organizatave në mes tjerash morën këto vendime e qëndrime:

1. Që organizata e re të pagëzohet "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).

11. Organ qendror i LRSHJ-së do të jetë "Zëri i Kosovës". ...

KOMITETI QENDROR I LËVIZJES PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË RSFJ"

Kjo Komunikatë u daktilografua, u shtyp dhe u shpërnda nga Xhafer Shatri së bashku Thirrjen e demonstratës së Bernit, të 26 qershorit 1982.

14. Të madhërishëm dhe të patejkalueshëm

Xhafer Durmishi: "Qysh si fëmijë kam pasur një kureshtje dhe dashuri të pashuar për Shqipërinë, e cila është shprehur apo personifikuar edhe në dashurinë për E. Hoxhën. I dehur nga kjo dashuri kam shkuar aq larg sa kam menduar se një ditë patjetër do të takohem me Hoxhën. Shkrimet e artikujt e tij jo vetëm që më kanë pëlqyer por tek unë kanë pasur edhe ndikim bindës. Artikujt e tij për Kosovën e për mbrojtjen e flaktë e të argumentuar të kërkesës "Kosova-Republikë" janë të fuqishëm, të madhërishëm dhe të patejkalueshëm.

Vitet kaluan, unë dola në Gjermani. Personalisht me Hoxhën nuk u takova kurrë, por megjithatë një pjesë e ëndrrës feminare m'u realizua. Kam fakte të pamohueshme dhe dëshmitarë të gjallë se në Salzburg, Vjenë dhe Frankfurt më është parafytyruar (jo njëherë por disa herë) vet KryeEngjëlli, KryeEngjëlli i Hoxhës, Engjëll Kolaneci, diplomati kryesor i Shqipërisë që është marrë me çështje e me shqiptarë të Kosovës në Gjermani e Zvicër. Natyrisht se më janë shfaqur edhe engjëj e shpirtra tjerë, por në kategorinë e engjëjve asnjë nuk mund të krahasohet me Engjëllin.

Nuk e di se a është e vërtetë apo jo, por thonë se për t'i takuar rrethit më të ngushtë të Hoxhës patjetër është dashur të kalosh nëpër duart e xharrahëve, se pa kalua nëpër duart e tyre ka qenë e pamundur me hy në kalanë e tij. Këtu nuk e shohë të arsyeshme e as nuk më takon të zgjerohem në hipoteza lidhur me krimet dhe garat e xharrahëve dhe servilëve. Me këtë rast dua të them se E. Hoxha, për mua dhe për Atë që e çmoj më së shumti në këtë jetë - Jusuf Gërvallën, ka qenë një nga inspiruesit e frymëzuesit në luftë

kundër pushtetit serb. Në atë periudhë të jetës time, (gjer në vitin 1985) mund të thuhet se Kosovës nuk i ka ardhë asnjë e keqe prej E. Hoxhës por vetëm të mira. Duke u bazuar në numrin e tytave të topave e pushkëve, Shqipëria ka qenë mbrojtësja konstante, besnike dhe e guximshme e Kosovës dhe shqiptarëve nën Jugosllavi. Ne që kemi qenë jashtë territorit të RPS të Shqipërisë kemi parë vetëm anët e mira. Ne kemi pasë punë vetëm me engjëj. Është me rëndësi që ta pohojmë këtë fakt dhe kjo nuk duhet të merret si ofendim i viktimave të gjalla e të vdekura të dhunës fizike e psikike të sistemit të tij. Por vlerësimet tona janë të njëanshme dhe mbeten të tilla. Vlerësimin, kritikën, lavdatat e të tjerat u takojnë në radhë të parë dhe të fundit atyre që kanë jetuar nën regjimin e tij, që kanë pasë punë jo vetëm me të mirat e engjëjve por edhe me trajtimet e xharrahëve.

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit

01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: “Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror.” (14 janar 1981)

Shënime për autorin



Xhafer Durmishi-Skenderi

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën “Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi”. Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në

emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

XHAFAER DURMISHI-SKENDERI Nëntor 2011-Shkurt 2026